

Shkrimtari dhe përkthyesi i njohur Agron Tufa, autor i romanit “Bija e Minotaurit”, botuar së fundmi nga “Onufri”, rrëfen ekskluzivisht për gazetën “ExLibris” qorrsohakun mes mitit dhe pushtetit, etikën e përkthimit dhe përvojën e jetës në emigrim, si pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij.

AGRON TUF

Labirinti më i rrezikshëm
është ai që na trashëgohet
si identitet

Përgatiti dhe bisedoi Xhoina Salaj



Foto nga Romir Imami

Tirania e
thonjës

Nga Andreas Dushi

(fq. 19)

SHËNIME MBI LIBRAT

Brenga, roman i Pashko R. Camajt

Një brengë që donte të
shkruhej... – Dhe thirri doktor
Pashko R. Camajn –

Nga Visar Zhiti

(fq. 8)

Romani do të promovohet në datë 21 janar, në
orën 12.00, tek Akademia e Shkencave, salla
“Aleks Buda”. I pranishëm do të jetë autori.Tregimi *Floçka* i Anton PashkutKryevepër letrare e bukurisë
dhe për bukurinë

Nga Anton Nikë Berisha

(fq. 10)

Romani “Vaji i gurit” i autores Miranda Haxhia

Monument kujtese për një
familje fisnike që u gjymtua
nga diktatura

Nga Mal Berisha

(fq. 7)

Le të përpiqemi të lexojmë
librat e artit

(fq. 20)

Nga Suzana Varvarica Kuka

Mbi veprën *Të lirë* nga Lea Ypi, DudajAutobiografia si interpretim:
rasti i Lea Ypit

Nga Rubensa Ndreca

(fq. 21)

ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË 2024:

ZHBËRJA E NJË TRADITE
BRENDA NJË DITE

Nga Granit Zela

QENDRA KOMBËTARE
E LIBRIT DHE LEXIMITNga Çmimet Kombëtare është hequr plotësisht drama, është hequr si
kategori më vete poezia, është hequr si kategori më vete tregimi dhe po
kështu edhe letërsia për fëmijë, nuk mendoj se duhet hequr dorë edhe nga
përkthimi letrar.

(fq. 6)

Dashuria e José
Saramago dhe
Pilar del RioDhe një sekret i
Saramagos për Kadarenë,
sipas Pilar del Rios,
treguar nga fotografi
personal i nobelistit, zoti
Joakim Silva Rodrigues

Përktheu dhe përgatiti

Bujar Hudhri

(fq. 22)



BIBLIOTEKË

Anton Pashku

(fq. 12)

Floçka

Konstandin Dharmo

(fq. 14)

GAZ 69

Teuta Dhima

(fq. 15)

...Offline

Delvina Kërluku

(fq. 15)

Korç' e Shkup - dashuri

Feride Papeleka

(fq. 16)

Xha Abazi dhe Averroes

Arben Meksi

(fq. 23)

*Karikatura e së shtunës*Koleksioni më i fundit
i Dior-it i bën homazh
letërsisë klasike

Nga Jola Tasellari

(fq. 19)

Përballja e një përkthyesje
me gratë e “Odisesë”

Nga Emily Wilson

E para grua në botë,
që ka përkthyer “Odisenë”

(fq. 18)

Agron Tufa është një figurë poliedrike në kulturës shqiptare: shkrimtar, poet, përkthyes i kolosëve rusë dhe ish-pedagog, i njohur për rigorozitetin intelektual dhe qëndrimin kritik ndaj deformimeve të kujtesës historike. Përkthimet e tij të Dostojevskit kanë ndezur gjithmonë debat për sintaksën, ritmin dhe etikën e përkthimit, ndërsa proza e tij ka ndërtuar një marrëdhënie të qëndrueshme mes vorbullës së totalitarizmit, fajit, trashëgimisë dhe refuzimit moral.

Këto prirje tematike dhe etike kulmojnë në romanin e tij më të fundit, “Bija e Minotaurit”, botuar së fundmi nga shtëpia botuese “Onufri”, një tekst që rikthen mitin për ta zhvendosur në terrenin e pushtetit totalitar, trashëgimisë ideologjike dhe zgjedhjes individuale; një nga ata qorrsoakë që të fut ngadalë në labirinte të brendshme e të jashtme, ku modernia dhe arkaikja frymojnë në mënyrë të dhimbshme, e shpesh të pandashme. Përpara se të hyjmë në bisedën me autorin, romani kërkon një ndalesë leximi dhe reflektimi.

Në qendër të romanit është Dafinë Luçi, një vashë, e cila që prej viteve të adoleshencës ushqen një romancë të çuditshme ndaj makinerisë së sigurimit të shtetit dhe diktaturës. Kjo marrëdhënie, që në fillim duket si një adhurim i padiskutueshëm, shndërrohet gradualisht në një mallkim të brendshëm, duke u shfaqur si një mjegull e errët e ambicies, dhunës psikologjike dhe vetëshkatërrimit. Një metamorfozë ku ndjesia dhe dëshira e humbin pafajësinë rishtarë dhe transmodelohen në një peshë të rëndë simbolike, ku rrëzimet shpirtërore dhe morale ndërthuren me figura të errëta, që nuk ia pret mendja askujt. Dafina nuk është gjë tjetër veçse produkt i formësuar nga ideologjia, nga pushteti dhe nga adhurimi i verbër ndaj strukturave që premtojnë rend, por prodhojnë dhunë.

Personazhet e Tufës janë thellësisht njerëzorë: të ndarë mes dëshirës që të përkasin diku dhe nevojës për të qenë të lirë. Herë-herë bëhen qesharakë, të vegjël, po emëruesi i përbashkët është se asnjë nuk është ashtu siç hiqet. Sikur të mos mjaftojnë lojërat si macja me miun me shoshoqin, ata përballen edhe me sistemin shtypës, edhe me pasojat që ai damkos në shpirtin dhe shtëpinë e gjithsecilit: frikë, bindje, vetëshkatërrim.

Romani ndërtohet mbi simbolikën e labirintit dhe të Minotaurit, si ura lidhëse mes ndërgjegjes dhe së keqes që ushqehet nga bindja dhe nga mungesa e dyshimit. Pavarësisht se në mendje të vërtitet një periudhë e caktuar, duket sikur “Bija e Minotaurit” shtrihet në gjithë segmentin e fjalës “e shkuar”, në mënyrën se si ajo mbijeton brenda qenies, edhe kur mendojmë se e kemi kapërcyer.

A është e nevojshme të cek gjuhën? Kushdo që ka humbur, qoftë edhe një herë të vetme, në universin që ndërton pena e Tufës, e di mjaft mirë se gjuha e tij është poetike, arkaike, dialektore, herë-herë brutale. Secila fjali ka peshën e vet dhe i bie në të çdo ideje, kujtimi, vrage. Edhe pse romanin e mbulon një petk misteri dhe faqet kalojnë sa hap e mbyll sytë, përgjigjet nuk jepen kaq sheshit, por zbulohen pak nga pak, si daljet e fshehta të një labirinti.

Sa lehtë mund të shndërrohet bindja në adhurim, njeriu në përbindësh, qoftë edhe në kohët që i quajmë moderne?

Xhoina: Profesor Tufa, edhe pse unë nuk pata fatin të dëgjoja leksionet tuaja, emri juaj ka qenë gjithmonë i pranishëm gjatë viteve të mia universitare, i shoqëruar nga respekti i kolegëve dhe nga puna kolosale që keni lënë pas. Kam dëgjuar shpesh histori të mësimdhënies *tufiane*, më pas u përhumba në botën poetike dhe prozaikë të veprës suaj, e më pas te përkthimet e të patëmeta, që më kanë krijuar ndjesinë e veçantë për krijimtarinë dhe seriozitetin tuaj. Tash, më në fund, kam mundësinë të bisedoj drejtpërdrejt me Agron Tufën, dhe ndiej një kënaqësi të madhe për këtë mundësi! Është privilegj të zhvilloj këtë bisedë për librin tuaj të ri, “Bija e Minotaurit”, përkthimet e shumta të Dostojevskit, që i janë bashkuar bibliotekave tona, dhe për jetën tuaj në emigrim, për të kuptuar më nga afër

AGRON TUFA

Labirinti më i rrezikshëm është ai që na trashëgohet si identitet

Përgatiti dhe bisedoi Xhoina Salaj

Shkrimtari dhe përkthyesi i njohur Agron Tufa, autor i romanit “Bija e Minotaurit”, botuar së fundmi nga “Onufri”, rrëfen ekskluzivisht për gazetën “ExLibris” qorrsokakun mes mitit dhe pushtetit, etikën e përkthimit dhe përvojën e jetës në emigrim, si pjesë e pandashme e krijimtarisë së tij.

mendimet dhe përvojat që e kanë formësuar veprën dhe rrugëtimin tuaj. Ia nisim nga libri i ri, “Bija e Minotaurit”, që u botua në panairin e fundit, nga shtëpia botuese “Onufri”. Romani duket se e ndërton gjithë boshtin e tij mbi metaforën e labirintit, jo vetëm si strukturë mitike, por edhe si mekanizëm politik, psikologjik dhe moral. Nga mënyra se si Dafina, agjentja, e përjeton misionin, labirinti shfaqet si një sistem që e përpëlit njeriun mes roleve, ideologjive dhe manipulimeve të pushtetit. A e mendoni labirintin si një strukturë që individi e mban brenda vetes pavarësisht nga koha historike, apo është kryesisht produkt i një epoke represive specifike? Ç’përfaqëson për ju labirinti sot?

Agroni: Më miklon të dëgjoj kaq shumë fjalë miradije qysh në fillim, nga hiri i mësimdhënies sime në Fakultetin Filologjik. Faleminderit! Më ka munguar shumë marrëdhënia ime 17-vjeçare me auditorin dhe studentët.

Metafora e labirintit kam përshtypjen se përshkon, ku më shumë, ku më pak, të gjitha romanet e mia, që nga “Dueli” (1998) dhe sidomos fund e krye romanin “Arratia e fundit e Baltazar Ketës” (2024, “Onufri”), në të cilin ka dhe shenja të qarta konvencionale të referencës së mitit si taverna “Labirinthos”, hotel “Parsifea”, etj. Duhet theksuar diçka: që nga miti i Minotaurit, labirinti nuk është ndërtuar për të u humbur brenda tij, por për të u provuar. Kush hyn, hyn sepse diçka brenda vetes e kërkon përballjen me të (si te “Dueli”). Në këtë kuptim, labirinti ekziston pavarësisht nga epoka: çdo njeri që mendon seriozisht, që reflekton moralisht, e mbart atë si strukturë të brendshme. Me fjalë të tjera, Labirinti, në thelb, nuk është historik, por *antropologjik*. Dikur, nga viti 2002 kam pas botuar një cikël prozash poetike te “Fjala”: “Historiografia e Labirintit”; “Epistemologjia e Labirintit”; “Retorika publike e Labirintit”, si reflektime pa referencë nga botët labirintike të Dostojevskit, Kafkës, Xhojsit, Borhesit etj. Mendimet mbi strukturën e Labirintit në botët e trilluara artistike janë përimtuar me kohë, për të dalë te protagonistja e romanit “Bija e Minotaurit”. Dafina, i përket llojit më të vështirë: *labirintit të trashëguar*. Kur lind brenda një labirinti familjar, shtetëror, ideologjik, ti nuk hyn në të - ti je tashmë brenda. Nuk ka moment zgjedhjeje, nuk ka fillim dramatik. Prandaj

ky lloj labirinti është më tinëzar se ai mitik. Ai është labirinti i vetëdijesimit, që në roman ndodh pahetueshëm, instinktivisht. Vajza e Labirintit këtu nuk përballet me përbindëshin si hero; ajo zbulon se vetë struktura e botës së saj është ndërtuar rreth përbindëshit. Minotauri nuk është vetëm figura e dhunës, por origjina e rendit. Asaj i duhet të projektojë një antilabirint, prandaj dhe zgjedhja për të është më e dhimbshmja, sepse nuk premtion shpëtim, por vetëm *mosbashkëfajësi*.

Sot, labirinti më i rrezikshëm nuk është ai që na mbyll, por ai që na trashëgohet si identitet. Kur ideologjia kalon në gjak, ajo nuk ka më nevojë për mure. Në këtë kuptim, Dafina e romanit nuk është Ariadna. Ajo nuk jep fill. Ajo zgjohet brenda labirintit dhe vendos të mos bëhet trashëgimtare e Minotaurit. Koklavitja këtu është se Dafina, nuk është e mbyllur në labirint si të tjerët. Ajo është edukuar për ta *patrulluar* atë. Ky është labirinti më i rafinuar i shtetit totalitar: ai që riprodhon veten përmes bijve. Këtu labirinti nuk është burg, por karrierë, privilegj, kuptim jete. Me fare pak fjalë: labirinti i Dafinës është labirinti i atij që është rritur për ta ruajtur përbindëshin, por zgjohet duke kuptuar se e vetmja dalje është ta lërë përbindëshin pa trashëgimtar. Por nëse e reduktojmë fare-fare në një mesazh etik (që në letërsi, në akord me shkrimtarin Balil Gjini, duhet ta quajmë “masazh” etik), atëherë kemi lindjen e një postulati të ri: ta lësh përbindëshin pa trashëgimtar është mënyra e vetme për ta mposhtur të Keqen, pa u bërë vetë përbindësh.

Sistemet totalitare nuk jetojnë nga frika, por nga trashëgimia: nga bijtë që e marrin pushtetin si “normalitet”, si “fat”, si “detyrë morale”. Kur trashëgimtari refuzon, sistemi plakët menjëherë. Është një ndëshkim *ontologjik*: e Keqja mбетet gjallë, por e pafrytshme. Mundja “nga jashtë” krijon gjithmonë një Minotaur të ri. Mundja “nga brenda” krijon një boshllëk. Në mitologji, mallkimi më i rëndë nuk është vdekja, por *shterpësia*. Dhe kjo na kthen secilin në pyetjen e pamëshirshme: çfarë po trashëgoj? Çfarë po përcjell? Çfarë po normalizoj? Kjo është forma më e heshtur, më e vështirë dhe më ngadhënjyese e rezistencës. Për mua, ekzistojnë tri shtigje, që në fakt formojnë një trekëndësh etik të mbyllur, ku labirinti nuk është më arkitekturë, por gjendje e vetëdijes. Ja tri kulmet e tij:



1. *Refuzimi pa alternativë* i Ivan Karamazovit të Dostojevski: Ivani nuk është revolucionar.

Ai nuk ka projekt. Ai nuk ofron shpëtim. Hedh vetëm këtë tezë famëkeqe, që është akt apostazie metafizike: “Unë ia kthej mbrapsht biletën Hyjit.” Kjo është lënia e përbindëshit pa trashëgimtar në planin kozmik. Ivani nuk e mohon Zotin, as nuk e zëvendëson. Ai refuzon të marrë pjesë në rendin e botës që kërkon vuajtjen e fëmijëve si çmim. Të njëjtën lëvizje bën e Bija e Minotaurit, Dafina: ajo nuk e përmbys sistemin, nuk e demaskon publikisht, por refuzon ta trashëgojë.

2. *Banaliteti i së keqes me një labirinti pa qendër*. Hanah Arendt zbulon këtu diçka tronditëse: e Keqja moderne *nuk ka Minotaur*. Ajhmani nuk është demon, por korrekt, procedural, mediokër. Labirinti këtu është *pa përbindësh*, vetëm me rregulla. Prandaj akti etik nuk është heroik, por *mospjesëmarrje*: të mos nënshkruash, të mos raportosh, të mos e bësh punën “siç duhet”. Në këtë kuptim, Apostazia është forma e vetme e heroizmit që sistemi nuk di ta ndëshkojë pa u zbuluar. Dafina e librit “Bija e Minotaurit” bën pikërisht këtë: ajo e prish mekanizmin nga brenda, jo duke u bërë martire, por duke *mos qenë më funksionale*.

3. *Apostazia si akt etik (jo fetar)*, e cila mendohet si mohim, tradhti, rënie. Veçse apostazia e vërtetë nuk është “nuk besoj më”, por “nuk pranoj të jem hallkë”.

Xhoina: Nga dinamika e romanit, figura e Minotaurit kthehet në një metaforë politike: përbindëshi nuk është më i fshehur në labirint, por është arkitekti i tij, vetë babai i protagonistes. Si lindi ideja për ta përmbysur mitin në këtë mënyrë dhe për ta vendosur përbindëshin jo tek *i burgosuri*, por te *ndërtuesit e pushtetit*? A qe një reflektim për ndryshimin e roleve të viktimës dhe xhelatit në shoqëritë totalitare?

Agroni: Në roman, miti i Minotaurit merr një kuptim të ri: përbindëshi nuk është më i mbyllur në labirint, por është ai që e ka ndërtuar atë. Babai i heroinës, figurë e pushtetit dhe e autoritetit atëror, përfaqëson një të keqe që nuk shfaqet si dhunë e verbër, por si rend, disiplinë dhe “normalitet” deri në fanatizëm e besnikëri të verbër politike dhe ideologjike. Shefi i Sigurimit, Ligor Luçi, përpiket ta sakrifikojë të bijën, si fli për labirintin duke dëshmuar besnikëri të pacenueshme. E ëma, Marianthi, ndonëse nuk e di planin e të shoqit ndaj bijës së tyre, parimisht është dakord ta dorëzojë vajzën në litar, në rast të një tradhtie të hamendësuar. Vajza, e rritur brenda këtij sistemi dhe e formuar për t’i shërbyer atij, nis dalëngadalë të zgjohet kur përballet me njerëz që duhej t’i shihte si armiq, por që i zbulohen si të drejtë, të ndershëm dhe njerëzorë. Zgjimi i saj është një tronditje e thellë: ajo kupton se është rritur brenda një labirinti që s’e ka ndërtuar vetë, por që pritej ta trashëgonte ose të flijohej për të. Arratisja e saj, në këtë kuptim, nuk është thjesht një ikje fizike, por një zgjedhje morale - refuzimi për të vazhduar një trashëgimi dhune dhe mashtrimi, dhe mënyra më e heshtur, por më e fortë, për ta lënë përbindëshin pa pasardhës.

Nuk bëhet fjalë që viktimat të shndërrohen në xhelatë. Romani tregon se e keqja në një shoqëri totalitare nuk ndryshon role, por vazhdon të jetojë si zakoni i trashëguar. Çasti vendimtar nuk është ndërrimi i roleve, por zgjedhja për të mos e vazhduar zinxhirin. Vajza nuk përmbys përbindëshin - ajo thjesht refuzon ta trashëgojë.

Xhoina: Protagonistja që na rrëfen ngjarjen, Dafina, ka një identitet të ndërtuar nga shteti. Është produkt i një trupe të stërvitur sipas modeleve të KGB-së, një instrument i pushtetit, por ndërkohë kërkon t’i shpëtojë pikërisht këtij identiteti. Në ç’moment të shkrimit u qartësua ndarja mes identitetit të *mësuar* dhe identitetit të *përfjetuar*? A është ky roman një rrëfim për mënyrën se si njeriu përpiket të kthejë trupin dhe mendjen e vet nga mjeti i tjetrit në pronë të vet?

Agroni: “Bija e Minotaurit” qe menduar si pjesa përmbyllëse e projektit romanor pentalogjik “Ngjizja e papërlyeme”, gjithashtu, një roman labirint që shtrihet nga Moska në Tiranë. Kjo vërehet nga një pjesë e personazheve të “Ngjizja e papërlyeme”, që veprojnë edhe te “Bija e Minotaurit”. Ka qenë kështilla e botuesit tim për ta lënë këtë roman të botohej i pavarur nga cikli tetralogjik, pak a shumë në traditën franceze të romanit-rrjedhë, romanit-lumë, siç është te Prusti “Në kërkim të kohës së humbur” apo te Romein Rollend “Zhan-Kristof”. Në epokën tonë të shpejtësisë dhe fragmenteve, *roman-fleuve* kërkon një lloj tjetër leximi: leximin e duruar. Ai të ofron mundësinë të “jetosh” brenda një bote tjetër për një kohë të gjatë.

Ideja fillestare ka qenë, që Dafina, të cilën e ndeshim te “Ngjizja e papërlyeme” duke flirtuar me shkrimtarin e ri të talentuar Saumill Ismari, të ishte një nepërkë e neveritshme, ndoshta personazhi më i poshtër e më pashpirt. Gjatë shkrimit të romanit ajo bëri një qëndresë të paparashikuar, m’u përdrodh ndër duar, nuk donte të bëhej “e keqe”. Jam përpjekur t’i tregoj vendin, duke ia shpjeguar edhe me të mirë, se ti duhet të jesh e keqe! Nuk deshi, m’u kundërvu me një rebelim të tillë... po unë jam nga natyra tejet demokratik, andaj e lash të bënte jetën e vet.



Foto nga Rromir Imami

Dafina lind si instrument i pushtetit, një trup i bukur, joshës, i stërvitur për t’u shërbyer planeve të tjetrit, por përmes takimit me njerëzimin e pastër dhe virtytet që nuk mund të manipulohen, ajo ndien pavetëdijshëm se identiteti i mësuar po shpërbëhet. Dafina është mjeti i dikujt tjetër, por rrëfimi i saj është udhëtimi i trupit dhe i shpirtit drejt pronësisë mbi vetveten, ku ndjenjat, zgjedhjet dhe etika bëhen të sajat: ky është një akt i brendshëm që shpërthen nga njohja dhe mania para brishtësisë tragjike të presë së saj (Meleqit), një akt i mrekullueshëm dhe i dhimbshëm njëkohësisht.

Xhoina: Teksti rrëfëhet me keqardhje, tërheqje, por edhe shfrytëzim, manipulim dhe një moral që rrëshqet sipas mekanizmave të frikës dhe pushtetit. Duket se në ligjërimin e romanit nuk ka viktimë të pastra, por as fajtorë për në gjiotinë. Ishte zgjedhje e qëllimshme për t’i hequr kufijtë e moralit klasik? Sa synon libri të tregojë se njeriu i futur në mekanizma represivë humb aftësinë për të qenë plotësisht *i mirë* ose *i keq*?

Agroni: Romanit i intereson më pak ndarja e ngushtë midis të *mirit* dhe të *keqit* sesa mënyra se si pushteti, frika dhe manipulimi e shtypin shpirtin e njeriut. Dafina, edhe pse e stërvitur si mjet i shtetit dhe e formuar për t’u shndërruar në vegël të Sigurimit, zgjedh të veprojë sipas ndërgjegjes së saj: shpëton njërin nga vëllezërit, të voglin, Meleqin, të dashuruar me të, i cili me siguri mund të vetëvritej dhe nuk e tradhton familjen Shestani: bën plane të fshehta për t’i shpëtuar ata. Në roman, nëse do të zbuloheshin, fajtorë për gjiotinë, sigurisht që ka: nëse Dafina do të raportonte sekretin e tunelit prapa shtëpisë së Shestanëve; nëse ajo do të raportonte që vëllai i madh (Feriku) del në male çdo fundjavë dhe flet me një radiomarrëse me të atin, kontigjent i një detashmenti të pritshëm desantësh, ai me siguri do të shkonte në plumb apo litar; sikundërse, po të kapej vetë Dafina, do të ndëshkohej mizorisht. Romani tregon se njeriu brenda mekanizmave represivë mund të humbasë aftësinë për të qenë “plotësisht i mirë” ose “plotësisht i keq”, por mund të ruajë një hapësirë të brendshme të lirë. Ky akt shpëtimi përmes ankthit dheurvejimit, bëhet nën zjarrin e farkëtimit të një personaliteti, që as Dafina nuk e di se çfarë do të jetë dhe ku do ta çojë, por është gjithsesi një kërkim me tahmin dhe instinkt përmes sprovës së zjarrit.

Xhoina: Një nga reflektimet më interesante në fragment është ideja se mund të bësh profeci jo vetëm për të ardhmen, por edhe për të shkuarën. Kjo prish rrjedhën tradicionale të kohës në letërsi. A është ky koncept një mënyrë për të treguar se si trauma dhe e tashmja deformojnë të kaluarën? Apo është më shumë një mekanizëm letrar që e afron rrëfimin me nivelin e kujtesës poetike?

Agroni: Kjo ka të bëjë me fiksimin tim të hershëm ndaj misterit të Kohës si kategori metafizike dhe se si përjetohej Koha në letërsi. Kam shkruar dikur ese të mirëfillta filozofike mbi Kohën, paradokset e përjetimit të saj në vepra të ndryshme letrare (libri “Kuja e Mnemozinës”, 2011, “Pika pa sipërfaqe”). *Profecia për të shkuarën* te Dafina tregon dy gjëra njëkohësisht: se si trauma dhe e tashmja e deformojnë kujtesën, duke e bërë të kaluarën të rifrymëzohet nga çasti i sotëm, dhe se si e përdor këtë mekanizëm si një rrugë për të afruar rrëfimin me nivelin poetik të përjetimit, ku kujtesa vetë bëhet aktive dhe e gjallë. E tashmja, me gjithë lodhjen dhe pasojat e një viti në Gradishtë, nuk e ndalon të shohë dhe të rilevojë të shkuarën; përkundrazi, e ringjall atë, e ritregon, madje e parashikon në kuptimin më të brendshëm të fjalës. Koha nuk rrjedh thjesht drejt; ajo kthehet mbi vetveten, si në paradokset e Zenonit.

Xhoina: Bukuria femërore, sidomos ajo e Silvanës, shfaqet si e dyfishtë: si armë që të jep pushtet, por edhe si thikë që të ekspozon, të plaçkit dhe të bën të prekshëm. A e trajtoni bukurinë në roman si një formë pushteti të përkohshëm, që gjithmonë bie nën hijen e pushtetit të vërtetë (politik dhe shtetëror)? Ç’rol ka estetika në mekanizmat e frikës dhe kontrollit?

Agroni: Në roman, bukuria e Silvanës është si një dridhje dritëhije: mund t’i japë pushtet, por gjithmonë nën hijen e pushtetit të vërtetë. Ajo është armë, por edhe kurth; ankth, magji e jashtme, por e ekspozuar ndaj manipulimit dhe frikës shtetërore. Estetika këtu nuk është zbatimje, por instrument i logjikës së dominimit: bukuria e saj tregon se pushteti i vërtetë nuk fshihet pas hijeshisë, por përdor hijeshinë për të sunduar, për të mashtruar, për të kontrolluar. Në këtë lojë, çdo buzëqeshje dhe çdo gjest është pjesë e një strategjie të

heshtur, ku njerëzit nuk janë vetëm tërheqës dhe të tërhequr, por edhe viktimë të bukurisë së manipulueshme. Ndoshta ajo ka prirjen e brendshme t’i dhurohet më të fortit në hierarkinë e pushtit dhe, siç e shohim, mbetet dhe peng i shantazhit. Bukuria dhe ankthi erotik i pushtimit dhe zotërimit shkojnë krahas në një diafragmë të çmendur, trallisëse. Më ka qëlluar një herë të vizitoj në Lodevë të Francës një muze të çuditshëm, që quhej “Shtëpia e kënaqësisë”. Më troç, bëhej fjalë për një shtëpi kurtizanesh të viteve 1900-1930, me të gjitha mjetet, aksesoret dhe trillet e gjithëmundshme që përshkruhen në letërsinë franceze që nga Markezi dë Sad deri te koha e Prustit. Ishte i papërfytyrueshëm gjithë ai sistem i larmishëm, sqimatar dhe i sofistikuar i mjeteve që e “shtrengonin” femrën e bukur, t’u nënshtrohej lojërave të rrezikshme. Ato shufra vezulluese të holla metalike, format e trajtat gjithfarëshe të kamxhikëve, prangave, sferave e gypave të qelqtë, ishin një “tekst” i çmendur i sojlinjve të çuditshme të një epoke që i impononte “bukurisë” një regjim të trazuar. Për këtë estetikë tregonte Ciceroni. Ndërsa estetika e frikës, ankthit dhe kontrollit në membranën e romanit tim, bëhet, vetvetiu, në përputhje me gjestin e gishtit në buzë: shshshsh!

Xhoina: Edhe kur përshkruhen mizori, manipulime, pislleqe, gjuha e romanit mbetet gati-gati poetike, e mbushur me metafora që duken si një kundërvënie ndaj realitetit të errët. A është kjo formë e gjuhës një mënyrë për ta bërë sa më të njerëzishme dhunën, për ta bërë më të përballueshme, apo është një mënyrë për të treguar se gjuha, edhe në situata të errëta, mbetet streha e vetme e njeriut?

Agroni: Nuk e di si ndodh. Në roman, gjuha është një mburojë dhe një dritare njëkohësisht. Kam patur kujdesin të mos bie në sforcime manierizmash, që ta shpifin me gjuhën: kërkime fjalësh për efekt, spitullime të lëngshme, apo ndonjë grremç metafore. Gjuha për mua është diksioni i natyrshëm me të cilin duhet të flasë një personazh, në përputhje me botën e vet, nivelin e vet kulturor, shtresën që i përket dhe projeksionin që i bën vetes në horizontet e ëndrrave, idealeve. Gjatë gjithë romanit është Dafina që rrëfen kujtimet e saj për një periudhë gjashtë vjeçare, nga matura deri në arratisje. Të mos harrojmë, Dafina është një lexuese e pasionuar, një shkrimtare e re, një përkthyes. Ndërsa rrëfimin e bën nga lartësia e një moshe thuajse të thyer, të mbetur vejushë. Ne nuk e dimë se ç’jetë ka bërë ajo në Paris, përtej atyre gjashtë viteve të ankthshme në atdhe. Dimë që ajo dhe Meleqi nuk kanë lënë pasardhës dhe kjo ilustron idenë e ndërprerjes së trashëgimisë së xhelatit dhe viktimës.

Xhoina: Protagonistja dërgohet për të korrptuar dhe kontrolluar familjen *armike*, por zbulimi i dinjitetit të tyre kthehet në pikën që e shpërbën misionin e saj. Në ç’masë është ky roman një histori mbi rrezikun e empatisë? A është përballja me të vërtetën e tjetrit forca që e thyen propagandën më shumë se çdo akt heroik?

Agroni: Dafina hyn tek shtëpia e Shestanëve si mjet i pushtetit, e stërvitur për të manipuluar dhe kontrolluar. Por çdo hap pranë tyre i zbulon hijeshinë dhe dinjitetin e njerëzve që duhej të ishin “armiq”. Ajo kupton se misioni i saj nuk mund të mbijetojë përballë empatisë. Ky roman, më shumë se histori spiunimi apo heroizmi të jashtëzakonshëm, është rrëfim për rrezikun e të ndierit, të kuptuarit të tjetrit. Përballja me të vërtetën e tyre, me bukurinë, dobësinë dhe shpirtin e tyre, shpërbën propagandën më me efekt sesa çdo akt heroik. Fuqia e njeriut nuk matet vetëm me guximin apo veprën, por me aftësinë për të njohur dhe për të ndier të tjerët, dhe pikërisht kjo njohje, ndonjëherë, është arma më e fuqishme kundër manipulimit dhe frikës.

Xhoina: Romani duket se ngrihet mbi dy shtylla, ku ndërtohet një tension i jashtëm (misioni, intriga, rrjetat dhe pezshishkat e

pushtetit) dhe një tension i brendshëm (që shemb identitetin e protagonistes). A e shihni librin më shumë si një triller politik-policor apo si një tragjedi intime? Cila prej këtyre dy linjave ishte fara që e shtyu romanin dhe cilën e ndërtuat më pas, si strukturë mbështetëse?

Agroni: Romani lind nga tragjedia intime e Dafinës: një vajzë e stërvitur si mjet i pushtetit, që kërkon të shpëtojë identitetin dhe lirinë e vet brenda një rrjeti intrigash. Thyerja e saj vjen nga çmeritja prej bëmave të ulëta të të atit dhe jo më pak të së ëmës. Linja e jashtme, misioni dhe pushteti, janë korniza që i japin ritëm dhe tension, por nuk janë thelbi. Pa përplasjen e saj me vetveten, trilleri politik do të ishte thjesht lojë; është konflikti i brendshëm që e bën historinë të gjallë e të dhimbshme dhe, shpresoj, edhe të pashlyeshme.

Xhoina: Tanimë dua të kaloj te një fushë tjetër juaja që e zotëroni siç i ka hije: përkthimi. Përkthimi i Dostojevskit është konsideruar shpesh si një stërvitje morale. Kur nisët punën me katër titujt “Krim dhe Ndëshkim”, “Idioti”, “Net të bardha” dhe “Shënime nga nëndhesa”, që janë botuar së fundmi nga shtëpia botuese “Pema”, cila ishte sfida që ju paralajmëroi se nuk do të ishin përkthime të zakonshme? E them këtë, duke marrë parasysh vështirësinë e një autori të tillë, por edhe faktin që janë përkthyer edhe më parë (disa herë) në shqip. A synohet unifikim, freskim apo rivlerësim i tekstit me këto botime të reja?

Agroni: Fakti që veprat e Dostojevskit janë përkthyer edhe më parë, nuk është arsye të mos përkthehen sërish në të ardhmen. Shpesh, në përkthimet tona ndodh që të mos na vijë gjenia e shkrimtarit të madh, por “morgu” me emrin e tij dhe shpesh me shtrembërime qysh në tituj. Në kulturat e mëdha, Dostojevski njeh, deri më sot, nga 20 deri në 25 përkthime. Gjuha jonë me shtrirje më të ngushtë mbërrin deri në 2-3 përkthime. Po arsyeja e vërtetë pse e kisha synim të hershëm përkthimin e Dostojevskit, përveç vlerësimit të jashtëzakonshëm që kam për të si kryeshkrimtar, ka qenë rutina e përditshme e kohës së studimeve të mia në Institutin e Letërsisë “Gorki”, më saktë, orët e Teorisë dhe Praktikës së Përkthimit ku duhet të krahasoja autorët rusë në përkthimet shqipe me origjinalin krahas. Jam marrë dhe me Dostojevskin. Ajo çfarë është sjellë në shqip, nuk është sintaksa e Dostojevskit. Sfida është të sjellësh në shqip sintaksën, fizionominë stilistike të Dostojevskit, diafragmën e plotë të fjalisë me gjithë valën e saj të ethes epileptike, pa e copëtuar fjalinë në fjali të shkurtra, duke e lënë “të marrë frymë me diafragmë të qetë”. Sepse nuk është ashtu në origjinal. Leximi elitar kërkon të shijojë sot stilin, jo përmbajtjen, fabulën. Shpesh, në dëshirën për ta bërë shqipen të rrjedhshme e “të bukur”, “të thjeshtë”, përkthyesit e kanë shpërbërë atë vorbullën të tekstit origjinal. Nëse Dostojevski shkruan një fjali që zgjat një paragraf të tërë apo një faqe, ku mendimet përplasen, ku ka thonjëza brenda thonjzash dhe ku njeriu i nëndhesës ndërron mendje tri herë brenda një pikë-presjeje, kjo nuk është paaftësi stilistike: është *fiziologjia e mendimit*.

Edhe në Euroamerikë ka mbisunduar gjatë “shkolla e lëmimit” të Dostojevskit, e cila e kishte kthyer Dostojevskin në një lloj kloni të Balzakut apo Viktor Hygosë, duke i dhënë një elegancë frënge që autori rus nuk e kishte pasur kurrë. Mirëpo përkthimi i ri i Dostojevskit nga André Markowicz pas viteve 1990, i skandalizoi qarqet akademike dhe u ndien të fyer nga një Dostojevsk krejt tjetër. Frëngjishtja klasike prirret drejt qartësisë dhe ekuilibrit (*Cartesian logic*). Markowicz e theu këtë. Ai e *përdhuno*i frëngjishten për ta detyruar të ndiqte thyerjet, pasthirrat dhe ato diafragmat e gjata epileptike për të cilat folëm. Edhe qëllimi im është jo të habis lexuesin me gjetjen e fjalëve të stërvjetëruara, të pluhurosura si nga fonderia e përkthimit të qëmotit, por të jem besnik e riprodhues i stilit të Dostojevskit me një sintaksë që nuk rrjedh, por që *shkumon*. Sepse Dostojevski i vërtetë nuk flet me gjuhën e salloneve të Parisit, por me gjuhën e rrugëve të Shën Petërburgut, të

pijetoreve dhe të katorgës. Duhet sjellë një regjistër gjuhësor *i pistë*, plot zhargone, fjalë të vrazhda dhe strukturë bisedore, duke e zhveshur autorin nga *shenjtëria* artificiale e një klasiku të ngrirë. Vetëm kështu vepra e tij shijohet, dhe risjellja i shërben rimarrjes, shpërnguljes së diskursit të dikurshëm, në një plan filozofik e artistik bashkëkohor.

Xhoina: Dostojevski ka një ritëm të çrregullt, shpesh kërcen mes mendimit filozofik, delirit dhe realitetit të ndyrë të jetës ruse. Si e ruani këtë *ndërprerje elektrike* të stilit në shqip pa e bërë tekstin të duket i paqartë ose i keqrenditur?

Agroni: Sekret, sipas meje, qëndron te faktit se *paqartësia e personazhit nuk duhet të bëhet paqartësi e përkthyesit*. Për ta ruajtur këtë ndërprerje elektrike, pa e kthyer tekstin në një lëmsh të pakuptueshëm, përdor disa teknika specifike: Sintaksa si “Sizmograf”. Në shqip, kjo arrihet duke ndjekur me besnikëri pikësimin emocional të Dostojevskit. Ai përdor shpesh pikëpresjet, dy pikat, dhe mendimet që hapen si kllapa brenda kllapave (efekti matrioshkë).

1. Teknika: përkthyesi nuk duhet ta *sistemojë* fjalinë sipas rendit logjik (Kush? Çfarë? Ku?). Ai duhet ta lërë fjalinë të derdhet ashtu siç vjen deliri: me ndajfolje që nguten të uritura, me përemra që ngatërrohen. Qartësia nuk vjen nga rregulli gramatikor, por nga saktësia e tonit. Nëse toni është i duhuri, lexuesi e kupton se kaosi është i qëllimshëm.

2. Ruajtja e *artikulimit* të brendshëm: Dostojevski është mjeshtri dhe sajuesi i parimit narrativ që quhet polifoni. Brenda një paragrafi mund të kesh tri zëra: zërin e autorit (shpesh ironik), zërin e personazhit (në delir) dhe zërin e ndërgjegjes (filozofik). Teknika: shfrytëzoj pasurinë e sinonimeve të shqipes. Për realitetin e ndyrë përdor një shqipe të vrazhdë, pothuajse eshtërore, ndërsa

kur kërcen te filozofia, regjistri ngrihet në një shqipe më abstrakte e më solemne. Ky kalim i shpejtë mes regjistrave krijon atë shkëndijën elektrike që ndien lexuesi.

3. Përsëritja si tension, jo si gabim: ithtarët e *lëmimit* i fshijnë përsëritjet. Por te Dostojevski, kur një personazh përsërit pesë herë të njëjtën fjalë, ai po tregon një obsesion psikologjik që kalëron drejt ankthit. Duke i mbajtur këto përsëritje në shqip, krijohet një lloj stërpikjeje sonore. Lexuesi fillon të ndihet i shqetësuar, ashtu si personazhi. Kjo e bën tekstin të duket i keqrenditur, vetëm për sytë e një gramaticieni të ftohtë e pedant, por absolutisht të saktë për mendjen e një lexuesi që kërkon të vërtetën njerëzore.

4. *Diafragma* e hapur: siç e diskutuam, mbajtja e fjalisë së gjatë (vorbullës) pa e këputur, shërben si një rrymë elektrike. Nëse e ndërpret rrymën me pika të shpeshta, voltazhi bie. Duke e mbajtur diafragmën hapur, përkthyesi lejon që deliri dhe filozofia të bashkëjetojnë brenda së njëjtës frymëmarrie.

Xhoina: A ka çaste kur mendoni se Dostojevski nuk mund të shqipërohet plotësisht, dhe nëse po, cilat pjesë të tij ju duken të pamundura për t’u transmodeluar pa humbje? Përkthimi i klasikëve të mëdhenj rusë në shqip gjithmonë ka krijuar debat mes shqipërimit kreativ dhe besnikërisë së ftohtë. Ku pozicionoheni ju në këtë dilemë për Dostojevskin, i cili vetë është në teh të thikës: brutal dhe poetik, filozofik dhe vulgar njëkohësisht?

Agroni: Jam përkthyes i teksteve tejet të vështira të ligjërimit më të epërm artistik, siç është poezia. Të përkthesh Pushkinin, Tjutçevin, Majakovskin, Mandelshtamin, Eseninin, Ahmatovën, Cvjetajevën, Pasternakun, Brodskijn, Sjedakovën etj, etj., parimisht mund të përkthesh gjithçka,

përpos poezinë e ekzegezës së kubofuturistit Velimir Hljebnikovit, fjala vjen. Nuk kam pasur vështirësi me përkthimet e Nikollaj Leskovit, L.N. Tolstoit, Zamjatinit, Bullgakovit, me përjashtim të Platonovit. Dostojevski është pa dyshim shkrimtari absolutisht më i vështirë për çdo përkthyes, në çdo kulturë letrare. Përveç veprave të botuara tashmë nga shtëpia botuese “Pema” dhe që ju i përmendët, kam përkthyer dhe janë në proces romanet e vëllimshëm “Demonët”, “Adoleshenti” dhe “Vëllezërit Karamazov”. Tani po vijoj përkthimin me “Shënime nga shtëpia e vdekur” (kurrësi jo “Shënime nga shtëpia e të vdekurve”, siç e kanë ves ta përkthejnë me dashje gabim, a thua se Dostojevski nuk ishte vetë në gjendje ta shkruante ashtu titullin). Besoj se më i vështiri për përkthim ka qenë “Adoleshenti”, kur fragmentariteti dhe turbullira psiko-gjuhësore e tij është gjuhë e traumës. Mendoj se ka dy vepra shumë të vështira për t’u sjellë në shqip ashtu si duhet dhe këto janë novelat “Shtëpiakja” (ose “Zonja e shtëpisë”) dhe “Kipci”, i përkthyer më parë në shqip “Sozia”. Pse “Kipci” dhe jo “Sozia”? Sozia është një fjalë me origjinë nga mitologjia greko-latine (personazhi Sosia te Plauti), që ka hyrë në shqip kryesisht përmes frëngjishtes. Ajo tingëllon disi sterile, letrare dhe e jashtme. Kipci vjen nga brumi i lashtë i shqipes (nga rrënja *kip/këput*), që do të thotë një shëmbëlltyrë e prerë, një kopje identike që këputet nga origjinali. Te kjo novelë, personazhi Goljadkin nuk ka thjesht një ngjashmëri me dikë tjetër. Ai pëson një çarje psikike. “Kipci” përcjell një ndjesi më organike, më makabre dhe më popullore të asaj që rusët e quajnë *Dvojn*ik. Është diçka që ka dalë prej teje, një tjetër *ti* që të përndjek. Vështirësia ka të bëjë me *ritmin belbëzues*: Goljadkini flet me vete, ndërpret fjalinë, përsërit të njëjtat fraza dhjetëra herë (“unë për vete”, “nejse”, “në rregull”, “ashtu është”). *Artikulimi i dyzuar*: përkthyesi duhet të ruajë një ekuilibër të tmerrshëm: teksti duhet të jetë i lexueshëm, por duhet të transmetojë ndjesinë e një truri që po shpërbëhet. Nëse e *lëmon* Goljadkinin, ai pushon së qeni i çmendur dhe bëhet thjesht një personazh komik. Ndërsa novela “Shtëpiakja” ka një atmosferë të turbullt. Kjo është novela më gotike dhe më romantike e Dostojevskit. Ka një gjuhë plot imazhe mistike, përrallore ruse dhe një erotizëm të mbytur. Është vepër që nuk e di pse më prek pa masë; çdo herë e lexoj me një përjetim të ndryshëm, gjithsesi, të dalldisur. Ç’është e vështirë të kjo vepër? Sfida e Riformësimit: gjuha këtu është e dendur, pothuajse si poezi në prozë. Ajo kërkon një shqipe që ka ngjyrat e të kuqes së errët, të dritëhijeve të ikonave ruse. Të përkthesh këtë vepër do të thotë të glesh një shqipe që është e turbullt, por magjepsëse, ku kufiri mes ëndrrës dhe realitetit humbet. Prandaj e kam shtyrë përkthimin e këtyre dy veprave për në fund.

Xhoina: Profesor Tufa, vendimi juaj për t’u larguar nga Shqipëria dhe për të kërkuar azil politik u perceptua si një moment i rëndë për shoqërinë shqiptare, sidomos për ata që e panë si provë të mungesës së sigurisë për intelektualët dhe studiuesit e së shkuarës totalitare. A mund të na çoni në brendësi të atij procesi? Çfarë ndodhte paralelisht publikisht dhe privatisht, çfarë lloj presioni psikologjik, institucional apo mediatik po përjetohej, dhe cilat ishin shenjat se situata po degradonte në një pikë pa kthim?

Agroni: Këtu, Xhoina, rrezikojmë që vëmendja e kuvendimit tonë të shkëputet nga objekti i letërsisë dhe të shkapërcejë në biografi. Dhe ju e dini se si publiku ynë i braktis gjërat më serioze për një grimë kuriozitet. Po, pati një trishtim solidar të elitës kulturore për largimin tim të papritur nga atdheut, një trishtim të një përmase që nuk ma merrte mendja, jo vetëm të njohur, por njerëz që i njihja vetëm si emra, nga të katër anët e botës. Ime shoqe, Elvana, numëroi mbi tre mijë faqe shkrimesh e reagimesh në media e rrjete sociale.

Brenda konceptit të koprracisë së ndershme, do të them shkurt, se qentë e tërbuar të diktaturës duheshin vaksinuar fill



pas rënies së regjimit të tyre; por, në mungesë të ndëshkimit me drejtësi, sipas hakut, të lireshin së paku të themelonin kolonitë e tyre private, pa pasë të drejtë të përziheshin me ne, të shpërndanin virusin e tyre të tërbimit mes nesh, në sferën publike dhe shtetërore. Fatkeqësisht kështu nuk ndodhi, andaj i kemi mes nesh - cerberë të çdo ferri të pushtetit të politikës dhe narkotrafikut, ndërmjetës të çdo lloj krimi, plaçkitjeje e poshtërsie. Fabula është e shkurtër: ata, siç e përmendët, nuk donin të rrëmohej e kaluara e tyre kriminale, të bëhej e dukshme. Sipas tyre dhe shefave që i drejtojnë, ata thonë: “Nëse doni të studiohet periodha e komunizmit, le të bëhet, por pa dëshmi, pa dokumentr arkivash, pa emra të përveçëm.” Dhe në fakt, kjo vazhdon të bëhet “kulturalisht” me disa institucione proqeveritare e të pavarura, shoqata të sponsorizuara, por kurrë, asnjëherë, askush, nuk qe dhe nuk ka qenë ende aq i troçët të flasë konkretisht me emra të përveçëm, me dokumente arkivash, dhe me një projekt ligjor për çmontimin e tyre nga drejtimi i institucioneve shtetërore e publike, dhe ua kam artikuluar në sallë të Kuvendit: është e papajtueshme tejngopja e institucioneve tona demokratike me ish-sigurimsa të rirekrutuar! Një proverb i vendlindjes sime thotë: “Thuaje të vërtetën dhe shko e mbyllu për gjak!”. Po, kërcënimet e vazhdueshme me vdekje, nuk mbetën në nivelin qesharak me të cilat tallesha: kush më mirë se unë i njihte bëmat e atyre ustallarëve të vdekjes? Përgjatë një viti unë hapa 5 procese gjyqësore, kundër shpifjeve, kërcënimeve, fyerjeve. Drejtësi iu dha fyesve dhe kërcënuesve. Iu drejtova Kuvendit, duke e ditur mirë se kryetari ishte Nxitësi. Iu drejtova 14 ambasadave më të forta në Tiranë, por ata heshtën si peshku, gjithnjë pro regjimit. Kush do ta mbronte familjen time? Ustallarët e vdekjes u afruan afër shtëpisë. Edhe kafshët dhe shpezët e kanë instinktin e mbrojtjes së folesë. Më duhej të mbroja fëmijët nga skenarët e tyre a, b, c, d... Kur tashmë ndodhesha në kampin e refugjateve politikë, ata s’e përmbajtën dot mllëfin dhe u përbetuan haptazi, në shtyp, për shpagim, të më gjejnë edhe në Zvicër.

Xhoina: Ju keni përmendur disa herë se në vendin ku ndodhni sot ndiheni më i lirë për të thënë të vërteta *rrëqethëse*. Çfarë nuk mundeshit të thoshit në Shqipëri? Çfarë lloj reagimi ose pasoje ju ndalonte? Dhe si ka ndryshuar zëri juaj publik që prej largimit?

Agroni: “Më i lirë” nënkuptonte jo kufizimin tim, sepse nuk u kufizova dhe nuk u tërhoqa për asnjë çast, por vihej seriozisht në rrezik mbyllja e Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK). Nuk kisha të drejtë që të lija rreth 20 kolegë, kryefamiljarë, pa punë, por dhe pa punën kërkimore dhe dëshmitë, dua të them, që përbënin thelbin e punës së Institutit. Ndërkohë për mbylljen e ISKK-së kishte një grup nismëtar deputetësh që filloi mbledhjen e firmave. Opozitë kishte, jashtë parlamentit sigurisht, dhe e ngordhur, natyrisht. Më vonë, që nga mërgimi kam publikuar dokumente shumë të ndjeshme mbi të shkuarën kriminale të ish-spiunëve, agjentëve dhe hetuesve mizorë nga postet shumë të larta politike e administrative të shtetit (kryeparlamentari Gramoz Ruçi, kreu i parë i SPAK Arben Kraja), deri në kulturë (Nasho Jorgaqi, agjent veteran me pseudonimin “Dragoi”). Por me kalimin e kohës, duke parë mpirjen e nervit shoqëror, mendova të bëj atë, që bën më mirë një shkrimtar: veprën letrare.

Xhoina: Ka njerëz që argumentojnë se shoqëria shqiptare i ka “lënë pas krimet”, se gjenerata e re është e shkëputur nga rrëfimet e vjetra. Po ju këmbëngulni se pa ballafaqim serioz, pa lustra, pa transparencë të dosjeve, një shoqëri nuk emancipohet. Çfarë shihni sot tek të rinjtë shqiptarë: mungesë informacioni, mungesë dëshire për të ditur, apo thjesht mungesë shprese se e vërteta mund të ndryshojë realisht strukturat e pushtetit?

Agroni: Të gjitha nga pak. Të gjitha njëherësh. Çështja e edukimit historik apo botëkuptimor të brezave, nuk bëhet kurrë jashtë institucioneve të ligjshme e të detyruara arsimore. Në këtë fushë, zor se ka njeri më me përvojë se unë. Dhe mungesa e vullnetit politik për të miratuar në kurrikulat e detyrueshme të shkollës dhe gjimnazit të një lënde me titull “Shqipëria nën diktaturën komuniste 1944-1991”, ka sjellë në këtë shpërfillje, injorancë e dembelizëm. Një tekst i tillë në 9-vjeçare dhe gjimnaz, do të bënte që edukimi i brezave të hynte në mënyrë legjitime nga dera ballore e institucionit arsimor, jo nga hyrja e fshehtë, në dorë institutesh e shoqatash. Duhej një tekst i detyrueshëm, i hartuar nga një grup i larmishëm ekspertësh të fushave të ndryshme për të kuptuar se ç’ngjau me shqiptarët, me pushkatimet sipas listave të zeza, pushkatimet dhe dënimet politike, internimet; ç’ndodhi me elitat, tregtarët, pronarët e tokave, klerikët, properendimorët, nacionalistët; ç’ndodhi me luftën e klasave, kulakët, biografitë, familjet e të arratisurve, të përjashtuarit nga Partia; ç’ndodhi me ideologjizimin e gjithçkaje, me zinxhirin arsimor që në fund të tij prodhonte zombi në seri, me perversionin e sodomizimin e letërsisë, folklorit, filmit etj, etj. Të gjitha këto, ia kam paraqitur në një projekt të qarë e të shkoqur ministres socialiste të arsimit, dhe aq e entuziazmuar qe ajo, veçse s’di pse gjithë ai entuziazëm i degradoi në gogësimë... Nuk u bë asgjë. Sepse nuk duan.

Xhoina: Emigrimi shpesh është një akt i dhimbshëm, por edhe transformues. Si e ka ndryshuar ky kapitull identitetin tuaj si shkrimtar dhe si qytetar? A ndiheni më shumë pjesë e Shqipërisë tani që jeni larg saj, apo më i distancuar prej realitetit të saj të përditshëm? Duke e parë nga jashtë, a mendoni se Shqipëria është sot më pranë apo më larg lirisë së vërtetë? Dhe cili është rreziku më i madh: autokritika e munguar, nostalgjia për autoritarizmin, apo indiferenca e re shoqërore?

Agroni: Për mua është i vërtetë ai vargu i Seferisit: “Ngado që shkoj, Greqinë e mbart me vete, si një plagosje”. Zëre se e thashë dhe unë për Shqipërinë, madje duke pasur shumë më tepër arsye edhe se vetë Seferisi ta përjetoj këtë. Nuk ndikon asnjë emigrim apo transmigrim për të ndryshuar sadogrimë identitetin në çfarëdo në labirintin tim të këtushëm; dikur i punoja rrengje vetes për t’i ikur vetëdijesimit kryqëzues se “ti je shkrimtar”; merresha me shumë punë njëherësh, si për ta shurdhuar “të qenit shkrimtar”, a thua se kjo ishte një nga ato barra që mund të shtyhej pak për më vonë. Por pas ikjes sime këtu, nuk dija si të fshihesha më. Isha pa asnjë atribut tjetër, pa studimet dhe punën në terren me dëshmitë, pa auditorin me studentët e mi: unë mbeta thjesht... shkrimtar. Dhe ndonëse shkruaj rrallë, ngase përkthej më shumë, prapë habitem sa shumë kam shkruar. Gjërat, nga sa e si i shoh pas ikjes sime, janë përkeqësuar mizorisht. Shqipëria po rikthehet në epokën e një skllavërie të re, po aq të ndyrë, kërrusëse e shfjytyruese, sa ç’ka qenë komunizmi. Profecia ime mbi të shkuarën është gjithsesi plot shpresë: do të marrë fund shumë shpejt, edhe pse jo pa pasoja, kjo epokë e turpshme, servile e mendjelehtë.

Xhoina: Po e mbyllim këtë bisedë jo me atë që keni thënë e shkruar tashmë, por me atë që ende ju shtyn të shkruani: çfarë është ajo që sot, pas gjithë këtij rrugëtimi, ende ju mban gatitu si shkrimtar? A është një nga ato pyetjet që zor se i gjendet përgjigje, apo veç nevoja për të mos e lënë fjalën të mpaket përballë harresës?

Agroni: Nuk shqetësohem fare në fakt. Një ndër gjërat më absurde më është dukur gjithmonë togfjalëshi “krizë krijimtarie”. Tjetër është të thuash “krizë kohe”. Mua më duket gjithnjë se ende, për rrethana të pasqaruara mirë, nuk kam filluar të shkruaj me gjithë mend, thellë-thellë, i përfshirë mish e shpirt. Por në çdo fillim të ri, më duket vetja për turp, i pasigurt.



**Bustina e Kamomilit është një rubrikë joperiodike e shqyrtimit të disa situatave, prej shqetësimit të të cilave shpëtoj vetëm pasi t’i kem shkruar.*

TIRANIA E THONJËZAVE

Andreas Dushi

Të qenurit politikisht korrekt mbetet, akoma sot, një prej sfidave më të mëdha me të cilat përballet nevoja për të qenë të lirë. Komedianët, sidomos pas vitit 2020, e kanë humbur mundësinë e shakave me disa situata të cilat, ndonjërin, mund ta lëndojnë. Edhe në fushat e tjera, gjithëpërfshirja ecën krahpërkrah me mbrojtjen e hiperndjeshmërisë jo vetëm të çdo shtrese sociale, por edhe të çdo individi personalisht. Parakusht i lirisë është kthyer korrektesa, çka shprehjen e Lincoln-it se liria e tij mbaron aty ku fillon liria e tjetrit e ka ndryshar në liria ime fillon aty ku mbaron ndjeshmëria e tjetrit. Dimensioni i tretë, ai i thellësisë, po humbet pasi çdo turjelë rrezikon të gërvishtë sipërfaqen emocionale të dikujt, çka vetëvetiu sjell linçimin publik të ofenduesit, falë keqkuptimit më të madh të demokracisë: ngatërresës mes të drejtës së shprehjes, pra të opinionit, me të drejtën e sharjes dhe, akoma më tepër, të akuzimit. Dhe këtu është rasti, mbase, të kujtoj një koment Facebook-u. Njëra shkruante se ishte e bindur që libri “flan” ishte përkthyer keq, para se ta vazhdonte me fjalinë e dytë, **por ndoshta duhet ta lexoj më para**. Ky ngut për të dhënë një mendim mbi një objekt që nuk e njeh është fenomeni fantastik i shqiptarit bashkëkohor të rrejteve sociale, ose homorete-sociale-albanicusit.

Për të dalë nga ky labirint, nga ky sokak qorr, kushdo ka dashur t’ia dijë, është përpjekur të përdorë mjetet e veta. Dikush nëntekstin, një tjetër ironinë, sarkazmën ndoshta e kështu me radhë. Ndërsa shqipja, prej vitesh, ofron një metodë të thjeshtuar: thonjëzat. Fjala, kur thuhet me atë kuptim që vërtetë synon t’i jepet por, në të njëjtën kohë, duke mbartur atë kuptim rrezikon të fyejë a lëndojë dikë, futet brenda thonjëzave, si të ishte një trup i vdekur që është marrë nga diku, i ngrirë, i paprekshëm, për t’u përdorur në kontekstin e caktuar, pa e njollosur as fjalinë ku zë vend, as autorin e saj.

Thonjëza pra, në shqip, mes sa e sa përdorimesh, mundëson edhe një qasje puritane, korrekte, jo më të ftohtë, pra objektive, por të ngrirë, thua se ai që e përdor nuk ka asnjë mundësi tjetër ta ofrojë fjalën përveçse mes atyre thonjëzave, që të përdorura vend e pa vend, gjithnjë e më shpesh, të ngecin në fyt, si të ishin guralecë të fshehur në një tas hashureje që, kur gabimisht i përtyp, të thyejnë të paktën dy dhëmbë. Dhe, kur rastis ta lexosh me zë fjalinë – fole të fjalëve në thonjëza, duhet të ngrish krahët, të përthyesh bërrylat, të zgjasësh dy gishta të secilës dorë në dy anët e kokës tënde dhe, të mbledhësh e të hapësh nyjat e atyre gishtave, për ta bërë edhe vizualisht të dukshme se fjala që po shqipton është në thonjëza, por shqiptimi është një akt tingullor, pra që perceptohet nëpërmjet shqisës së dëgjimit, ndërsa tërë kjo çka shpjegova, akt pamor, pra që perceptohet nëpërmjet shqisës së të parit. Ky konfuzion pra, mund ta bëjë dikë të mendojë se folësi a lexuesi, në fakt, po fut kokën e vet brenda thonjëzave, çka nuk do të ishte gabim, por përkundrazi, do të kishte kuptim, sepse ajo fytyrë që fshihet pas thonjëzave, është një fytyrë e rreme që meriton të jetë në thonjëza.

Jam i sigurt se ky përdorim përherë e më i gjerë i thonjëzave është një formë e *cancel culture*-s, sepse fjala druhet ta shprehi hapur atë vlerë kuptimore që thënësi a shkruesi i saj i ka dhënë, ndaj detyrohet të vishet me petkun e korrektesës së thonjëzës, duke e bërë paraprakisht të qartë se ka rreth vetes një pelerinë mbrojtjeje, pas së cilës ajo nuk jeton, pelerinë e tejdukshme, si xhami i një morgu.

Çmimet Kombëtare të Letërsisë 2024, nuk u dhanë si më parë, për të gjitha gjinitë, për poezinë, për tregimin, për romanin, për letërsinë për fëmijë dhe për përkthimin letrar, jo! krejt papritmas, pa vënë në dijeni paraprakisht autorët, botuesit, publikun ato u mpakën vetëm në tri kategori.

Së pari, sivjet Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit nuk dha një Çmim për poezinë shqipe të shkruar gjatë vitit 2024, si kategori më vete. Ndër dekada, me Çmimin Kombëtar për Poezinë janë vlerësuar poetët Entela Tabaku (2023), Olimbi Velaj, (2022), Visar Zhiti (2021, 1993), Bardhyl Londo (2020), Alisa Velaj (2019), Havzi Nela (2018), Rudolf Marku (2012), Rudian Zekthi (2011), Arian Leka (2010, 2004), Vilson Blloshmi (2009), Preç Zogaj (2008, 1999), Luljeta Dano (2007), Ali Podrimja (2005), Sokol Zekaj, (2003), Dhimitër Pojanaku (2002), Gentian Çoçoli, (2001), Luljeta Lleshanaku (2000), Sadik Bejko (1998), Ledia Dushi (1997), Xhevahir Spahiu (1994), listë e cila nuk është e plotë. Të gjithë këta poetë janë nderuar për veprën e tyre poetike në vitin përkatës sepse ky çmim jepej më vete për gjininë e poezisë.

Natyrish, ne kemi disa breza autorësh që shkruajnë dhe botojnë poezi sot, përse tani e më pas qenka e tepërt që një libër poezi në vit të shenjohej ndër të gjitha botimet e tjera?

Librat poetik, le ta theksojmë, pranohen nga fare pak librari, më së shumti refuzohen. Përballë këtij refuzimi, dhe diktati të tregut, janë disa botues të cilët bëjnë një sakrificë që meriton nderimin më të lartë duke botuar libra me poezi të autorëve shqiptarë, duke organizuar takime paraqitëse nëpër panairë të librit, dhe më pas, duke u rrekur për t'i dhënë kësodore peshë artit të fjalës poetike dhe poetëve në mjedisin letrar. Zhdukja e pranisë së poetëve nga prania publike e vlerësimit të prurjeve letrare të një viti është një veprim shkurajues për këta botues, për librarët, për lexuesit dhe përveçse refuzues, për autorët, ai është në vetvete, kur bëhet papritur dhe papandehur, sipas gjykimit tim, ndoshta edhe fyes. Duhet të kemi parasysh, se ky çmim, ashtu si edhe çmimet për gjinitë e tjera, mbart në vetevete edhe domethënien e vet simbolike, është shprehje e një vlerësimi dhe përkujdesjeje për artin, në këtë rast artin poetik. Braktisja e kësaj tradite të krijuar prej gati tridhjetë vitesh është krejt në kundërshtim synimin për të krijuar një mjedis të mbështetjes dhe vlerësimit të poezisë.

Dhe, meqenëse nuk kemi një kategori më vete për gjininë e poezisë, kategoria e krijuar, ajo e Çmimit të Madh të Letërsisë është kthyer në një çmim "transgjinor" sepse mbart brenda vetes gjininë e poezisë, tregimit dhe romanit. Tani nuk vlerësohet më vetëm vëllimi i mirë poetik kundrejt botimeve të tjera poetike, vëllimi më i mirë me tregime krahasuar me librat e tjerë me tregime, dhe po kështu edhe me romanin, por pasi të jenë përzgjedhur në secilën kategori, ato bëhen bashkë në një kategori "trigjinore" le ta quajmë, për të zgjedhur një libër të vetëm.

Kjo lloj praktike, është vetëm disavjetëshe, dhe sikurse është përdorur për herë të parë në vitin 2006 kur Ministria e Kulturës dha vetëm dy çmime, atë për veprën letrare më të mirë dhe për përkthimin më të mirë, përgjersa është një praktikë prej së cilës u hoq dorë, kjo do të thotë se ishte e dështuar.

Kapërcimi nga vlerësimi për çdo zhanër, e jetësuar për vite e vite më radhë,

ÇMIMET E LETËRSISË 2024: ZHBËRJA E NJË TRADITE BRENDA NJË DITE nga Çmimet Kombëtare është hequr plotësisht drama, është hequr si kategori më vete poezia, është hequr si kategori më vete tregimi dhe po kështu edhe letërsia për fëmijë, nuk mendoj se duhet hequr dorë edhe nga përkthimi letrar

Nga Granit Zela

tek ajo e vlerësimit vetëm të dy zhanreve, dhe pastaj kalimi prapë të çmimet letrare të fundvitit për të gjitha kategoritë dhe pastaj, sërish rikthimi të kjo praktikë ku vlerësohet një libër letrar, një studim dhe një përkthim jolettrar është një tetëhapësh pas, them tetëhapësh, duke pasur parasysh se u zbatuar para tetë vjetësh.

Së dyti, sivjet është hera e parë qysh prej krijimit të Çmimeve Kombëtare Letrare që Çmimi i Përkthimit i jepet përkthimit të një *vepre joletrare*. Po të shohim historikun e paplotë të përkthimeve të vlerësuar me Çmim Kombëtar, asnjëherë nuk ka ndodhur që çmimi për përkthimin t'i jepet përkthimit të një vepre të filozofisë, të estetikës, të teorisë së letërsisë etj etj. Përkthimet e vlerësuar kanë qenë *vepra letrare* si "Daullja prej llamarine", (G.Grass, 2023), "Vjeshta e patriarkut" (G. G. Marquez, 2022), "Njeriu i parë", (Albert Camus, 2021), "Lepur vrapo" (John Updike, 2020), "Iliada" (Homeri, 2019), "Abadoni/Engjëlli i skëterrës" (E. Sabato, 2018), "Armëpushimi" (Primo

Levi, 2017), "Kanali Musolini" (Antonio Pennacchi, 2016), "Robinja" (Marcel Proust – 2015), "Poezi" (Paul Claudel, 2014), "Orlando i çmendun" (Ludovico Ariosto – 2013), "Delfin" (Robert Lowell, 2012), "Nokturne" e Kilit (Roberto Bolano, 2011), "Ishulli i mundshëm" (Michel Houellebecq, 2010), "Mali magjik" (Tomas Man, 2009), "Fausti" (Gëte, 2008), "Tregime të zgjedhura" (Grup autorësh grekë, 2006-2007), "Kujtim kurvash të trishta" (G. G. Marquez, 2005), "Shtatë vëllezërit" (Aleksis Kivi, 2004), "Ulisi" (James Joyce, 2003), "Lumturia e mashtimit" (Hubert Nyssen, 2002), "Poezi botërore" (Odiseas Elitis, 2001), "Armët e fshehta" (Julio Cortasar, 1999).

Kësodore, pasi nga Çmimet Kombëtare është hequr plotësisht drama, është hequr si kategori më vete poezia, është hequr si kategori më vete tregimi dhe po kështu edhe letërsia për fëmijë, nuk mendoj se duhet hequr dorë edhe nga përkthimi letrar për të kaluar tek përkthimi jolettrar, përkthimi i filozofisë, librave të estetikës,



të teorisë së letërsisë, teksteve akademike etj etj., sepse kështu, ato një mijë apo dy mijë botime në vit, që duhet të shohis juria bashkëme dhjetëra kategori të përkthimit jolettrar, ajo jo vetëm nuk ka kohë t'i lexoj, por nuk do të ketë kohë as t'i njëjtësoj si tituj dhe mandej as t'i shfletoj rrëmbimthi.

Së treti, duke mos e publikuar këtë rregullore, askush nuk e di dhe nuk do ta dijë asnjëherë në të ardhmen se si do të procedohet me përzgjedhjen e romaneve, tregimeve, dhe poezive për një çmim të vetëm; askush nuk e di si do të vlerësohet përkthimi letrar; si do të përzgjidhet përkthimi jolettrar apo të dyja bashkë; askush nuk do ta dijë se *kur* dhe *si* parashikohet të ngrihet juria, as nëse lejohet që një anëtar i kolegjiut të QKLL-së të konkurojë për njërin nga këto kategori dhe më pas edhe të fitojë; a lejohet që Ministri i Kulturës, Inovacionit dhe Turizmit apo vetë Drejtori i QKLL-së, cilitodoftë ai apo ajo, të fitojë Çmimin e Madh të Letërsisë? A parashikohet se sa herë mund ta marrë një krijues një Çmim? Fituesi i sivjetshëm i Çmimit për Përkthimit e mori per herë të pestë këtë vlerësim, pasi është vlerësuar në vitin 2019 (libër me tregime), në vitin 2014 (për përkthimin e një libri me poezi), në vitin 2009 (libër me tregime), dhe në vitin 2007, për përkthimin e një libri me poezi. Kemi një autor tjetër që deri tani e ka fituar pesë herë gjithsej Çmimin Kombëtar, a parashikon ndonjë kufizim rregullorja e re? A mundet që një autor deri në fund të jetës ta fitoj, le të themi, tetë apo dhjetë herë?

Pa e publikuar rregulloren, askush nuk do ta dijë as nëse është etike dhe e lejueshme që një anëtar jurie sivjet të konkurojë dhe të fitoj vitin tjetër; - praktikat e këqija të çmimeve letrare gjatë, kanë treguar se është bërë rrokadë, fituesi i sivjetmë është përfshirë në juri dhe anëtar i jurisë së vjetme ka dalë si fitues një vit më pas, a e lejon këtë rregullorja e re? A e lejon që familjari i njërit prej anëtarëve të jurisë të marrë çmim po atë vit që bashkëshorti apo bashkëshortja është në juri? Si e shmang rregullorja konfliktin e interesit, parashikohet një deklaratë e secilit prej anëtarëve të jurisë? A reflekton ajo praktikat më të mira në këtë lëmë apo lë shteg për interpretime abuzive? A kërkon dhe a e bën rregullorja të detyrueshme transparencën me publikun?

Dhe së fundi, duke pritur që kjo rregullore të publikohet, le ta pranojmë se duke e vënë jurinë e sivjetme para një rregullore të re, (para një fakti të kryer), dhe duke i mpakur Çmimet e Letërsisë vetëm në tri, është jetësuar zhbërja brenda një dite e një tradite të krijuar mbi njëzet vite, traditë e cila edhe pse e papërsosur, nuk mendoj se duhej rrudhur e rroposur.

Letërsia e kohës tonë të “Lirisë së Shprehjes” në Shqipëri ende nuk ka prodhuar aq vepra sa të denoncojnë, sa dhe siç duhet, barbarinë e regjimit komunist, ashtu siç e bën me mjeshtëri të plotë Miranda Haxhia në librin e saj *Vaji i Gurit*.

Në gjurmët e autorëve si Visar Zhiti, Pjetër Arbnori, At Zef Pllumi e të tjerë, ajo sjell një histori të vërtetë që përfshin katër breza shqiptarësh të familjes Alizoti, të cilëve regjimi mizor enverist ua shkatërroi jetën.

Autorja ka zgjedhur një teknikë rrëfimi të veçantë:

Heroi, Riza Alizoti, na e tregon “vetë” historinë, pasi e kanë varur në litar dhe e kanë hedhur në hon, pa të drejtën që, të kishte një varr. Ai “flet” nga përtejvdekja për të dëshmuar krimin e kryer ndaj tij dhe familjes së tij, para, por edhe shumë kohë pas vdekjes

Në historinë e letërsisë botërore ka pak vepra ku ai që rrëfen në vetën e parë është “i vdekur”. Shembujt më të njohur janë romani *“Kockat e bukura”*, shkruar nga Alice Sebold, ku rrëfimtari është Susie Salmon, e vrarë, e cila nga “parajsa” e saj ndjek dramën e familjes. Te romani *“Hajduti i librave”* i Markus Zusak, ngjarja zhvillohet në Gjermaninë naziste dhe “tregohet” nga vetë Vdekja. Ndërsa William Faulkner, në Librin e tij *“Tek po jepja shpirt”*, sjell një personazh që “flet” edhe pasi i ka mbyllur sytë përgjithmonë.

Libri *Vaji i Gurit* i autores Miranda Haxhia mund të rreshtohet denjësisht pranë këtij modeli të letërsisë botërore. Rrëfimi që vjen nga “zëri” i largët i të vdekurit i jep veprës një forcë tragjike, tronditëse dhe dëshmuuese të jashtëzakonshme.

Tragjedia e *Vajit të Gurit* zë fill me jetën e Riza Alizotit, një i ri i arsimuar në Angli në vitet ’30 të shekullit të kaluar. Ai kishte studiuar për industrinë e naftës me bursë të Mbretërisë Shqiptare. Bir i Fejzi Alizotit, këtij patrioti shtetformues shqiptar, Rizai ishte rritur në një familje me parime të forta patriotike, morale dhe qytetare.

I pajisur me ëndrra, idealizëm dhe dashuri të thellë për vendin e tij dhe për profesionin e inxhinierit të naftës, ai zgjedh të braktisë jetën e rehatshme në Anglinë e Gjellbër për t’iu përkushtuar me mish e me shpirt shërbimit ndaj atdheut.

Romani “Vaji i gurit” i autores Miranda Haxhia

Monument kujtese për një familje fisnike që u gjymtua nga diktatura

Nga Mal Berisha

Ai sakrifikoi dashurinë e ëmbël dhe martesën me anglezen Kathleen për hir të detyrimit ligjor, moral dhe patriotik që kishte dhe ndiente ndaj vendit të tij, Shqipërisë. Njësoj si në thënien e Shandor Përtefit: “Për dashurinë jap jetën, por për atdheun e jap dashurinë”, ai zgjodhi ta linte Kathleen – en bashkë me dy fëmijë dhe të kthehej në atdhe.

Pas brengës së thellë të shkaktuar nga ndarja me anglezen Kathleen, erdhi edhe dhimbja për humbjen tragjike të djalit të tij, i mbytur aksidentalisht në ujërat e lumit Tamiz, si dhe ndarja me vajzën e mbetur atje pa baba; megjithatë, jeta i dhuron Rizait një mundësi të re.

Ai njihet dhe bie në dashuri me Vera Ypin, një zonjushë e fisnikërisë shqiptare, e rritur në një jetë mondane në Milano, e cila zgjedh ta lërë pas atë botë për dashurinë dhe jetën me Rizain në Kuçovë. Ata ndërtojnë një familje të bukur dhe sjellin në jetë tre fëmijë, jeta e të cilëve do të shndërrohej më pas në një tmerr të vërtetë.

Kështu, gjithçka ndryshoi menjëherë sapo komunistët erdhën në pushtet në Shqipëri, në vitin 1944. Babai i Rizait, Fejzi Alizoti, një figurë atdhetare dhe shtetformuese, së bashku me shtatëmbëdhjetë patriotë të tjerë, u ekzekutua në Kodrën e Priftit, në Tiranë, në natën e zezë të 13 prillit 1945.

Saga vijon menjëherë pas këtij akti: burgoset djali i tij i madh, Hasani, i cili, ndonëse kishte shpëtuar qindra partizanë nga vdekja gjatë pushtimit nazifashist, vuajti

thjesht sepse ishte i biri i Fejziut.

Në këto rrethana, jeta e re dhe e bukur familjare që Rizai kishte ndërtuar me Verën, e mbushur me dashuri dhe punë për vendin, u shemb përpara syve të tyre. Fill pas babait të pushkatuar dhe vëllait të burgosur politik, erdhi edhe arrestimi i tij.

Ai akuzohej se paskësh pas qenë “spiun amerikan” që në fëmijëri, kur ndiqte studimet në “Kolegjin Robert” në Stamboll, si edhe për antikomunizëm, në një kohë kur komunizmi ende nuk kishte lindur as në Moskë, përpara Revolucionit të Tetorit të vitit 1917.

Me këto akuza kaq absurde, ai, pikërisht në ditëlindjen e tij, më 10 dhjetor 1947, u var në një degë lisi, në mes të Kuçovës. Bashkë me të u ekzekutuan edhe përfaqësuesit më të shquar të inteligjencës dhe profesionalizmit të atij brezi shqiptarësh, të diplomuar në universitetet më të mira të Evropës. Trupi i tij u zhduk përgjithmonë.

Pas varjes në litar të Rizait (rrëfimtari të vdekur të kësaj tragjedie, në penën e Miranda Haxhisë), vijoi kalvari i shkatërrimit dhe i zhdukjes së asaj familjeje. Shtëpia iu sekuestrua, e shoqja, Vera, u internua, ndërsa tre fëmijët gjetën strehë të përkohshme te njerëz të afërm. Internimi dhe uria goditën edhe engjëjt e vegjël: Nezin, Viminin dhe Xikun e vogël (Fejziun e Ri), i cili përfundoi në kampin famëkeq të Tepelenës.

Madje, edhe kur fëmijët u përpoqën të ndërtonin jetën e tyre, regjimi nuk ua lejoi këtë. Dashuritë e tyre, sa herë që guxonin të



lindnin, shkatërroheshin në emër të ‘luftës së klasave’. Nuk vonoi shumë dhe po ato pranga që kishin shtrënguar dikur duart e gjyshit, xhaxhait dhe babait, kërcitën edhe në duart e Fejziut të Ri, të sapomartuar. Ai u akuzua se ‘punonte për shërbimet e huaja angleze’!?

Vera Alizoti-Ypi, gruaja që i përjetoi të gjitha këto vuajtje, në vitin 1971 u përball me kancerin, armikun e saj të fundit. E shpallur ‘armike e klasës’, diktatura komuniste e përzuri nga spitali në gjendje terminale. Ky vendim u mor nga zëvendësministria Vera Ngjela, me pretendimin se shteti ‘nuk i kuronte armiqtë e popullit’. Më vonë, për ironinë e fatit, edhe vetë persekutorja, Vera Ngjela, do të përjetonte persekutim, por vetëm pasi kishte kryer akte të tilla antinjerëzore.

Vera, e mjerë, ndërroi jetë vetëm një ditë pas dëbimit nga spitali dhe u varros aty ku ishte e internuar, e përcjellë vetëm nga i vëllai dhe një kosovar fisnik, banor i Bashkovës.

Vetëm pas rënies së diktaturës, falë atij kosovari, u gjetën eshtrat e saj dhe pasardhësit i “dhuruan” një varr të denjë ku të prehej.

Në fund të kësaj sage tragjike, që rrëfen krimin shtetëror komunist të kryer mbi elitën shqiptare, mbërrimë te Tomorr Alizoti, i mbijetuari i familjes, diplomat dhe deputet i Parlamentit Shqiptar. Ai është një figurë publike e pajisur me dije, kulturë, dinjitet dhe urtësi, që sot mban me vete dhimbjen dhe kujtesën e brezave të persekutuar, të vrarë, të varur në litar, të zhdukur, të burgosur, të internuar e të keqtrajtuar pafundësisht dhe padrejtësisht. E vetmja pasuri që ata i lanë dhe që pushteti nuk ua mori dot ishte:

Morali dhe dinjiteti i lartë shqiptar dhe njerëzor.

Ky libër është një monument kujtese për një familje fisnike që u godit, u gjymtua dhe u sakrifikua nga diktatura më çnjerëzore që njohu Evropa Lindore. Në fakt, është një thirrje për kujtesë e për drejtësi. Prandaj vepra e Mirandës duhet të njihet gjerësisht, jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga bota. Ajo ka sjellë në letërsinë tonë një vepër që dëshmon, edukon dhe ngre zërin kundër barbarisë, e cila synon edhe sot të vrasë kujtesën.

Nëse ky libër do të ishte përkthyer në gjuhë të huaja dhe do të kishte pasur shanset që kanë pasur libra me histori krejt më të thjeshta, por që kanë marrë dhenë dhe i kanë “habitur perëndimorët” me mungesat elementare të shqiptarëve, e jo me këtë lloj tragjizmi pa fund, ky libër pa dyshim do të renditej ndër veprat më të fuqishme letrare, të mbështetura në histori të vërteta të kohës së diktaturës komuniste në Shqipëri.

Përveç përmbytjes rrëqethëse, stilit të të shkruarit dhe emocionit që të shkakton në çdo faqe, vepra ka edhe një element të veçantë: përdorimin e një numri fjalësh shumë rrallë të përdorura në gjuhën e sotme shqipe.

Harresa e së keqes hap rrugën për përsëritjen e saj, siç po ndodh sot, fatkeqësisht, në Shqipërinë tonë të dashur.

Le të mos jemi të detyruar të rrëfejme nga varri, si Riza Alizoti, sepse atëherë do të jetë shumë vonë. Koha është tani, pikërisht tani.



E vërteta dhe romani janë bashkë, aq sa e vërteta është roman dhe romani është i vërtetë, teksa fantazia e jetës me fantazinë e shkrimtarit pleksen për të dhënë një vepër kujtese, por letërsia e tillë është e gjithë, kujtesë e bukur, do të thosha.

Pashko R. Camaj, pas botimit të librit autobiografik *Porosia e kullës* nga “Onufri”, ku rrëfeu “jetën e tij nga fillimi e deri aty ku është sot, një doktor në shkencat shëndetësore dhe funksionar i rëndësishëm në shtetin e Nju-Jorkut”, siç shkruan në parathënie shkrimtari Besnik Mustafaj, siç duket ndjeu së brendshmi të rrëfejë tani për të tjerë, që janë si vetet tona të tjera veçanërisht në letra. Por më shumë se aq, të mbartë edhe “brengën” e tyre.

Ai i beson rrëfimit, të vërtetave që mbart si një kulturë që mbase mitikisht i erdhi si frymë dhe fjalë nga odat e burrave në kullat e malësorëve shqiptarë atje në Mal të Zi, nga lutjet e nënave, nga eposi i rapsodëve ballkanikë e deri edhe te metropoli amerikan që është plot me befasi dhe habira metamorfozash domethënëse, me lajme dhe art të madh.

Gjithsesi, autori ndjeu se i duhej tashmë rrëfimi nga Shqipëria, ku ai, edhe pse nuk ka jetuar atje, e ka në gjak, në psikikë si porosi, si fantazi dhe kronikë, qoftë edhe e pashkruar ajo, si dhembje dhe legjendë, si një kthim kolumbian për të zbuluar jo Amerikën, por dheun amë.

Nëse në veprën e mëparshme kujtimet e doktor Pashko R. Camajt u “lexuan si një roman”, tani ai sjell një “roman që do të lexohen si kujtime”, me retrospektivat e munguara.

Duket se më e rëndësishme për doktorin është rrëfimi, jo vetëm si një dëshirë, por edhe si një domosdoshmëri, si një dëshmi, duke e parë edhe si ndërgjegje, pastrim të saj edhe te personazhet, që të merret ajo forcë shpirtërore për të mos u përsëritur mëkatet dhe më lart akoma, si një pajtim hyjnor i vetveve me qiellin. Kështu, për të ndihmuar jo vetëm me profesionin e vet si doktor i shëndetit publik, por edhe si shkrimtar, që, edhe pse nuk janë e njëjta gjë, ngjajnë a mbase janë. Dhe mënyrë e mirë, më sipëranja shpirtërisht do të ishte një rrëfim i gjatë, tronditës, një roman tjetër.

Pastaj rafinaturat romanore, ashtu si stili, vijnë vetvetiu. Po a kërkohen a veç duhet t'i kesh? Po është edhe kujtesa mahnitëse e leximeve, por edhe arkivi digjital... Rëndësi ka lexuesi.

Dhe Pashko R. Camaj vazhdoi si më parë, shkroi në anglisht romanin *When Eagles Cry*, që në shqip e nxjerr prapë “Onufri”, me kujdesin dhe përkushtimin e themeluesit të saj, Bujar Hudhrit.

Një brengë në dy rrugë

Në romanin *Brenga* të Pashko R. Camajt janë dy rrëfime paralele... me një si hijezim përsipër, si të asaj pemës së gështenjës të vendlindjes së personazheve.

Janë dy shokë, djem të rinj që kujtonin se nuk do t'i ndante asgjë, por u ndanë aq dramatikisht, aq gjatë dhe aq larg, gati gjithë jetën dhe me fate të kundërta si realitetet e tyre – njëri që do të rrezikonte në arratinë drejt parajsës, në lirinë dhe mirëqenien jashtë dhe tjetri që do ta hidhnin në ferrin e burgjeve brenda.

Fati dhe fataliteti. Që njëri nga shokët arriti ta ndryshonte, ndërsa tjetrit ia ndryshuan pa rrugëdalje.

Paralele që s'e presin njëra-tjetrën, që s'e di pse, më kujtojnë shinat e trenit, të një treni ngjarësh do të thosha, meqenëse po flasim për rrëfime letërsie, ku çuditërisht ndodh ndryshe, paralelet edhe bashkohen, i bashkon lokomotiva e guximshme e krijimit artistik – le ta vazhdojmë krahasimin – me vagonët që tërheq pas, me personazhe që hipin dhe zbresin nëpër stacione si në kapituj romanesh.

E di që doktor Pashko R. Camaj udhëton shumë me tren nëpër Nju-Jork për të shkruar në punë, shihet njëherë që lexojnë, ashtu si dhe veten dhe këtu do t'i ketë lindur ideja për një libër me udhëtime, me ikje, me rreziqe që jo pak ka kaluar edhe vetë, por edhe ka dëgjuar që edhe të tjerë kanë kaluar shumë e më shumë dhe më të rënda. Nga bashkatdhetarë, natyrisht. Sidomos me

Brenga, roman i parë i Pashko R. Camajt

Një brengë që donte të shkruhej...

– Dhe thirri doktor Pashko R. Camajn –

Ese nga Visar Zhiti

ato udhëtimet brenda vetes. Që të mos harrojmë. Pa kujtesë jo vetëm që s'është askush, por nuk ka as popull, as kohë. Duhet medoemos rrëfimi. Si shkencë dhe art... si roman.

Ashtu si edhe dashuria njerëzore. Që sa e vështirë ishte në Shqipërinë me dy diktatura të mëdha, atë komuniste dhe atë të varfërisë. Miqësitë e mëdha do të ishin të rralla, do të kishte të vërteta, por edhe të kollajthyeshme, të brishta dhe të ashpra dhe mashtruese ashtu si edhe vepronte realiteti që bëjnë. Mjerisht, miqësitë do të kishin rëndesa politike. Dukej e pamundur miqësia e një të përndjekuri, e një familjeje të tillë, me një që ishte me përndjekësit, i

një familjeje të atillë. Gjendej edhe poezi që i miqësonte të rinjtë, aq sa ajo nuk bëhej politikë e ditës apo nuk ndërhynte policia politike për t'i prishur, edhe me ndihmën e njërit nga miqtë.

Doktor Pashko R. Camaj zgjodhi të bëjë romanin e miqësisë së dy shokëve, të tëhollojë alternueshëm ndodhitë e mëpasshme të ndërprerjes brutale të saj. Dy bashkëfshatarëve nga një vend i Veriut tonë, Tonini nga familja e Mirakajve, e njohur për patriotizmin dhe persekutimin – z. Tonin Mirakaj është i vërtetë, jeton në Nju-Jork, ka moshë të thyer, autori e ka takuar – dhe tjetri është shoku i tij, Marku, i fantazuar i gjithë, që është si ata që vuajtën burgjeve



politike të diktaturës si kundërshtarë, madje Marku i romanit nuk bëri ndonjë vepër penale politike, ai thjesht donte të mbetej mik dhe nuk mundi të merrte dot që në krye të herës formatin e përcudnuar të njeriut të ri që kërkonte Partia-shtet.

Në natën e fundit, që s'e dinin se do të ishte e tillë, kur dy miqtë ndahen, njëri i jep tjetrit një kryq. Jemi në kohën kur feja do të ndalohej me ligj, që do të prisheshin tempujt e besimit, kishat e xhamitë do të ktheheshin në kinema, në magazina e depo armësh për ushtrinë, kur klerikët do të burgoseshin apo edhe do të pushkatoheshin.

Duke i dhënë shokut kryqin si shenjë miqësie, besimi e qëndrese, ai, pa e ditur, sikur i ndolli edhe mundimet e Rugës së Kryqit, Golgotën e së ardhmes. Ndërkaq, kishte nisur përçarja mes njerëzve, disa po shenjoheshin të ishin fatzinjtë e diktaturës dhe disa po paracaktoheshin të ishin si fatbardhët e diktaturës.

Përgjegjësia mbetej e gjithsecilit.

Ankth, entuziazëm, partizanë kur lufta kishte mbaruar, fitore, gjyqe mizore, kafkiane, vrasje, tmerre, spiunë të gjithçkaje, dhunime...

Komunistët na kanë vrarë çdo shpresë. Dhe jo vetëm për ne, por për gjysmën e këtij kontinenti. Dhe të jesh një Mirakaj me komunistë në pushtet, do të thotë të jesh i vdekur, - i thotë Toninit i ati para se të marrin udhën e arratisë.

Ndërsa Markut në burg një prift ortodoks, Petroja, që fshehurazi mbante edhe fletë të Biblës, do t'i thoshte: ...të pranosh fatin tënd është shenjë force, jo dobësie. Është një rrugë që fillon duke pranuar se gjërat ndodhin, duam apo jo...


Ndërkaq, familja e Toninit mori guximin të sfidonte fatin, arratisen, u ikin kthetrave të tiranisë komuniste, jo vetëm kaq, marrin edhe fluturimin drejt ëndrrës amerikane. Një odise plot rreziqe, nga malet e Iballës, përmes kampeve të ftohta të refugjatëve në Jugosllavi e Itali dhe deri te dritat e Nju-Jorkut. Por edhe Marku me familjen pati guximin të qëndrojnë dhe të përballojnë të keqen në vend, sfida e tij është infernale.

Liria e Toninit nuk do të jetë e mjaftueshme, ajo ka brenda brengën, atë kompleks faji për ç'la pas mbas ikjes, një si hije të gështenjtë braktisjeje për mbijetesën. Ai s'e di që vëllai i tij i shpirtit, Marku, mbetet burgjeve edhe si ndëshkim i arratisjes së tij.

Rëndësi merr ndjenja, se çfarë ndien, ajo je. Kjo është vlera thelbësore e këtij romani, sipas meje.

Marku tashmë është hero i tragjik në ferrin e burgjeve famëkeqe të Burrelit dhe të Spaçit, në minierat ku trajtohen si skllëvër. Megjithatë, historia e Markut nuk është vetëm histori vuajtjeje, por edhe e qëndresës njerëzore. Dinjiteti mund të ruhet edhe kur trupi shembet dhe se besnikëria ndaj një njeriu tjetër si ndaj vetes mund t'u mbijetojë dekadave të torturës. Po ai tjetri a ka faj? Ç'mund t'i bëhet kësaj brengë?! Që të vjen nga tjetri si vetja...

Më shumë se rrëfimin e dy rrugëve, më e rëndësishme është ndjesia që përftohet prej tyre – ndjesia që përjetojmë, e përsëris, është përcaktuese në një vepër letrare, kështu



besoj – që edhe nëse nuk ka për qëllim zbërthimin psikologjikisht a estetikisht të saj etj., ajo kthehet mrekullisht në etikën e qëndrimeve dhe veprimeve, se në fund të fundit jemi më shumë ajo që bëjmë se ajo që themi.

Vepra e Pashko Camajt është qëndrim edhe i fuqishëm. Si shkrimtar mund të them se përgjithësisht ka një si përzierje të stilit të një kronike me të folurën e njënjëshme të fatthënësit, plot me detaje romanore. Sa shumë çliruese janë në roman ato skenat epiloguese atje te pema e gështenjë së vendlindjes, ku dhe filluan, ngjashëm tani me imazhe të filmave hollivudianë.

T'i besojmë ndjenjës!

Ikjet dhe dënimet... Çështje morale me rëndësi

Nga koha që lamë, autorë të ndryshëm zgjedhin realitete të ndryshme për të shpalosur, ashtu siç shpalosim ne librat e tyre.

Ata që u sunduan nga realizmi socialist shohin më shumë triumfin e rendit, propagandimet e tij të bujshme, unitetin forcërisht, rreshtat dhe brohoritjet, statistikatat e një progresi të dyshimtë, ekonomi që për t'u rritur rrënon një popull etj., duke shmangur kështu edhe progresin tjetër, atë të luftës së klasave, përçarjes kombëtare dhe të varfërisë dëshpëruese, të shumanshme, gjenerale.

Doktor Pashko R. Camaj nga Shqipëria që lamë, mes festës dhe makabritetit, zgjodhi, pra, jo rastësisht, të rrëfejë burgjet dhe ikjet, siç duket këto dhe mbeten si arritjet më të rëndësishme të asaj epoke.

Trajtimi dhe mënyra si i sheh, optika e tij, kanë jo vetëm largësinë kohore të nevojshme, po ashtu edhe atë gjeografike, që sigurojnë një paanshmëri, besohet, përveçse ai është shkrimtari, ndërgjegjja dhe përgjegjësia s'mund ta lënë mënjanës. Ai është me ata që përndiqeshin e vuajtën dhe jo me ata që përndiqnin e duan të shkaktojnë vuajtje edhe sot.

Kur flasim për burgjet politike, nuk duhet të nënkuptojmë vetëm njerëzit e burgosur, gjë që s'e durojnë dot të gjithë, por cilësinë e lirisë njerëzore të mohuar. Një qasje e ndjeshme ndaj asaj është rikthimi i historisë në empati, të imagjinosh dhembjen, frikën, lirinë, por edhe të tashmen si ëndërr e tyre. Dhe ta ndiesh si projekt tonin të përbashkët.

Psikologu i njohur i traumës, Viktor Frankl, vetë i burgosur në kampet naziste, shkruante: "Ai që ka një 'pse' për të jetuar mund të përballojë pothuajse çdo 'si'".

Nga përvojat e skajshme mund të kuptohet se ata mbajtën dinjitetin brenda një realiteti mizor. Dhe kjo i shërbeu dinjitetit të gjithë shoqërisë.

Ish-të burgosurit politikë, Marku i romanit me bashkëvuajtësit e tjerë, nuk janë vetëm viktimat, por edhe kundërshtarë të së keqes së përbashkët, bartës të një historie të dhembshme, të një traume, shpesh të brishtë psikologjikisht. Kur shoqëria i gjykon vetëm si "të fortë" ose "heroikë", apo me kahun tjetër cinik, akoma më cekët se "ashtu ishte koha, pse shkelën ligjet e saj" etj., kuptohet se nuk kanë kapur fare nga dhembja e tyre e brendshme, që është dhembja e njeriut.

"Për të kuptuar dikë, duhet të ecësh me këpucët e tij", - kjo është *Empatia e Platonit* në një kuptim praktik.

Doktor Pashko R. Camaj ka veshur edhe çizmet stoike të të burgosurit, që me dhunë e detyruan të punonte në minierat e ferrit, por ka vënë mbi supe edhe flatrat drithëruese të atij që merr arratinë për t'i ikur së keqes.

Romani ka kujtesë. Dhe nuk duhen medoemos amnezia penale e as glorifikimi automatik.

Burgjet e Burrelit dhe të Spaçit, qelitë e akullta, mizoritë, revolta, shtypja, vrasjet në veprën e Pashko Camajt nuk janë vetëm dëshmi, por edhe akuza, edhe sfidë kundrejt asaj utopie që ushtroi dhunë duke vazhduar disi edhe sot dhe nga ata që shpërdorin fjalën. Jo vetëm shkrimtarë, por edhe shumë filozofë dhe teoricienë të politikës, p.sh., Hannah Arendt me *Banalitetin e së keqes*, na mësojnë se jo gjithmonë "e keqja" është monstruoze; shpesh ajo është e

përditshme, e rutinës dhe kjo e bën gjykimin më kompleks.

Të gjykosh një njeri nuk është të urresh të kaluarën e tij, por të kuptosh rrethanat dhe psikologjinë e zgjedhjes që e sollën aty ku është... Po kështu dhe për një popull. Kështu duhet të ndodhë edhe me librin e historisë. Pse jo dhe me romanin...

Ngulmim te ndjeshmëria

Duhet të emocionohemi deri në magjepsje. Jo vetëm me veprat e artit. Po edhe si tek ato.

Romani i Pashko Camajt ka tension ndjeshmërie dhe duket se këtë kërkon të bëjë edhe te lexuesi. Te njeriu... Empati... dhe të kuptuarit se sa afër ose sa larg mund të ishte vetë nga zgjedhjet ekstreme të kohës.

Të kthyerit e gjykimit jo vetëm për dënim ose falje, por për ndjeshmëri, është edhe misioni i shkrimtarit.

Duke parë muret e burgjeve dhe në faqe romanesh, të ndiesh ende ftohtësinë dhe frikën, urinë dhe heshtjen, braktisjen nga njeriu etj., këto janë edhe kujtesa për atë që mund të na gjente, po të harrojmë. T'i ikësh së keqes, kthetrave të saj, duhet një arratisje... si akt, por edhe si akt artistik.

Të shumë janë ata që arritën të iknin, të shpëtonin jetën nga diktatura dhe vetvetja që mund të bëhej nën diktaturë: i shtypur ose, më keq, shtypës.

Të ishe i lirë, i pakërcënuar, me mundësi pasurimi me punën tënde, nuk ishin të mundshme në dheun amë.

Në romanin e Pashko R. Camajt mendoj se është risi ndjenja ambivalente që na shkaktohet prej personazheve që ikën dhe që mbeten, një përzierje mes gëzimit për jetët e shpëtua dhe pezmit për vuajtjet dhe padrejtësitë e vazhdueshme, edhe nga shkaku i njëri-tjetrit.

Të arratisurit politikë ndodhte të përjetonin në botën e lirë një si kompleks faji, atë të shëlbimit kur të tjerët masakroheshin në atdhe, ku të tjerët nuk lejoheshin ta ndienin, duke arritur deri aty sa të shihnin si fajtorë ata që i fusnin në burgun politik dhe jo ata që fusnin, faunën e sundimtarëve...

Prandaj edhe të ngjuarit forcërisht në burgun politik të atdheut kanë një si akuzë për të gjithë...

Mosndjeshmëria

I gjithë romani duket si një qortim dhe Imoshonepsje ndaj atyre që u mungon ndjeshmëria. Se ka nga ata që lexojnë vetëm veten e tyre, ashtu siç do të donin të ishte ajo dhe të tjerët përreth saj.

Fanatikët e rikthyer nga diktatura, që e dënojnë diktaturën, madje me atë pasionin që e deshën, çuditërisht, nuk mund të përballojnë historinë e vërtetë të atyre që vuajtën. As të veteve që i bënë ata të vuajnë. Çdo gjë e masin me një kompas imagjinari superior, duke besuar se askush nuk ka pësuar aq sa ata dhe asnjëri, po të ishte në rrethanat e tyre, nuk do të vepronte më drejt se ata.

Shpesh atë kompas e bëjnë penë. Mjeshtër të demokratizmit të letrës dhe të hipokrizisë morale. Në formën e tyre parake, si sekretarë e gardianë e spiunë i gjejmë edhe në roman. Ata mund të flasin për lirinë, por nuk durojnë të lirët dhe shpesh shpikin kundërhistori, sepse nuk u pëlqen që dikush tjetër mbart atë që ata nuk mund ta duronin dot.

Këta janë bërë kritikë përçudnues të vuajtjes së tjetrit, ekspertë të dhembjes që nuk e kanë përjetuar.

Konvertit të fanatizmit të dikurshëm i është shtuar aftësia e prapë për të gjykuar gjithçka dhe të mosndjerit të asgjëje, përveç kënaqësisë që kanë kur tregojnë superioritetin kinse moral mbi të tjerët.

Janë gati për të shpallur lirinë si ide të tyre ekskluzive.

Fanatikët e dikurshëm të diktaturës sot e gjykojnë vuajtjen si një spektakël televiziv, romani thjesht duhet të zbukurojë bibliotekën, pranojnë aq dhembje sa edhe Inteligjenca Artificiale.

Miqësia e zorshme me të persekutuariat u duhet tani persekutorëve jo si paqe, por që të kalohet sa më parë tek teprimi që, në fund të fundit, ta lënë rolin e zemërgjerëve,



që ligësitë e vetes të gjitha, t'i hedhin jo në burgun e së dikurshmes, por tek ata që njohin dhe kanë qenë të burgosur, kështu ata shmangin vetveten e dikurshme.

Një zgjidhje në roman

Ado të ishte zgjidhje shkëputja nga Andjenja apo thjesht të kuisje mbi brengën personale, siç edhe bëjnë duke ia hedhur tjetrit mëkatet e vetes, madje edhe me akuzën absurde për privatizim të burgut. Marku i romanit nuk mburret kurrë me vuajtjen e vet dhe burgun nuk është pronë e të burgosurit, por e atyre që e ndërtuan për të futur njerëz në burg dhe ata janë privatizuesit e tij ose ata që mendojnë: e ashtu duke e pasur burgun brenda mendjes dhe shpirtit të tyre.

Doktor Pashko R. Camaj zgjodhi të tregojë brengën e madhe të një populli, që edhe pse ai pati fatin të mos e jetojë, e përjeton atë si të veten, sepse ndien si njeri dhe shkrimtar. Dhe mban qëndrim. Ajo zbulohet te personazhet e tij.

Në fund, doktor Pashko R. Camaj na rrëfen takimin aq emocional midis ish-të burgosurit politik në Shqipëri dhe ish-të mërguarit politik, të lirë në Perëndim. Dy shokë të dikurshëm, palë të një kohe, të të njëjtit kah, sepse kahu tjetër janë sundimtarët dhe nostalgjikët e tyre sot.

Pala e të burgosurve pritët të flasë për vuajtjet dhe padrejtësitë shtetërore, humbjet, si mbetën pa rini, me fëmijët rrugëve të internimeve, sakrificat dhe fajtorët, ndërsa pala e të arratisurve duhet të tregojë shpëtimin, liritë, arritjet, pleqërinë e bardhë, fëmijët e shkolluar mirë, por edhe brengën, atë ndjenjën e pashprehur të fajit, të pasojave të rënda të atij largimi nga vetë historia që lanë pas.

Çfarë na tregon romani? Çkemi pas kësaj? Acarim apo mundësi dialogu të sinqertë? Rizbulime? Gjykim? Apo dhe respekt për të kaluarat e njëri-tjetrit? Të ndiesh, të kesh dhembjen e mirë...

Mendimtari dhe filozofi i psikikës, Carl Jung, thoshte: "Çfarë nuk shprehet brenda nesh, mundohet të shprehet jashtë." Pra, vuajtjet dhe humbjet që mbajtën ata që mbetën brenda dhe çlirimi që përjetuan ata që u larguan, janë të dyja histori që kërkojnë njohje dhe shprehje, rrëfim, jo krahasime, por shmangie të zilisë. Siç duket, nuk është plotësisht më mirë ose plotësisht më keq të kesh qenë jashtë apo brenda. Çdo rrugë ka çmimin dhe dhembjen e vet.

Liria me brengë e njerit nuk e zhbën vuajtjen kryeneçe të tjetrit. Le të rrëfejnë secili me shpresën duke krijuar një kuptim të përbashkët për të kaluarën nga doli e tashmja që paraprin të ardhmen. Njohja dhe pranimi janë mënyra që të shpëtojmë

vetvetet... Dhe të lexojmë patjetër.

Në fund të fundit, nuk ka pasur më mirë apo më keq – mund të thotë i paanshmi i ardhshëm – por rrugë të ndryshme. Dhe një brengë – pasuri e përbashkët. Që pranohen për të ndier një lloj paqeje të thellë, me adhurimin për guximin e të jetuarit, për durimin, zgjedhjet dhe vuajtjet, nga të cilat njeriu i fortë, njëherësh edhe i dobët, nxjerr edhe lumturinë.

Dhe romani sheh me syrin e zemrës, me një ndjesi të sinqertë përbashkuese.

Kur Marku imagjinari i shkruan Toninit real, mes tyre është "brenga" dhe ndjenja që ajo shkakton, por është dhe përgjigjja jonë: *Nëse po e lexon këtë letër dhe më kujton, atëherë nuk ka qenë kot. Më kujtohet ajo natë kur më vure kryqin në dorë. E gjeta mënyrën për ta mbajtur me vete për gjithë këto vite, edhe në qeli, edhe nën tokë, atje ku s'kishte as Zot, as kohë. E kam ende... Dhe e përfundon letrën: Jam mirënjohës që ende di si duket qielli... Pikërisht si një poet. Shpik poetin brenda vetes dhe ke për të shpëtuar. Dhe përsiatja vazhdon: Nuk pata kurrë mundësinë të shihja e të jetoja veten që mund të isha. Kur ta vjedhin jetën kaq herët siç ma vodhën mua, mbart me vete dy fantazma: fantazmën e asaj që je dhe fantazmën e asaj që mund të ishe. Kam jetuar me to çdo ditë, në heshtje, vetëm. [...] humbur në varre pa emër, në dosje që askujt s'i lejohej t'i lexonte...*

Po është romani, më i sigurt se të gjitha. Ndërsa prifti, Petroja, sikur na thotë të gjithëve: *Jo, ndjenja e dhembjes dhe kërkimi i fajit nuk të bën të dobët... Të bën njeri...*

Gruaja e një bashkëvuajtësit tim në burgun e Spaçit, ku mes nesh kishim edhe Markun e romanit, gruaja e atij poetit që varën në Kukës, Havzi Nela, varja e fundit në perandorinë komuniste dhe do të nisinin ndryshimet... por edhe romani... ajo grua më kishte thënë njëherë se kur ne do të flisnim për dashurinë, atëherë do të ishim çliruar...

Te gështenja e vendlindjes Marku takon edhe Dritën, mësuesen e re. Të dy bien në dashuri. I bashkoi edhe dashuria për librat, por më shumë ndjenja e të qenit të huaj në vendin e tyre dhe akoma më shumë vetë mrekullia shëlbuese e dashurisë.

Të gjithë ndiejnë se historia duhet rrëfyer, sepse e kemi nga një histori, po edhe si një e vërtetë që mund dhe duhet të shërbejë si katarsis, e vërteta na bën të lirë, rrëfimi është dhe akt shprese, të pajtohemi me historinë.

Këtë bën ky roman... Na kërkon të jemi të ndjeshëm, qoftë edhe pa asnjë histori, se na e sjell. Historia jonë jemi ne.

Chicago, vjeshtë e tretë 2025

Arti dhe muzika i japin kuptim jetës sonë të përditshme; nëpërmjet tyre ne jemi në gjendje t'i përballojmë shqetësimet tona dhe t'i gjejmë ngushëllim dhe paqe në praninë e tyre. Kjo aftësi e së bukurës për të zbutur vuajtjet tona është një nga arsyet përse e bukura mund të shikohet si një zëvendësuese e fesë. Përse t'i japim përparësi fesë? Përse të mos themi që feja është një zëvendësuese e së bukurës? Për të shkuar edhe më tej, përse t'i përshkruajmë të dyja si kundërshtare kur në fakt e bukura dhe e shenja janë dy dyer drejt një hapësire të vetme dhe në atë hapësirë të vetme ne gjejmë shtëpinë tonë?

ROGER SCRUTO
(Filozof dhe shkrimtar)

Nga tregimet më poetikë të prozës sonë

Tregimi “Floçka” i Anton Pashkut është, pa asnjë dyshim, nga më të dendurit si tekst dhe më poetikët si mënyrë shtjelluese dhe shprehje që është shkruar në gjuhën tonë, që njoh unë. Ka dymbëdhjetë faqe e gjysmë libri me gjithsej 3259 fjalë¹. Në bazë të shumësisë kuptimore dhe të nëntekstit që nxit dhe krijon teksti, është një krijesë e gjatë, shumë e gjatë. Gjithë teksti i tregimit është i lidhur ngushtë me Bukurinë, me të Bukurën, me Dashurinë, qoftë në rrafshin e të shprehurit poetik, qoftë të qenësisë kuptimore që e cilëson atë. Tregimi është ndërtuar nga shprehje poetike dhe figura që, në vijimësi, shndërrohet në figurë tërësore dhe të papërsëritshme.

Çdo gjë në tekst është e menduar dhe e matur, e ndërtuar me dije e me përkushtim të lartë; është një tekst metaforik, ku zbatohet lapidariteti (koprracia) i skajshëm. Në tekst gjërat e rëndomta thuhën në rrafshin sipërfaqësor, ndërsa ato të qenësishme mbesin në rrafshin thellësor (sipas përfaqësuesve të gramatikës gjenerative: rrafshi sipërfaqësor dhe rrafshi thellësor). Në rrafshin thellësor ato heshtën (me ndonjë përjashtim), po nënkuptohen. Kjo mënyrë e ndërtimit të tekstit bën thelbin dhe vlerën e tekstit të tregimit.

Kush dëshiron të mbesë në rrafshin e parë – atë sipërfaqësor – do të pohojë se ky tregim lidhet me përrallën, me mitin, me përfytyrimin, me imagjinatën ose është tregim fantastik (nëse vështrohet në bazë të titullit të librit ku ai është botuar – *Tregime fantastike*) po vrojtimi i rrafshit thellësor e thotë të kundërtën dhe ka tjetër vlerë. Edhe vetë qëllimi – arsyeja e kërkimit të *Bukurisë*, e të *së Bukurës*, Dashurisë, të dashurës, është tjetër nga kërkimi që i ngjet personazhit të një përralle kur ai vihet, fjala vjen, në kërkim të Bukurës së Dheut ose të Kshetës, ku kalon pengesa të ndryshme e të shumta².

Pse në tregim vështrohet dhe mbipeshon Bukuria – e Bukura?

Janë shumë arsye që Anton Pashku e vë në thelb të tekstit të këtij tregimi të vet Bukurinë – të Bukurën. Ajo ka qenë e mbetet qenësi e gjallimit të njeriut dhe e shpirtit të tij si dje si sot e si nesër.

Qysh Aristoteli thoshte se Bukuria është dhuratë e Zotit, ndërsa Platoni argumentonte se e bukura është simbol i një rendi më të lartë. “Me të bukurën në mendje - thoshte ai, - ju do të jeni në gjendje të ushqeni virtytet e vërteta dhe të bëheni kështu miq të Zotit.”

Fishta ynë vinte në dukje se arti i fjalës (brenda tij dhe poezia) është jehu i shpirtit i shprehur nëpërmjet gjuhës – “Asht t’bukurit *pulcrum* – bukuria”³, që këndell e ndriçon shpirtin. Bukuria ndërlidhet me gjendjen

Tregimi *Floçka* i Anton Pashkut

KRYEVEPËR LETRARE E BUKURISË DHE PËR BUKURINË

Nga Anton Nikë Berisha

e shpirtit të krijuesit⁴, me mendjen dhe me shijen e tij, por (bukurinë) lexuesi e recepton dhe e përjeton në mënyrën e vet [...] ajo, ngurrë t’vet s’është tjetër veç se një fshâmë qi ep shpirti, kurr kndellet n’shkelxim t’rrezeve t’bukuriës. E tujë kânë se shkelximi i bukurisë i tfaqet nierit mas gjënjes s’shpirtit, a se mas zhdrivillimit t’mëndjes e t’shies estetike t’tiit⁵...”

Bukuria – e Bukura është e tillë nga se ajo nuk i përket një individi ose vetëm një kohe, po u përket të gjithëve dhe të gjitha kohëve (ajo nuk është vetëm diçka subjektive, por njëherësh nevojë universale e qenies njerëzore – Roger Scruton).

Duke folur për rëndësinë dhe kohëzgjatjen e Bukurisë, të Bukurës, De Rada ynë shkruante: “E bukura, kjo pjesë e ndritur shpirtërore, na është dhënë që ta mbështesim, ta zhvillojmë dhe ta bëjmë të japë fruta e lule dhe, ashtu si hyjnia Nemesis, që qëndronte mbi një fron të lartë në mes të godinës së madhe të botës, për të ndëshkuar ata që punojnë keq dhe të prapët, ajo na e bën të mundur të mbajmë qëndrim: e t’i vlerësojmë si të mira ose të këqija veprimet e njerëzve nga fakti nëse këto nderojnë apo fyejnë virtytet e njerëzve të ndershëm. Ky qëndrim përbën gurin themeltar të jetës njerëzore. Kënde del se kultivimi i bukurisë paraqitet si kërkesa e domosdoshme, më e lartë se çdo vepër arti, dhe ka një peshë shumë të madhe për të mirën ose për të keqen në jetën e njeriut. Dhe një detyrë e tillë që vjen duke u rritur, është e lodhshme dhe e gjatë sa vetë jeta tokësore”⁶.

Bukuria, e Bukura në tregimin “Floçka” përligjet, pos të tjerash, në dy forma, të thuash të të njëjtës qenësi:

- Përmes tekstit poetik, strukturës gjuhësore shprehëse, që është përbërësi kryesor i çdo krijese letrare poetike dhe kushtëzën komunikimin e tekstit me marrësin dhe ndikimin estetik në të,
- Përmes mënyrës së vështrimit të Bukurisë, të së Bukurës në tekstin e tregimit. Përmes rrëfimit të qetë, po të menduar e të thellë, shpaloset drama e njeriut tonë në kushte dhe në rrethana të caktuara shoqërore e jetësore.

Në hartimin e tregimit dhe të vështrimit të rëndësisë së Bukurisë dhe të Bukurës, përkatësisht të krijimit të tyre përmes tekstit letrar poetik, Anton Pashku dëshmohej sa mjeshtër i madh, aq dhe i mëvetësishëm, gjë që vërehet në të gjithë përbërësit e rëndësishëm shtjellues dhe shprehës poetikë të krijesës. Kjo provohet nga fjalja e parë deri në atë të fundit, ku çdo gjë është e menduar, e ndërlidhur dhe e funksionalizuar në rrafshin më të lartë.

Ndërtimi i bukurisë përmes gjuhës, përmes të shprehurit poetik

Rëndësinë kryesore në këtë tregim Pashku i kushton ndërtimit të tekstit, që e mbërrin përmes gjuhës, sidomos asaj poetike, përmes mënyrës së shtjellimit të tekstit dhe të mënyrës dhe shumësisë së të shprehurit.

Për disa nga veçantitë e mënyrës së ndërtimit të tekstit dhe të sistemit të të shprehurit poetik të prozës së Anton Pashkut, të stilit të tij, kam bërë fjalë në pjesët e tjera të këtij libri, sidomos në punimet kushtuar tregimit “Kulla” dhe në atë për konstantet stilistike ose nga stilematika e “Oh” – it., ku kam shpalosur dhe ndriçuar disa nga përbërësit kryesorë. Megjithatë, duhet thënë se Pashku nuk është imitues dhe kopjues i vetvetes, po bën ndryshime prej një tregimi në tjetrin, të cilat studiuesi i vëmendshëm i vëren. Kryesorja: përmes gjuhës dhe fjalës dhe me ndihmën e imagjinatës Pashku vijimisht përfiton një të shprehur të bukur, të bukurën, që ka qenë e mbetet gjakimi kryesor i njeriut. Edgar Allan Poe thoshte: “[...] ndjenja e së bukurës është në mënyrë të hapur një instinkt i pavdekshëm, i rrënjësor thellë brenda shpirtit të njeriut”⁷.


Disa nga veçantitë e tregimeve të Anton Pashkut i ka ndriçuar edhe studiuesi ynë, Mensur Raifi, i cili shkruan: Do të ishte gabim sikur në këto tregime të kërkosh figurshmërinë në formën e figurës së stilit, atë formë elementare të fjalës a fjalisë që është përdorur dhe përdoret edhe sot e gjithë ditën, madje shumë dendur. Prijatari i tregimit të figurshëm ndër ne në Kosovë ka ambicie shumë më të mëdha. Këtë dimension të mjeteve shprehëse ai e zgjeron dhe e përforcon në të tërë rrëfimin, kështu që i tërë konstrukti i tregimit të tij merr trajtën e një figure, domethënë, i tërë tregimi i A. Pashkut duhet të lexohet fillim e mbarim si një figurë [...] Koherenca e mjeteve të zgjedhura e të përdorura me gjeturi të madhe artistike në ndërtimin e tregimit, që sugjerojnë nuanca dhe aspekte të një situatë prej së cilës reflektohen fillimi, zhvillimi dhe mbarimi i një mendimi a mënyrë të jetesës, paraqet në të vërtetë një tërësi të harmonishme tregimtare⁸.

Për ta dëshmuar këtë po sjell në vijim vetëm pak shembuj, ku këto veçanti shpalosen mirëfilli.

[...] iu kishte dukur se ai terr sikur rigonte ngadalë, sikur rigonte imtë prej dikah lart në fushë, ku gjithnjë e më pak ajgonte gjërat e ndryshme.

Ecën si nëpër blozë, që kishte veshur secilin send dhe mbushur tërë hapësirën.

Në të vërtetë, kishte përshtypjen se posë rrasave, posë gurëve nuk kishte gjë tjetër në atë bokërinë të mjerë - ndoshta, aty-këtu, kishte fije bari, ndofta vetëm ndonjë grusht fijesh bari të shtrënguara midis gurëve dhe asgjë tjetër.



E dera krratte. Flamuri i ri me kryq të thyer e të zi valonte në fshat. Qentë lehnin.

Qentë afroheshin, korbat krrokatnin. Edhe ai zë i njohur për të - kumbonte. Të gjithë i dëgjonte.

Një mori rrezesh të flakta kishin gufuar prej atij liqeni. Një mori rrezesh të flakta ishin shpërndarë në të katër anët.

Ato rreze kishin lëbyrë korbat dhe ua kishin djegur krahët. Shumica kishin cofur pa rënë mirë në pyll. Disa të tjerë kishin mundur të ikin. Ata edhe tash krrokatnin.

Ato rreze kishin lëbyrë edhe qentë. Nga nxehtësia, shumica e qenve kishin ngordhur. Disa të tjerë kishin mundur të ikin. Ata edhe tash lehin.

Megjithatë, ishte edhe i kënaqur, madje edhe disi i lumtur, që Floçka, së paku, iu kishte dëftuar në ëndërr, që së paku e kishte parë në ëndërr tërë bukurinë e saj. Ishte, njëmend ishte i kënaqur që Floçka iu kishte dëftuar, që kishte parë sytë e saj magjike, shikimet e tyre, ato shikime të syve të saj që me nxehtësinë e vet mund të të shkrijnë, të të shndërrojnë në flakadan, në shkëmb të bazalt. Ishte i kënaqur, e edhe i lumtur, që kishte njohur Floçkën së paku nëpërmjet të një ëndrre, Floçkën e bukur me flokë të gjatë e të dendur, që shkëlqejnë si mijëra fije të arta, të cilat në kryet e saj duken si kurorë e ndezur, si kurorë pishe e ndezur flakë, që mund të nxejë po nja gjashtë a shtatë copë fshatra e të shkrijë borën e akullin edhe atje lart, edhe atje në kreshtat e maleve.

Anton Pashku e përfiton Bukurinë, të Bukurën duke e bërë atë edhe objekt vështrimi poetik në bazë të asaj që thoshte Edgar Allan Poe: “E vetmja kënaqësi që është njëherësh më e kulluara, më e ethshmja, më shpirtlartontjësja, besoj se rrjedh nga kundrimi i së bukurës. Vetëm nëpërmjet kundrimit të së bukurës, arrin të na jepet mundësia e arritjes së atij lartësimi të kënaqësisë apo ngacmimit emocional të *shpirtit*, që ne njohim si ndjenjë poetike e që është kaq lehtësisht e dallueshme nga e vërteta, që mund të quhet kënaqja e arsyes apo e pasionit, të emëruar si dalldisja e zemrës”⁹.

Shprehur ndryshe, gjatë hartimit të krijesës poetike, shkrimtari synon t’i shprehë ato gjëra që na shpëtojnë nga vrojtimi dhe vëmendja e përditshme ose që u kanë shpëtuar edhe paraardhësve, të përshkojë (siç ndodh me poezinë e Edgar Allan Poe-s) atë trull të magjishëm midis reales dhe botës së ëndrrave, atë brez të hijëzuar kufitar ku përvojat e autorit përzihen në mënyrë të çuditshme me përbërës nga të dyja anët e mbretërive, përkatësisht aftësia për të gërmuar në labirintet e shpellave të mugëta të shpirtit njerëzor [...]”¹⁰

Edhe vetë ëndrra në tregim, që është nxitëse për ta bërë objekt vështrimi poetik Bukurinë, të Bukurën, është, në qenësi, kundërvënje e realitet përkatës të padurueshëm ose gjakim i asaj që synohet, që dëshirohet, siç dëshmohej në përrallë. Shkrimtari anglez, Dunne, thekson: “Çdo njeriu ëndrra i fal një përjetësi të vogël që i lejon të shohë të kaluarën dhe të ardhmen e tij të afërt”¹¹, ndërsa Jorge Luis Borges thoshte:

⁹ Edgar Allan Poe, Poezi dhe ese, vep. e përm., f. 101 - 102.

¹⁰ Edgar Allan Poe, Poezi dhe ese, vep. e përm., f. 20.

¹¹ Jorge Luis Borges, Ligjërata. Përktheu nga

¹ Shih Anton Pashku, Tregime fantastike. Rilindja, Prishtinë 1986, f. 69 – 81.
² Shih për përrallën dhe poetikën e saj në librin tim Hyrje në historinë e letërsisë gojore shqipe. “Faik Konica”, Prishtinë 2017, f. 227 – 274.
³ P. Gj. Fishta, O. F. M, A janë t’zot Shqyphtarët me u majtë shtet n’vedi? Në “Hylli i Dritës”, n. 3, Shkodër 1913, f. 75.

⁴ Në Parime të estetikës De Rada thekson se “Kënaqësia që i japin shpirtit shumë sende, të cilat nuk i vlejnë gjë trupit, i është atribuar formës së bukur...”. Shih mendimin e plotë në librin Jeronim De Rada Parime të estetikës. Përgatitur për botim nga Alfred Uçi, Globus R., Tiranë 2003, f. 32 – 33.
⁵ P. Gj. Fishta, O. F. M, *A janë t’zot Shqyphtarët* me u majtë shtet n’vedi? Në “Hylli i Dritës”, n. 3, Shkodër 1913, f. 77.

⁶ Girolamo De Rada, Principii di estetica. (estratti delle sue considerazioni su la Vita e i fini di essa), Napoli, 1861, f. 46 - 47; Jeronim De Rada, Parime të estetikës. Përgatiti për botim prof. Alfred Uçi, Globus R., Tiranë 2003, f. 97 – 98.

⁷ Edgar Allan Poe, Poezi dhe ese, vep. e përm., f. 100.

⁸ Shih *Në mbretërinë poetike*. Kritikë letrare për veprën e Anton Pashkut, Zgjedhje dhe përgatiti për shtyp Anton Nikë Berisha. Shpresa, Prishtinë 2002.

“Ëndrrat janë krijime estetike dhe s’ka dyshim që janë shprehja estetike më e lashtë”¹². Në rrjedhë të kësaj, mund të thuhet se ëndrra në procesin e shqiptimit poetik të botës bëhet vetvetiu pjesë e zhgjëndrrës dhe shpreh dramatiken e brendshme të njeriut. Pra, dëshmohet ajo që thoshte Ernesto Sabato: *“Për një ëndërr mund të thuhet gjithçka, përveç se është një gënjeshtër”*¹³. Në këtë kuptim dhe funksion ajo përdorët kaq mjeshtërisht nga Pashku në këtë tregim¹⁴.

Në veprën letrare moderne nuk sqarohen dhe nuk shpjegohen gjërat dhe dukuritë, qofshin ato të jashtme ose të botës së brendshme; të jepen këshilla ose porosi për të mirë ose për të keq; të mohohen ose t’u kundërvihet skajshmërisht dukurive, po para së gjithash, t’i shqiptojë ato, pa hezitim e ngurrim, qofshin të mëdha, qofshin të vogla, që të ngazëllejnë ose të shqetësojnë dhe të tronditin nga se “Në të njëjtën frymë jetojmë dhe vdesim”; t’i degëzojë kuptimet e tyre sa më shumë që është e mundur, ta nxitë marrësin të mendojë sa më mëvetësishtë e më thellë rreth tyre¹⁵.

Pashku nuk e vështron Bukurinë, të Bukurën dhe Dashurinë në natyrë, edhe pse personazhi lëviz në natyrë (kodra e male), po i vështron ato brenda njeriut, shpirtit të tij. Kjo të sjell ndërmend thënien e filozofit të lashtë grek, Sokratit: Të lutem o Zot, më bëj të bukur përbrenda.

Këtë dukuri e zbrërthen sidomos filozofi gjerman, Hegeli, i cili shkruan se vërtet, në jetën e përditshme, është bërë shprehri të flasim për ngjyrën e bukur për qiellin e bukur, për lumin e bukur, madje për lulet e bukura, për shtazët e bukura, sidomos për njerëzit e bukur, por, për kundër kësaj, që tani mund të thuhet se e bukura artistike qëndron në një shkallë më të lartë prej natyrës [...] Pasi bukuria artistike, e përfaqëson të bukurën, e cila në shpirt ka lindur dhe në të ka rilindur, prandaj në qoftë se shpirti dhe produktet e tij qëndrojnë në një shkallë më të lartë se natyra dhe dukuritë e saj, aq më tepër edhe bukuria artistike do të jetë më e lartë se bukuria natyrore. Aq më tepër, shikuar nga ana formale, mund të thuhet se edhe një shaka e pahijshme që njeriut i bie ndërmend, është më e lartë se cilido prodhim i natyrës, sepse një shaka e tillë kurdoherë përmban më vete shpirtëri dhe liri¹⁶.

Një varg filozofësh kanë provuar se nëpërmjet kërkimit të së bukurës njeriu i jep formë botës si një të tërë. Kjo ndihmon edhe për të kuptuar natyrën tonë dhe qenien tonë shpirtërore. Kanti ka shpjeguar se ne mund ta përjetojmë të bukurën vetëm atëherë kur i lëmë mënjanë interesat tona; kur i shohim gjërat jo me qëllimin për t’i përdorur apo për të shpjeguar funksionimin e tyre, për të kënaqur nevojat apo unitë tona, por thjesht për t’i përthithur dhe pranuar për atë që janë.

Cila e bukur dhe për çarsye ajo vështrohet në tregimin “Floçka”?

Është thënë se e bukura ka qenë thelbësore për qytetërimin tonë për po thuaj 2000 vjet (Roger Scruton), ndërsa Ralph Waldo Emerson pohon se Engar Allan Poe besonte se e Mira, e Vërteta dhe e Bukura janë të gjitha aspekte të të njëjtit uniteti hyjnor, ndaj edhe pse mund të arrihen në udhë të ndryshme, shfaqen njëlloj përballë syve të përjetësisë”¹⁷.

Anton Pashku është i vetëdijshëm se përmes artit të fjalës, letërsisë, Bukuria, e Bukura dhe Dashuria mund të dëshmohe­n e të arrihen në forma, po ashtu, përkatëse dhe të përligjin qëllime të ndryshme, nga se ato, siç u tha, janë pjesë e natyrës dhe e shpirtit të njeriut. Tomas Man thoshte: *“Bukuria, o Fedër, mbaje mend mirë këtë, vetëm ajo është hyjnore dhe në të njëjtën kohë, e dukshme. Dhe meqë ajo është udha që na lidh me ndijimet, ajo, o Fedri im i vogël, e çon artistin tek shpirti. Mirëpo, ti, i dashuri im, ndoshta beson se përmes pushtetit të ndjenjave mbi shpirtin mund të arrihet te*

frëngjishtja Feride Pappleka, Pika pa sipërfaqe. Tiranë 2013, f. 29.

¹² Jorge Luis Borges, Ligjërata, vep. e përm. f. 42.

¹³ Ernesto Sabato, Para fundit. Ese. Përktheu nga origjinali spanjisht Orjela Stafasani. OM, Prishtinë 2018, f. 45.

¹⁴ Shih për këtë punimin e përbashkët me don Robert Kolën: Ëndrra si shumësi dhe fshehtësi kuptimore dhe si vizion. Në “Studime letrare të zgjedhura”, Vëllimi 9, Faik Konica, Prishtinë 2025, f. 528 – 537.

¹⁵ Shih Edgar Allan Poe, Poezi dhe esse,vep. e përm., f. 20.

¹⁶ Hegel, Estetika. I, Kultura Beograd 1959, f. 51—52.

¹⁷ Edgar Allan Poe, Poezi dhe ese. Përktheu nga origjinali Dritan Thomollari. Plejada, Tiranë 2004, f. 21.

*urtësia dhe dinjiteti njerëzor? Apo beson më fort (po të lë ta zgjedhësh vetë) se kjo udhë e rrezikshme dhe e këndshme është veç udha e gënjeshtërs dhe e mëkatit, që të çon patjetër te gabimi?*¹⁸” Me fjalë të tjera, “[...] e bukura është rruga që e çon njeriun e ndjeshëm drejt mendimit, vetëm rruga, vetëm një mënyrë, o Fedri im i vogël”¹⁹.

Pra, Bukuria në tregimin “Floçka” të Anton Pashkut përligjet me ato veçanti dhe cilësi që u përmendën, por ajo dëshmohet (është) edhe formë e qëndresës, e mbijetimit shpirtëror dhe fizik të personazhit (lexo: njeriut). Madje, në rrethana dhe kushte në të cilat jeton ai (pra, ku ngjet jeta e njerëzve të mjedisit përkatës shoqëror) ajo shfaqet dhe si mbështetje dhe shpëtimtare kryesore, për të mos thënë e vetme.

Tregimi fillon me frazën kuptimisht të rëndësishme: *Kur kishte zënë të ngjitej nëpër atë përpjetëze - thotë përralla për të, përralla për të dhe tërë atë dashurinë e tij*jo të rëndomtë - *kishte pasë rënë terri*.

Përpjetëza dhe terri janë parashenjat e para të asaj që do të rrefehet, do të ndodhë në tregim, si qenësi e tij.

Po qe se nisemi nga shprehja – *thotë përralla për të, përralla për të dhe tërë atë dashurinë e tij*jo të rëndomtë – (që përsëritet disa herë në tekstin e tregimit në formë jo të njëjtë) fitohet përshtypja se kemi këtu të bëjmë me ndonjë përrallë ose me botën e saj. Mirëpo, kjo shprehje është përdorur me qëllim, jo për të dëshmuar përrallën, botën e saj, po për të fshehur e për të shmangur, qoftë dhe mëdyshjen më të vogël, se ajo që rrefehet në tregim lidhet me jetën konkrete, me realitetin e përditshëm tejet të rëndë, për të mos thënë frymëzënës.

Kjo gjendje, në vijim, merr përmasa dhe më tronditëse, më të rënda: nata bëhet e zezë si pendla e korbit: personazhi dëshmon se ngjitja përpjetëzës nuk ishte veprim i rastit, po nevojë, shenjë e pakënaqësisë, e ballafaqimit me vuajtjet, formë e kërkimit të mbijetimit të përditshëm fizik e shpirtëror, ku frymëmarrja ishte frymëmarrje nate, ishte, siç do të thoshte Azem Shkreli *“kishte koha ethe, kishte koka brymë”* ose kohë e Ogipogës²⁰.

Me ngjitjen në përpjetëze, në udhëtim e sipër, personazhi dëshmon se është pjesë e gjithë asaj që ngjet rreth e për­qark tij, e mjedisit shoqëror ku jeton, po që është tronditëse për të e për të tjerët:

Kurse në qiell, dikur, ishte dëgjuar krrokatja e një korbi. S’kishte vonuar dhe fill pas krrokatjes së parë ishin dëgjuar edhe krrokatjet e shumë korbave të tjerë të zez, që fluturonin mbi fshat. Me ato krrokatje ishin përzier edhe të lehurat e qenve. Mezi dëgjohej krratja e derës.

Nuk mund të rrinte më aty e të shikonte qentë duke copëtuar prenë e tyre, të dëgjonte të lehurat e qenve afër shtyllës më flamurin e ri që kishte atë kryqin e thyer e të zi, nuk mund të rrinte e të dëgjonte krratjen e derës, të ndjente erën, duhmën e gjërave të djegura, erën dhe duhmën e fshatit të shkrumbuar. Me lot për faje u largua prej atij fshati të mjerë, mbi qiellin e të cilit fluturonin edhe kordat e zez.

Shtegtari i tregimit nuk e përjeton dhe është vetëm pjesë e këtij realiteti, pra është brenda tij, e pëson nga ai realitet, po njëherësh e ndien tek vetja forcën të mos gjunjëzohet, pa marrë parasysh vështirësitë dhe vuajtjet:

As ajri nuk lëvizte; nuk ndjehej pikë fryme, por, mendonte, ajri nuk do të lëvizë dhe pikë fryme nuk do të ketë vetëm për disa çaste, sepse në largësi dëgjoheshin murmurimat dhe herë-herë, si rreze të shkurtra, shiheshin vetëtimat duke shkrepur. Kurse këtë e çonte rruga shi andej ku dëgjoheshin murmurimat e shiheshin ato vetëtima, thotë përralla, rruga e vështirë, nëpër të cilën kurrë deri më atëherë nuk e kishte bërë asnjë hap dhe nëpër të cilën, duke u përshkruar nëpër atë errësirë të mallkuar, nganjëherë edhe zinte në thua, si tash kur, pas një përpjekje të madhe, mezi mbeti disi në këmbë pa u rrëzuar.

Këto vuajtje dhe pësime dëshmohe­n në mënyra të ndryshme e të shumta, herë – herë dhe të papritura.

Në fund, mbarimin e asaj farë zhurme e kishte pasë shoqëruar edhe pingrima e njëfarë zogu nate, kushedi çfarë zogu nate, që këtij nuk i kishte pëlqyer, sepse ajo pingrimë iu kishte dukur shumë ndjellakeqe, pingrimë që tërë atë errësirë dhe atë qetësi rreth tij ia kishte bërë edhe më të rëndë, edhe më të

¹⁸ Tomas Man, Vdekja në Venecie. E përktheu Beatrice Ballçi. Beqir Musliu, Gjilan 2017, f. 101.

¹⁹ Tomas Man, po aty, f. 63.

²⁰ Shih më gjerësisht për poezinë e Azem Shkrelit studimin tim Poetika e fjalëve të gurt­a. Qasje veprës letrare të Azem Shkrelit. “Argeta – LMG”, Tiranë 2011. Shih dhe botimin e dytë Për veprën letrare të Azem Shkrelit. Poetika e fjalëve të gurt­a. Con un’appendice in italiano. Botimi i dytë i ndryshuar. Shtëpia botuese Beqir Musliu, Gjilan 2024.

padurueshme; ajo nuk kishte mbetur vetëm: pas një trohë herë ishte shtuar në dy, mandej në tri dhe dikur ishte shumëar në kushedi sa pingrima të tjera. Të gjitha së bashku krijonin një oshëtimë të tmerrshme. Dhe, në një çast, ajo oshëtimë iu duk si të ishte qeshje, qeshje e mortjes, qeshje që thërriste, thërriste, thërriste...

Realitet i tillë sa shkon e bëhet, siç u tha, më i rëndë dhe mby­tës:

Duhej t’i bëhej ballë vargut të pandërprerë të valëve të frymës, valëve të hovshme të frymës e, pos kësaj, edhe ai shpat mali ishte bërë shumë i rëndësishëm. Kështu, njëherë edhe u rrëzua, ra përmbys, sepse nuk kishte mundur të qëndrojë në këmbë dhe kishte rrëshqitur. Kur ishte rrëzuar, aty për aty, s’kishte ndjerë gati kurrfarë dhembje. Më vonë, në krahun e djathtë, kishte ndjerë do therje, në fillim të lehta e mandej gjithnjë më të forta. Dikur, krahu iu kishte mpirë gati fare. Prej mundit, që e kishte pasë kapluar për disa çaste, ballin ia kishin mbuluar do djersë të ftohta. Megjithatë, nuk e ndalte hapin. Njëmend, tash ecën ngadalë dhe me vështirësi, por ecën, së paku lëvizte përpara.

Autorët e shquar në të shkua­rën ishin të vetëdijshëm për vështirësitë dhe vuajtjet e mëdha në jetën e njeriut, por ata kishin një zgjidhje për këtë dhe kjo ishte Bukuria, e Bukura, Dashuria. Pra, ato, edhe në rrethana e kushte të parëndomta, e ndihmojnë njeriun; e ngushëllojnë përballë vuajtjeve dhe pësimeve dhe i hapin shtigje qëndresës dhe jetës.

Bukuria, e Bukura si një burim thelbësor jetësor

Pikërisht këtë mënyrë veprimi e zbatoi dhe Anton Pashku në tregimin “Floçka”, për të dalë, për të ngadhënjyer mbi atë gjendje dhe ato pësime, personazhit nuk i mbetet tjetër të mbështetet në Bukurinë dhe të Bukurën – të mbështetet edhe në zërin e tyre. Pra, në zemër të vuajtjeve dhe të pësimeve të rënda, fizike e shpirtërore, shtegtari i tregimit ndien një zë tjetër, i cili ngadhënjën mbi të gjitha lëndimet dhe të këqijat; është zëri i të Bukurës, i Bukurisë, i Dashurisë:

Mbasi ishte prapsur, kishte vazhduar përsëri të dëgjojë atë qeshje, tërë atë valë pingrimash trishtuese, të gjitha ato qeshje si të mortjes, të cilat, befas, ishin mbytur nga një zë tjetër. Ai nuk vinte prej andej, prej nga kishin ardhur ato qeshje. Dëgjohej nga ana e majtë. Kishte kthyer kryet, si me drojtje: kishte parë, atje diku kah kurri­zi i malit kishte parë një flakë, një grusht drite. Ajo rrinte gjithnjë në një vend. Ai zë, pos të cilit, tash, nuk dëgjonte asgjë tjetër, vinte prej andej. Iu kishte dukur se e njihte atë zë. Iu kishte dukur i ngjashëm me zërin që e kishte dëgjuar para do netëve në ëndërr, në atë ëndrrën e ëmbël ku iu kishte dëftuar Floçka. Ah, ai ishte, ai zë ishte krejt si zëri i Floçkës, të cilën aq shumë e kishte kërkuar nëpër puse dhe buzë lumenjve; krejt si zëri i saj që e thërriste në ëndërr të shkojë te ajo.

Ngjet kështu për arsye se ai zë – zëri – shpreh Bukurinë, të Bukurën, e cila, siç thuhet në tekstin e tregimit: *Sa e madhërishte iu kishte dëftuar në ëndërr!* Pra, jo vetëm Bukuri dhe e Bukur, po të tilla që s’ka parë syri ndonjëherë. Këtë bukuri dhe këtë të bukur personazhi e kishte kërkuar pareshtur, nëpër puse dhe buzë lumenjve, që të kujton Të Bukurën e Dheut të përrallave, më e bukura në rruzullim. Ajo është kulmi; njeriu jo rastësisht i kërkon majat, skajshmëritë; atë që të pasuron më shumë dhe ku kënaqësia është e pafund.

Kurrë vashë më të bukur nuk ka parë syri i tij! Ishte me flokë të gjatë e të dendur, fijet e të cilëve ishin si mijëra fijesh të arta që shkëlqenin edhe në errësirën më të madhe, kurse në rrezet e diellit, kështu i ka parë në ëndërr, në kryet e saj dukeshin si kurorë pishe e ndezur flakë që mund të nxente po nja gjashtë a shtatë copë fshatra rreth e rrotull dhe të shkrinte borën e akullin edhe atje lart, edhe atje mbi kreshtat e maleve! Atë e ka parë në ëndërr. Dhe në ëndërr i tregoi vendin ku banon. I tha se jeton në ujërat e kulluara të një liqeni, që është larg shtëpisë së tij nja shtatë ditë e shtatë net këmbë. I tregoi, gjithashtu, se ai liqen ndodhet i strukur në midis të një pylli, se ai del para syrit të njeriut mbasi të kesh kaluar shtatë bjeshkë.

Zëri i Bukurisë dhe i të Bukurës (e bukura si një burim thelbësor jetësor) është i fuqishëm dhe ngadhënjën mbi të keqen, e çfarëdo natyre qoftë ajo, dhe sjell ngushëllimin e pafund. Për këtë arsye shtegtari, që është nisur përpjetëzës dhe ka përjetuar e ka pësuar shumëçka gjatë rrugës, nuk do të kursëjë asgjë që ta takojë atë Bukuri dhe atë të Bukur, Dashurinë e tij, që, së pakut, të prehet në të dhe të frymojë brenda saj.

Bukuria, e Bukura i ka thënë në ëndërr ku

rri dhe sa larg është: duhet të kalohen shtatë bjeshkë dhe të udhëtojë shtatë ditë e shtatë net. Me një fjalë, për të mbërritur tek ajo duhet aftësi, mund dhe flijim i pazakonshëm. Po shtegtari është i gatshëm të bëjë gjithçka, të flijohet pa fund vetëm të mbërrijë dhe të përjetojë Bukurinë, të Bukurën, ngjizur nga dashuria.

Ky, në ëndërr, i tha asaj se shtatë ditë e shtatë net udhëtim janë vetëm si shtatë dekika, kurse te liqeni do të arrijë gjallë o vdekur edhe sikur të jetë në skajin më të skajshëm të botës, e jo aty - pas shtatë bjeshkëve... Ajo, kur i kishte dëgjuar këto fjalë, e kishte përkëdhelur butësisht e i kishte dhuruar, madje, edhe një fije floku të artë dhe i kishte thënë diçka po me këtë zë, që tash i dukej se ishte zëri i Floçkës dhe i askujt tjetër. Se ç’i kishte thënë në fund, këtij tash nuk i kujtohej, por i parafytyrohej fare mirë ai shkëlqimi i Floçkës, kur iu kishte dëftuar në ëndërr; nuk mund të vërente asgjë, që do të dallonte atë shkëlqim prej këtij shkëlqimi që ishte shfaqur atje dikur kah kurri­zi i malit.

Është shkëlqimi i Bukurisë, i të Bukurës, përkatësisht i Floçkës së dashur; është drita që vjen prej saj dhe e grish pareshtur të mos ndalet po të shkojë tek ajo. Për këtë arsye vendos t’i përballojë edhe erën me fishkëllima të hatashme dhe shiun e rrëmbyeshëm, pikat e të cilit, si gjilpëra, e thernin në fytyrë, në duar, vetëm që t’i afrohet asaj sa më shumë. Vuan dhe pëson, po nuk i sh­këput sytë nga drita, të cilën e sheh si nëpër ag nga se shikimi i ishte lëby­ru­r nga lodhja dhe mundimet. Sa ka përshtypjen se i është afruar Bukurisë, të Bukurës, Floçkës, ajo bën një hark dhe i largohet edhe më shumë në çastet kur shpeshtohen murmurimat dhe bubullimat e hatashme dhe kur kishte lënuar dorën e majtë dhe i ishte shtangur krahu tjetër.

As kjo nuk e gjunjëzon; vazhdon udhëtimin drejt Floçkës për arsye se vetëm aty e sheh shpëtimin, ngadhënjimin mbi të gjitha ato të këqija dhe vuajtje, nga të gjitha ato gërmadha, krratje (kërritje) të derës, që i përngjan një vajtimi të mnershëm sa derdhet edhe në lot. Pra, rrënimet janë të mëdha dhe kudo. Kudo kishte qen dhe ata ishin tubuar (një qen e kafshon në pulpën e këmbës e ky e qëllon me thikë në qafë); shtegtari rrëzohet e çohet, rrëzohet e çohet, po nuk ndalet, ndërsa në shtyllë:

[...] ishte flamuri i ri, ku ajgëtonte një kryq të thyer. Kryqi i thyer ishte i zi, kurse qentë ishin gjithfarë ngjyrash. Ata ishin grumbull, sepse midis tyre kishin prenë, të cilën mundoheshin për ta copëtuar. Hungëronin, angullonin, lehnin, turreshin - një dreq e di çka bënin. Shih­te, mandej, se si ndonjëri prej tyre rrëmbente nga një copë dhe shpejt dilte jashtë grumbullit. I turreshin të tjerët, por ai largohej, ikën. E ndiqnin edhe pak dhe dikur hiqnin dorë prej tij; ktheheshin shpejt te preja, për të rrëmbyer edhe vetë ndonjë copë.

Shkrimtari i vërtetë e gjakon dhe e shpreh në veprën e vet letrare të vërtetën e mundshme, të vërtetën artistike²¹, të cilën duhet ta përligjë vetëm nëpërmjet bukurisë²².

Nuk e di nëse ajo që u tha mund të ndihmojë që t’i bëhet tregimit “Floçka” një lexim sa më i thellë ose së pakut, ta bëjë më shumë­sor komunikimin më të? Interpretimi vetjak (personal) mbetet, siç është e njohur, gjithmonë një variant i mundshëm edhe për personin konkret kur e lexon në rrethana e kushte të ndryshme.

Nëse nisemi nga mendimi i Oskar Valdit (Oscar Wilde) se bukuria është një nga format e gjenisë dhe si e tillë mbasi s’ka nevojë për shpjegim, atëherë tregimi *Floçka*²³ i Anton Pashkut, ndër tregimet më poetik të prozës sonë në vijën vertikale, i mjafton vetës. Ndoshta varianti i mënyrës së komunikimit, i interpretimit që u shpreh në këtë punim, edhe pse s’kishte këtë qëllim, mund ta kufizojë hapësirën dhe qenësitë kuptimore të tij. Them kështu nga se gjithçka që do të mund të thuhet për këtë tregim, teksti i tij poetik thotë më shumë dhe në mënyrë më të natyrshme e më burimore se çdo formë tjetër e shkrimit. Këtë gjë e shkakton gjuha poetike dhe qenësia e të shprehurit poetik që ngërthen në vete kuptime të shumta, për të mos thënë të pafundme. Llojet e tjera të shkrimit kanë peshë të dorës së dytë (anësore), siç mund të ndodhë edhe me këtë punim.

Prishtinë, dhjetor 2025

^[1] Shih mendimin e Lessingut në fillim të romanit tim Gjin Bardhela i arbresh & Etja e gurëzuar. Botimi i dytë me ndryshime. Faik Konica, Prishtinë 2024.


^[2] Edgar Allan Poe, Poezi dhe ese, vep. e përm., f. 21

^[3] Prozën e parë Në gjiri (të shkurtër) e botoi në revistën letrare “Jeta e re” nr. 5/1955, ndërsa përmbledhjen e parë me tregime me titull Tregime më 1961.

Kur kishte zënë të ngjitej nëpër atë përpjetëze - thotë përralla për të, përralla për të dhe tërë atë dashurinë e tij jo të rëndomtë - kishte pasë rënë terri. Në fillim, atje diku te një lis i vetmuar, pranë të cilit ishte ndalë për të soditur me kërshëri fushën, iu kishte dukur se ai terr sikur rigonte ngadalë, sikur rigonte imtë prej dikah lart në fushë, ku gjithnjë e më pak ajgonte gjërat e ndryshme. Sa më e dendur bëhej ajo rigë, aq më shumë zvogëlohej hapësira përpara tij, kurse arat, livadhet dhe drunjtë e shpërndarë andej e kënde, më parë humbnin trajtat e veta e, fill mandej, tretnin në terr dhe nuk shiheshin më, por, ajo kohë muzgu kishte kaluar dhe tash ky ndodhej po nja dy orë të mira larg atij lisi. Tash edhe errësira kishte arritur çdo kund dhe prej saj nuk mund të shihte, të thuash, gati asgjë rreth e rrotull. As hëna nuk dukej kund. As yjet. Ecën si nëpër blozë, që kishte veshur secilin send dhe mbushur tërë hapësirën.

Ndjente vetëm hapat, hapat e vet të lehtë, që i ndërronte me shumë kujdes, sepse terri ishte aq i dendur, sa mund t'i rrëshqiste këmba në ndonjë rrasë e mandej të rrokullisej nëpër atë farë shpati. Në të vërtetë, kishte përshtypjen se posë rrasave, posë gurëve nuk kishte gjë tjetër në atë bokërinë të mjerë - ndoshta, aty-këtu, kishte fije bari, ndofta vetëm ndonjë grusht fijesh bari të shtrënguara midis gurëve dhe asgjë tjetër.

As ajri nuk lëvizte; nuk ndjehej pikë fryme, por, mendonte, ajri nuk do të lëvizë dhe pikë fryme nuk do të ketë vetëm për disa çaste, sepse në largësi dëgjoheshin murmurimat dhe herë-herë, si rreze të shkurtra, shiheshin vetëtimat duke shkrepur. Kurse këtë e çonte rruga shi andej ku dëgjoheshin murmurimat e shiheshin ato vetëtima, thotë përralla, rruga e vështirë, nëpër të cilën kurrë deri më atëherë nuk e kishte bërë asnjë hap dhe nëpër të cilën, duke u përshkruar nëpër atë errësirë të mallkuar, nganjëherë edhe zinte në thua, si tash kur, pas një përpjekje të madhe, mezi mbeti disi në këmbë pa u rrëzuar. I kishin gufuar djersët dhe, duke i fshirë me mëngën e setrës, kishte ndjerë edhe rrokullisjen e gjatë, shumë të gjatë të një guri, që kishte pas lënë pas vetes njëfarë zhurme që jehonte thekshëm e, ngapak, edhe mnershëm në atë qetësinë e asaj natës së zezë si pendla e korbit. Ishte ndalë. Kishte menduar pak për gjatësinë e rrokullisjes së gurit, ku kishte zënë në thua, për gjatësinë e zhurmës së atij guri, që ishte shkaktuar nga përplasja e tij prej një rrase a shkëmbi në ndonjë rrasë a shkëmb tjetër. Në fund, mbarimin e asaj farë zhurme e kishte pasë shoqëruar edhe pingrima e njëfarë zogu nate, kushedi çfarë zogu nate, që këtij nuk i kishte pëlqyer, sepse ajo pingrimë iu kishte dukur shumë ndjellakeqe, pingrimë që tërë atë errësirë dhe atë qetësi rreth tij ia kishte bërë edhe më të rëndë, edhe më të padurueshme; ajo nuk kishte mbetur vetëm: pas një trohë herë ishte shtuar në dy, mandej në tri dhe dikur ishte shumëuar në kushedi sa pingrima të tjera. Të gjitha së bashku krijonin një oshëtimë të tmerrshme. Dhe, në një çast, ajo oshëtimë iu duk si të ishte qeshje, qeshje e mortjes, qeshje që thërriste, thërriste, thërriste...



ANTON PASHIKU

Floçka Tregim

Ishte i zbetë kur, padashur, kishte ndërruar nja dy hapa prapa - kallëzon përralla. Mbasi ishte prapsur, kishte vazhduar përsëri të dëgjojë atë qeshje, tërë atë valë pingrimash trishtuese, të gjitha ato qeshje si të mortjes, të cilat, befas, ishin mbytur nga një zë tjetër. Ai nuk vinte prej andej, prej nga kishin ardhur ato qeshje. Dëgjohej nga ana e majtë. Kishte kthyer kryet, si me drojtje: kishte parë, atje diku kah kurri i malit kishte parë një flakë, një grusht drite. Ajo rrinte gjithnjë në një vend. Ai zë, posë të cilit, tash, nuk dëgjonte asgjë tjetër, vinte prej andej. Iu kishte dukur se e njihte atë zë. Iu kishte dukur i ngjashëm me zërin që e kishte dëgjuar para do netëve në ëndërr, në atë ëndërrin e ëmbël ku iu kishte dëftuar Floçka. Ah, ai ishte, ai

zë ishte krejt si zëri i Floçkës, të cilën aq shumë e kishte kërkuar nëpër puse dhe buzë lumenjve; krejt si zëri i saj që e thërriste në ëndërr të shkojë te ajo. Sa e madhërishme iu kishte dëftuar në ëndërr! Kurrë vashë më të bukur nuk ka parë syri i tij! Ishte me flokë të gjatë e të dendur, fijet e të cilëve ishin si mijëra fijesh të arta që shkëlqenin edhe në errësirën më të madhe, kurse në rrezet e diellit, kështu i ka parë në ëndërr, në kryet e saj dukeshin si kurore pishe e ndezur flakë që mund të nxente po nja gjashtë a shtatë copë fshatra rreth e rrotull dhe të shkrinte borën e akullin edhe atje lart, edhe atje mbi kreshtat e maleve! Atë e ka parë në ëndërr. Dhe në ëndërr i tregoi vendin ku banon. I tha se jeton në ujërat e kulluara të një liqeni, që është larg shtëpisë së

tij nja shtatë ditë e shtatë net këmbë. I tregoi, gjithashtu, se ai liqen ndodhet i strukur në midis të një pylli, se ai del para syrit të njeriut mbasi të kesh kaluar shtatë bjeshkë. Ky, në ëndërr, i tha asaj se shtatë ditë e shtatë net udhëtim janë vetëm si shtatë dekika, kurse te liqeni do të arrijë gjallë o vdekur edhe sikur të jetë në skajin më të skajshëm të botës, e jo aty - pas shtatë bjeshkëve... Ajo, kur i kishte dëgjuar këto fjalë, e kishte përkëdhelur butësisht e i kishte dhuruar, madje, edhe një fije floku të artë dhe i kishte thënë diçka po me këtë zë, që tash i dukej se ishte zëri i Floçkës dhe i askujt tjetër. Se ç'i kishte thënë në fund, këtij tash nuk i kujtohej, por i parafytyrohej fare mirë ai shkëlqimi i Floçkës, kur iu kishte dëftuar në ëndërr; nuk mund të vërente asgjë,

që do të dallonte atë shkëlqim prej këtij shkëlqimi që ishte shfaqur atje dikur kah kurrizi i malit.

Bukur gjatë kishte shikuar matanë, kah ai vend, prej nga vinte ai zë, kah ajo anë, ku shihte atë grusht drite, që me aq krenari flakëronte në velin e errësirës. Ishte i bindur se ai shkëlqim i atjeshëm ishte shkëlqimi i flokëve të gjatë e të dendur të Floçkës së tij.

Edhe ky zë, që dëgjohej, e thërriste. Andaj, nuk mendoi më gjatë: e sosi të nisej në atë drejtim.

La vendin, ku kishte zënë në thua në atë gurin, që mandej ishte rrokullisur duke lënë pas vetes atë zhurmën që në fund ishte përcjellë nga ajo pingrimë e atij zogu të natës, i cili e shqetësoi. La, pra, atë vend - kallëzon përralla - dhe u nis kah drita.

Ecën e ecën. Murmurimat bëheshin gjithnjë më të fuqishme, kurse vetëtimat shpeshtoheshin. Murmurimat dëgjoheshin e vetëtimat shiheshin në qiellin përmbi të. Dhe, nuk vonoi shumë, tërë atë anë, nëpër të cilën përshkohej ky shtegtar, filloi ta rrahë një shi i përcjellë me frymë. Ishte kjo një frymë shumë e fortë dhe plot fishkëllima të hatashme, kurse pikat e shiut, si gjilpëra, e thernin në fytyrë, në duar. Mirëpo, për çudi, drita nuk shuhej! Për më tepër, sa më e tërbueshme bëhej ajo frymë, aq më shumë ndriçonte!

Shiu binte papra, rrëmbyeshëm, kurse fryma bëhej për çdo çast më e ashpër. Tash ishte shumë vështirë për të udhëtuar. Duhej t'i bëhej ballë vargut të pandërprerë të valëve të frymës, valëve të hovshme të frymës e, posë kësaj, edhe ai shpat mali ishte bërë shumë i rëndësishëm. Kështu, njëherë edhe u rrëzua, ra përmbys, sepse nuk kishte mundur të qëndrojë në këmbë dhe kishte rrëshqitur. Kur ishte rrëzuar, aty për aty, s'kishte ndjerë gati kurrfarë dhembje. Më vonë, në krahun e djathtë, kishte ndjerë do therje, në fillim të lehta e mandej gjithnjë më të forta. Dikur, krah u kishte mpirë gati fare. Prej mundit, që e kishte pasë kapluar për disa çaste, ballin ia kishin mbuluar do djersë të ftohta. Megjithatë, nuk e ndalte hapin. Njëmend, tash ecën ngadalë dhe me vështirësi, por ecën, së paku lëvizte përpara.

Sytë i kishte gjithnjë kah drita. Atë tash e shihte si nëpër ag, sepse prej mundit edhe shikimi iu kishte turbulluar; por e shihte dhe në atë vend, ku ndodhej ajo, kishte vendosur të arrijë gjithsesi. Shkonte kah ajo herë barkas, herë në këmbë, por shkonte, dhe i afrohej asaj drite, e cila nuk luante nga vendi i vet. Ajo qëndronte aty, ku e kishte vërejtur edhe herën e parë, qëndronte në atë vend, prej nga kishte ardhur edhe zëri, të cilin edhe tash e dëgjonte mirë. Ai zë e thërriste, vazhdonte ta thërriste. Mirëpo, mbasi mezi e kaloi një shkëmb të gjatë, që i kishte pasë dalë përpara (duke u ngjitur nëpër të e kishte lënurë mirë dorën e majtë, kurse me tjetrën, me krahun tjetër të ganduar nuk mund ta vepronte), drita mbeti edhe pak aty dhe mandej u pa duke bërë një hark të shkurtër nëpër qiell dhe ra diku andej përtej kurrizit të malit. Fill pas kësaj shiu mejti, por vazhduan të dëgjoen murmurimat, të dëgjohet edhe më tutje ai zë, që e thërriste ç'prej atij vendi, ku kishte zënë në thua. Shiheshin

edhe vetëtimat. E as fryma nuk e ndalte turrin e vet.

Vazhdoi të ngjitej nëpër atë përpjetëze të vështirë, ashtu me krahë të mpirë e dorë të lënurur.

Kur kishte arritur deri në një shenjë vendi - vazhdon të kallëzojë përralla - toka ishte trandur e ajri ishte dridhur, njëfarë drite e kuqërreme kishte zdritur mbarë vendin dhe bashkë me të ishte dëgjuar një bubullimë e hatashme, kurse mandej, atje mbi kurrizin e malit, ishte parë një shtëllungë e madhe tymi që ndriçohej nga poshtë prej zjarrit. Edhe katër herë të tjera ishte përsëritur ajo dritë e kuqërreme, ajo bubullimë e hatashme, edhe katër herë të tjera ishte parë edhe ajo shtëllungë e madhe tymi që ndriçohej nga poshtë prej zjarrit.

Ishte ndalë. Ndjente jehonën e bubullimës, po edhe kumbimin e zërit të njohur. Prapë kishte vazhduar të ecë. Nuk e ligështonte krah u i ganduar, e as dora e lënurur. Zëri i Floçkës, që e thërriste, ia forconte zemrën.

Dhe kur më në fund kishte arritur në atë kurriz mali, ishte shtrirë për të pushuar pakëz. Diktoi se aty, rreth tij, nuk dëgjohej ai zëri i njohur. Atë zë tash e dëgjonte duke kumbuar diku më tutje. E, pra, gjatë tërë kohës iu kishte dukur se ai zë kishte kumbuar shi në atë vend, ku tash ishte shtrirë për t'u shlodhur, ku i dukej se nuk e kishte një krah, atë krahun që iu kishte mpirë krejtësisht, shi në atë vend ku shihte se qielli kishte zënë të larohej prej do ishujve të kaltër, ishujve të vegjël, në disa prej të cilëve dukej edhe nga një yll, edhe nga ndonjë sy drite. Kishte vërejtur mandej se skajet e atyre ishujve të vegjël të kaltër ishin të kuqërreme prej rrezeve të para të diellit. Po, donte të agojë, dita donte të agojë. Dhe, në atë ag, kishte ndjerë njëfarë ere të rëndë. Ishte erë shkrumbi, erë gjërash të djegura. Ishte çuar. Në atë çast kishte lëshuar një shikim andej, prej nga kishte ardhur deri aty; asgjë, nuk kishte parë asgjë, sepse mjegulla kishte mbuluar atë anë. Mandej u zdorgj dhe arriti deri te një shkëmb. Aty kuptoi se prej nga vinte ajo erë, ajo duhmë. Ishte era, ishte duhma e një fshati të djegur. Aty pa vetëm gërmadha. Pa vetëm nja dy a tri pullaze, por edhe ato ishin të shkatërruara. Pa edhe një derë, e cila për habi kishte mbetur e kapur për vendin e vet të përhershëm. Edhe pragun e saj e pa. Atë derë e shtynin valët e frymës së tërbuar herë këndej e herë andej. Kur e shtynin, ajo krratte. Krratte si të ishte diçka me të vërtetë e gjallë. Pikëllueshëm. Ajo krratje e pickonte në zemër. Prandaj edhe i kishin gufuar lotët duke parë atë derë, duke dëgjuar krratjen e saj, krratjen e derës së asaj shtëpie të rrëzuar, të shkatërruar.

Nuk kishte fuqi t'i afrohej më shumë fshatit. Rrinte ulur rrëzë shkëmbit. Sodiste gërmadhat. Duke soditur, kishte dëgjuar mjaullimën e një maceje, mandej edhe të lehurit e një qeni. Të lehurit të tij iu kishin bashkuar edhe shumë të lehura të qenve të tjerë. Duke dëgjuar gjithë ato të lehura, i kishte thënë një mendje se aty ishin tubuar gjithë qentë e mbarë botës. Vërejt i më mirë: pa se ata qen ishin tubuar afër një shtylle. Kurse në shtyllë ishte një flamur i zi, ku ajgtonte një kryq të thyer. Kryqi i thyer ishte i

zi, kurse qentë ishin gjithfarë ngjyrash. Ata ishin grumbull, sepse midis tyre kishin prenë, të cilën mundoheshin për ta copëtuar. Hungëronin, angullonin, lehnin, turreshin - një dreq e di çka bënin. Shihte, mandej, se si ndonjëri prej tyre rrëmbente nga një copë dhe shpejt dilte jashtë grumbullit. I turreshin të tjerët, por ai largohej, ikën. E ndiqnin edhe pak dhe dikur hiqnin dorë prej tij; ktheheshin shpejt te preja, për të rrëmbyer edhe vetë ndonjë copë.

E dera krratte. Flamuri i ri me kryq të thyer e të zi valonte në fshat. Qentë lehnin.

Kurse në qiell, dikur, ishte dëgjuar krrokatja e një korbi. S'kishte vonuar dhe fill pas krrokatjes së parë ishin dëgjuar edhe krrokatjet e shumë korbave të tjerë të zez, që fluturonin mbi fshat. Me ato krrokatje ishin përzier edhe të lehurat e qenve. Mezi dëgjohej krratja e derës.

Nuk mund të rrinte më aty e të shikonte qentë duke copëtuar prenë e tyre, të dëgjonte të lehurat e qenve afër shtyllës me flamurin e ri që kishte atë kryqin e thyer e të zi, nuk mund të rrinte e të dëgjonte krratjen e derës, të ndjente erën, duhmën e gjërave të djegura, erën dhe duhmën e fshatit të shkrumbuar. Me lot për faqe u largua prej atij fshati të mjerë, mbi qiellin e të cilit fluturonin edhe korbat e zez.

Hyri në pyllin që gjëmonte, sepse aty valët e frymës dhe fishkëllimat e saj ishin edhe më të rrepta, edhe më të ashpra, por ende pa i bërë mirë disa hapa, i dol përpara një qen i madh sa s'bëhet. Kishte dalë papritmas prej një kaçube, ku kishte pasë ardhur, me gjasë, për të fshehur një copë të asaj preje, rreth së cilës i kishte parë të tubuar qentë e fshatit. Qeni ishte turrë kah ky. Në atë çast, kur kishte dashur të skajohet pak si anash, kishte ndjerë dhëmbët e tij në pulpën e këmbës. Vrik ishte kthyer. Dora e tij e lënurur kishte rrëmbyer thikën në shokë. Dhe kishte fluturuar drejt qafës së qenit. Ai kishte nxjerrë dhëmbët e vet prej pulpës së këmbës dhe me bisht ndër shalë, por ngutshëm e duke lehur, ishte larguar me thikë në qafë. Edhe ky ishte ngutur të largohej prej atij vendi. Këmba e përgjakur nga dhëmbët e atij qeni, nuk e mbante. Rrëzohej, mandej përpiquej të çohej në këmbë, por përsëri rrëzohej e rrokullisej nëpër pyll. Kështu nuk mund të largohej shpejt, të ikë sa më shpejt nga ai vend, nga tërë ajo llavë e qenve të tërbuar, të cilët, kur kishin dëgjuar ulurimën e atij qeni me thikë në qafë, ishin turrë kah pylli, duke kujtuar se ai kishte ndeshur në ndonjë pre të re më të majme. Të lehurat e tyre dëgjoheshin gjithnjë më afër. Kurse ky rrëzohej, çohej, rrëzohej e rrokullisej nëpër pyllin që gjëmonte prej valëve të frymës dhe fishkëllimave të saj. Së bashku me valët e frymës dhe fishkëllimat e saj dëgjo i dikur edhe krrokatjet e korbave të zez, të cilët tash fluturonin pareshtur përmbi pyll. Ishin aq shumë, sa dukeshin si një ombrellë gjigante, por e tmerrshme, e cila nxinte pyllin edhe më tepër.

Ky dëgjonte edhe atë zërin e njohur, që e thërriste pas vetes që nga vendi ku kishte zënë në thua. Ai edhe i jepte fuqi për të lëvizur. Mirëpo, krah u dhembte shumë, e edhe këmba, që ia kishte kafshuar ai qen i mallkuar, i dhembte

shumë; tash ajo iu kishte ënjtur. Nuk mund ta luante. I dukej tepër e rëndë, si të ishte ndonjë cung. Njëherë ra përmbys, kurse mandej u kthye në kokërr të shpinës. Rrinte ashtu i shtrirë pranë një lisi qindvjeçar. Dëgjonte të lehurat e qenve, krrokatjen e korbave, oshëtimën e pyllit. Nuk i vinte keq pse afroheshin qentë, por i vinte kaq sa s'ka pse nuk po mundte të ecë edhe pak më shumë, pse nuk po mundte të shkonte edhe pak më tutje dhe të shihte Floçkën. I vinte keq, mbasi kishte arritur kaq shumë afër saj, diku krejt afër Floçkës. Ky e dinte se është afër asaj bukurie të rrallë, sepse shtatë ditë e shtatë net kishte udhëtuar dhe shtatë bjeshkë i kishte kaluar. Kjo ishte ajo e shtata bjeshkë, ku gjendej liqeni i Floçkës, liqeni me ujë më të kulluar në botë.

Megjithatë, ishte edhe i kënaqur, madje edhe disi i lumtur, që Floçka, së paku, iu kishte dëftuar në ëndërr, që së paku e kishte parë në ëndërr tërë bukurinë e saj. Ishte, njëmend ishte i kënaqur që Floçka iu kishte dëftuar, që kishte parë sytë e saj magjikë, shikimet e tyre, ato shikime të syve të saj që me nxehtësinë e vet mund të të shkrijnë, të të shndërrojnë në flakadan, në shkëmb të bazalt. Ishte i kënaqur, e edhe i lumtur, që kishte njohur Floçkën së paku nëpërmjet të një ëndrre, Floçkën e bukur me flokë të gjatë e të dendur, që shkëlqejnë si mijëra fije të arta, të cilat në kryet e saj duken si kurorë e ndezur, si kurorë pishe e ndezur flakë, që mund të nxejë po nja gjashtë a shtatë copë fshatra e të shkrijë borën e akullin edhe atje lart, edhe atje në kreshtat e maleve.

Qentë afroheshin, korbat krrokatnin. Edhe ai zë i njohur për të - kumbonte. Të gjithë i dëgjonte. Në heshtjen e vet. Rrinte i shtrirë pranë atij lisi, krejt i qetë dhe aspak i trazuar. Edhe një buzëqeshje, madje, titronte në buzët e tij. Ajo mbeti aty edhe mbasi mbylli sytë. Dukej se flinte, dukej se buzëqeshte, dukej sikur ishte duke ëndërruar Floçkën e vet. Në ato çaste, nëpër kurorën e lisit qindvjeçar përshkoheshin kushedi sa rreze dielli; ishin si qindra-mijëra fije të arta, që ishin derdhur mbi të.

Kurse nga liqeni i asaj bjeshke - thotë përralla mandej - kishte buruar diçka, që dukej si grusht drite. Dhe kishte bërë një hark të shkurtër nëpër qiell e kishte rënë pranë atij lisi qindvjeçar. Sa çil e mbyll sytë, ai grusht drite përsëri kishte fluturuar nëpër qiell. Njerëzit kishin parë diçka në gjitë e asaj drite. Kishin parë edhe se si ajo kishte rënë mbi liqen. Dhe, në atë çast, kishte filluar mrekullia e re: tërë liqeni shkëlqente me një aso drite, të cilën, thotë përralla, s'ka gojë që mund ta përshkruajë.

Një mori rrezesh të flakta kishin gufuar prej atij liqeni. Një mori rrezesh të flakta ishin shpërndarë në të katër anët.

Ato rreze kishin lëbyrë korbat dhe ua kishin djegur krahët. Shumica kishin cofur pa rënë mirë në pyll. Disa të tjerë kishin mundur të ikin. Ata edhe tash krrokatin.

Ato rreze kishin lëbyrë edhe qentë. Nga nxehtësia, shumica e qenve kishin ngordhur. Disa të tjerë kishin mundur të ikin. Ata edhe tash lehin.

(1963)

Kishte disa ditë rresht që, në trotuarin Kpërgjatë kafenesë Killing Time, qëndronte një GAZ 69 .Herën e parë e vështrova me habi dhe kërshëri, sepse paraqitja e tij nuk po më përputhej me atë çka më kishte mbetur në kujtesë; e përfytyroja më të madh dhe më të zymtë dhe, mbi të gjitha, më agresiv.E si mund ta përfytyroja ndryshe, pënderisa ai çdo herë më lëvizte në sfondin njëngjyrësh të diktaturës, duke çuar vaj dhe mort kudo që ndalte?

Tashmë, që nga kafeneja ku isha ulur, e vëreja dhe e vëreja me përkushtimin e një spektatori të vëmendshëm në sallën e një teatri, i cili priret çdo çast për të ndjekur ngjarjet dhe fatet e personazheve.ndonëse objekti që kisha unë ballë për ballë nuk lëvizte dhe nuk bëzante.

Po kush ta kishte vallë këtë relikte të Sigurimit të shtetit komunist, këtë metaforë të mynxyrtë të tij, që rrinte haptazi dhe si pa turp aty, midis makinave të tjera,të modeleve të fundit, mu si ai gangsteri që ka marrë garanci të plotë nga kapot e policisë se, nuk e trazon njeri?

E pra, kush e kishte dhe nga ta kishte nxjerrë në një gjendje aq të mirë teknike?

Sepse, të paktën, kështu ta linte përshtypjen nga pamja e jashtme.

Me atë të gjelbrën e shpifur ushtarake, mushamanë e zezë blozë,parafangot me forma dhe vëllime të plota, si nofulla të shtrënguara, me grilën e lartë të radiatorit dhe,me fenerët errumbullakët si sy të shqyer, ajo makinë m'u duk veçse e shëmtuar dhe e mjerë, ndonëse në përgjithësi,automobilat e prodhuar tri apo katër dekada të shkuara, të pëlqejnë dhe të joshin së tepërmi, kur i ndesh rrallë e më rrallë nëpër rrugët e përmbytura nga trafiku,duke të ngjallur një nostalgji të ëmbël, të përfutur edhe nga mbresat e filmave të periudhës së tyre...

Një mëngjes, një mëngjes të atyre të dielave të boshatisura të Tiranës, e gjeta përsëri ndanë trotuarit gjashtëdhjetenëntëshin, që po të më lejonte drejtshkrimi, do të kisha dashur ta shkruaja gjashtenënçin...

Te xhami i derës së shoferit, te xhami i ngushtë si frëngji, i kapur te mushamaja, jo drejt e te korniza mtalike e derës, ishte ngjitur një letër, ku shkruhej:

Shitet

Me çmim të arsyeshëm

Cel 0692484764

Iu afrova dhe nisa t'i vij rrotull,siç i vihet edhe një kali që shitet dhe, më pas e ngjesha fytyrën pas xhamit dhe këqyra brenda në kabinë: ndenjëse të zeza, kruskotë e zezë, timon dhe levë e gjatë marshesh e zezë; një kult i vërtetë i të zezës, në atë skëterrën si qeli ambulante burgu, ku të fusnin me pranga ndër duar dhe, të ngjeshnin në mes dy agjentë të ngjallmë si derrat !

Por ja sot,shitej me një çmim të arsyeshëm...

- Ej ; - m'u afrua një burrë rreth të pesëdhjetave - si po të duket?

- Pash Zotin, ku e ke rrëmuar ? Jotja është?

- Ende po.Ku e kam rrëmuar, the? Pse, pak të tilla kishte nëpër tunelet dhe nëpër magazinat e ushtrisë? Përse po çuditesh? Unë pandeha se deshe ta blije.A e di ti se, çfarë makine është kjo? Tank ore tank!Ma kanë kërkuar shumë njerëz deri tani, por unë dua ta heq aqsa e kam ndarë mendjen që në fillim.Bjeri, bjeri llamarinës me çokun e dorës! - më propozoi, por në fakt i ra vetë bam bam bam - E dëgjove çfarë tingulli kumbues nxori? Ç'kanë makinat e blinduara më tepër? Asgjë.

- Unë or mik, nuk do ta blija këtë makinë kurrë; nuk do ta merrja madje, as edhe po të ma falje.

- Mos u mërzit, mos u mërzit, sepse ka plot nga ata që ma kërkojnë.

- Çfarë pune ke bërë, apo edhe çfarë pune bën tani?

- Kam qenë kapter ushtrie, mareshall me një fjalë,siç talleshim ne mes njeri – tjetrit; tani shes materiale ndërtimi në një pikë shumice.

- Të lumtë ty,ja që u bërë vërtet mareshall...

- E mora vesh unë; ty të pëlqen kjo BMW X5 këtu, apo ai Lexus pas saj; shkëlqejnë ato, shkëlqejnë, janë të bukura, të shpejta,

KONSTANDIN DHAMO GAZ 69 Tregim

luksoze sa më s'ka, por me këtë nënoken time asqë krahasohen ...

... *Korb i zi që çan e krakëllin krak krak nëpër natë!* Kush kishte lënguar duke e shkruar këtë varg për këtë përbindësh të Sigurimit ?Nuk po më vinte kursesi ndër mend autori, por kush ta kishte shkruar tjetër, përveçse ndonjëri nga ata poetët e pushkatuar, të mbetur pa varr, apo ndonjëri nga ata të burgosurit gjatë diktaturës po aq vite sa edhe vetë Mandela;krak krak korb i zi nëpër natë...

Nuk ka arrestim në emër të popullit që të mos jetë kryer me këtë makinë,e cila i kalte datën kujtdo që e haste përpara,pale të të ndalte te dera e shtëpisë !

Por këtë makinë nuk e përdorte vetëm Sigurimi Shqiptar; këtë makinë e përdornin për të njëjtin qëllim të gjithë vendet e Europës Lindore, të ashtuquajtur vende të demokracisë popullore, duke përfshirë pa dyshim edhe vetë Bashkimin Sovjetik, ku kjo makinë prodhohej...

GAZ 69! Duke përsiatur për të, filloi të më dukej sërish agresive, madje këtë herë më shumë nga ç'më kishte mbetur në përfytyrimin tim, aqsa për një çast m'u bë sikur do t'i zgjoheshin instinktët, do të përndizej dhe, të gjitha ato makina farfuritëse përqark, do t'i ngjeshte shuk në një qoshe!

GAZ 69, Gorkovski AvtoZavod,e plotësova këtë akronim dhe,atëherë u kujtova se kjo makinë prodhohej në uzinën e një qyteti që mbante emrin e shkrimtarit Maksim Gorki,emër që tashmë ia kanë hequr, ashtu si edhe Stalingradit, etj...

Por ky akronim në gjuhën shqipe formon një fjalë që ka disa ngjyime dhe ja : gaz - ndjenjë gëzimi,hareje dhe kënaqësie...

Por ky GAZ vetëm gaz nuk sillte...

Pas ndonjë muaji u ktheva përsëri te kafeneja Killing Time dhe përsëri e gjeta gjashtëdhjetenëntëshin ndanë trotuarit. Nuk po iu ndaka këtij vendi, e shpotita me vete kapterin e qerestësë; o e shet këtu rrotull, o plas!

Mirëpo, kur iu afrova makinës, vura re se, ajo letra e ngjitur te xhami, tek e cila shkruhej *shitet*, nuk ishte më.Pa dale...

- Ulu këtu nëse dëshiron - më ftoi me shumë mirësjellje në tryezën e tij një ish i burgosur politik, duke buzëqeshur intrigueshëm - Gjithmonë kam dashur të pi një kafe me ty, por ti se ç'vjen me ca tipa që unë nuk i honeps fare.Heu ; s'mbahet mend sa vite kemi që njihemi së largu , kështu ?

E falënderova dhe u ula, për më tepër, ngaqë nuk pashë të kishte tryezë të lirë.

- Po shihja atë makinën aty, atë makinën e Sigurimit; ka kaq kohë që i zoti i saj e parkon këtej me kokëfortësi, gjersa ta heqë qafe.

- O,e ka hequr qafe sakaq,e ka hequr qafe; gjithmonë gjendet një budalla në kësi rastesh.Ia bleva unë...

- Ti , ti i burgosuri i ndërgjegjes !?

- Po, po unë; aqsa më kërkoj.

- Të shohim çfarë do të na kallëzosh ...

- Për burgun asqë do ta hap gojën, sepse për çudi , ka filluar të më duket sikur riprodhoj përmendsh ca historira të të tjerëve , por për Gazin , po : i kisha aq para pra...

- Nuk e pata fjalën te paratë jo, por desha të di se, si mundesh pikërisht ti të futesh, e pale ta ngasësh atë makinë! Atë makinë me të cilën një ditë të mallkuar erdhën dhe të lidhën me pranga! Nuk të kap frika dhe paniku si dikur? Nuk acarohesh ?



- Ah,sa mirë e ngas unë atë makinë, sa mirë e ngas.U gëzova si kalamajtë, kur e pashë për herë të parë, aty te trotuari dhe, menjëherë më lindi dëshira ta bëj timen. Nuk u rrëqetha nga frika se mos kishin ardhur të më arrestonin prapë, jo,jo.Nuk jemi më në vitet '70 apo '80; jemi në vitin 2007, thellësisht në demokraci...

Me atë makinë po vetëkryej një psikoterapi të dobishme dhe të suksesshme. Ja, tashmë e zotëroj unë mjetin e robëruesve të mi.Kam filluar ta luaj arrestimin tim, ta tall dhe ta përqesh dhe, për rrjedhojë edhe ta zh dramatozjoj.Shih, çfarë itinerari përshkoj: nisem nga shtëpia që kam pasur, kur më vunë pranat dhe vete deri te burgu i vjetër i Tiranës, tek i cili më hodhën në fillim. Gati - gati po zbatoj atë formulën *plumbi del me plumb*.

Në fillim, mbi xhamin e përparmë, vura fotografinë, ku kishin dalë kokë më kokë ime më me tim atë, duke buzëqeshur, siç i kishte urdhëruar para shkrepjes fotografi dhe, sa herë e ndalja Gazin për pak çaste ndanë portës së zezë të burgut, bashkëbisedoja me ta, dënueshmërisht të mirit, si me Zotin vetë ! Ata vdiqën në pikëllim njeri pas tjetrit, gjatë kohës që unë isha në birucë , kështu që s'i varrosa dot, sepse nuk më dhanë leje. Por, bashkëbisedova me ta dhe u qetësuan kur i sigurova se tashmë isha krejtësisht i lirë ...

Pas shtatë ditësh, si të vazhdoja të kryeja një detyrim moral të njëmendtë, ngjita po natë vend fotografinë e ish të fejuarës sime! Njëzetvjeçare,me flokë të gjatë që s'harrohen, ajo shndrit natë pozë, tek të vështron me çiltërsi...

Edhe ish të fejuarën e çova gjer te porta e burgut, por nuk bashkëbisedova; veçse i urova jetë të lumtur në familjen e saj të re, paçka se u shkëput prerazi prej meje, që atë ditë që më arrestuan...

Dhe nënqesh unë me ironi kur mbërrij përpara burgut ; ironinë, sidoqoftë s'e e shmanga dot. Nuk kam menduar të hakmerrem ndaj spiunëve të mi,sepse ne të burgut përbëjmë një si sekt fetar më vete, që predikon përparësisht urti dhe paqëtim, por të paktën këto ecejaket e përcaktuara në fillim, si të ditës së arrestimit e tash së fundmi edhe revani shpërthyes udhëve ngado, po ma qetësojnë shpirtin së tepërmi, siç ta thashë një herë, prandaj një ditë t'afërme do të qesh me të madhe ja, duke e pasur në dorën time tashmë timonin e kësaj makine...

Tetori kishte sjellë një diell të butë, dhe ajo ditë dukej e zhurmshme. Disa zogj që ende nuk ishin nisur për shtegtim, cicëronin mes gjetheve të zverdhura që era e lehtë po i shkëpuste një herë e mirë nga degët e tyre. Hyra në lokal me dëshirën e mirë që të pija një kafe në qetësi, pa zhurma, në një qoshe ku mund të mendoja pak për veten, larg të gjithëve. Por natyra e qytetit tonë dhe e njerëzve që jetojnë në një botë “live” kishte plane të tjera për mua.

Kur hapa derën, aroma e kafesë më ngacmoi me butësi, duke më uruar një mirëseardhje simpatike, por sa u ula, m'u krijua përshtypja se gabimisht isha futur në një zgjua bletësh, por me të vetmin ndryshim: ata që gjeta brenda kafenesë ishin njerëz që gumëzhnin në bisedat e tyre dhe nuk punonin pa u ndalur, siç bëjnë bletët. Një vajzë me flokë të thurura gërsheta, që shtrëngonte një selfie-stick të gjatë, pasoi me zërin e saj potent:

“Hola mi genteee!”

Përsëndetjet në gjithë botën!

Hello! Yassou! Ciao! Bonjour! Salam alejkum!”

Ela Selfie, siç e quanin të gjithë, filloi të fliste për TikTok-un dhe “sekretet e jetës moderne” duke i kthyer tavolinat e lokalit në një studio televizive. Ndërsa përpiquesha të gjerbja kafënë e ngrohtë, ajo pyeste ndjekësit e saj se kush kishte marrë pjesë në eventet e fundit dhe sa herë kishin pirë kafe vetëm, në “qetësi”. Nuk dija ç'kishte ndodhur në takimet e tjera live, por për një gjë isha i sigurt: kafen e sotme do e pija në shoqëri. Dhe çfarë shoqërie se...

Në tavolinën pranë, dy motra po bisedonin me video-call: nga ana tjetër ligjëronte motra e Greqisë. Dialogu ishte një miks shqip-greqisht i tillë, sa që, vetëm ato të dyja mund ta kuptonin njëra-tjetrën, por edhe për këtë, kisha dyshimet e mia:

“E re, motër, e ke marrë lejen?” pyeti ajo që ishte ulur një tavolinë më tutje nga ajo ku qëndroja unë.

“Eeh, e mora re! Po akoma s'kanë dhënë *apodikseis*, më kupton?”

“Çfarë janë ato?”

“Apodikseis re, apodikseis! Fatura, dokumenta! Këtu pa *apodikseis*, s'të japin *tipota!*”

“Po ç'të japin moj?”

“Tipota re, asgjë!

“Unë nuk kuptoj asnjë fjalë nga ato që the!”

“E mirë, po ta them vetëm në shqip, se na dalin fjalët gjysma-gjysma: s'na japin lekët pa letra, e kuptove tani?”

Dialogu u shndërrua në një shfaqje, me ndërhyrje dhe përsëritje, ndërsa unë përpiquesha të mos dëgjoja, por çdo fjalë e tyre më depërtonte, si tinguj të një simfonie të çuditshme, gati- gati të bezdisshme.

Në një cep tjetër, një çift po fliste me djalin e tyre në Itali. Dialogu ishte gjysmë shqip-gjysmë italisht, dhe çdo fjali ishte më e komplikuar se e mëparshmja:

“Si, si, mama, e kam bërë kërkesën *per documenti*. Duhet të futeni në e-Albania.”

“Ku të futemi, bir?”

“Në e-Albania, mami! Është *pagina* interneti!”

“Po ku është kjo? Në postë?”

“Jo, jo, në kompjuter, në internet!”

“Ne kemi televizorin, po aty a del?”

“O Dio! Jo, mami! Në kompjuter, që të bëni verifikimin për pensionin!”

“Po s'na del as letra e dritave, çfarë pensioni bir?”

Djali përpiquej t'u shpjegonte hap pas hapi si të krijonin një llogari, ndërkohë që prindërit e tij përpiqueshin të kuptonin konceptin e “email-it” si të ishte një makinë magjike. Dialogu i tyre zgjati disa minuta, dhe unë ende nuk kisha arritur të gjerbja kafënë time, që aq shumë e kisha dëshiruar atë mëngjes. Ndërkohë, turistë të ndryshëm hynin në lokal duke bërë selfie me pamjen e mrekullueshme nga deti, ndërsa një mace rruge, e cila ndodhej jashtë e po shijonte

TEUTA DHIMA

...Offline

Tregim

rrezet e diellit, u bë pjesë e “live”-it, duke u kapur nga *Ela Selfie* dhe duke u bërë hit ndërkombëtar për disa minuta. Macja e shqetësuar nga thirrjet e Elës që ishin një hap larg britmës, lëvizi e dembelosur dhe zuri një tjetër cep, ku rrezet e mbulonin të tërën. Ktheu edhe njëherë kokën nga Zana dhe lëpiu mustaqet si për t’i thënë: “Se mos më vjen edhe këtu...”

Unë përpiqesha të gëlltisja kafen e ftohur dhe mendimet e mia për “qetësinë e munguar” u shndërruan në një monolog të brendshëm që më shqetësonte jo pak: “Në këtë qytet, nuk mund të shkosh në një kafene, pa u bërë pjesë e spektaklit. Ndoshta edhe ajri ka Wi-Fi.”

Djali, që fliste nga Italia, filloi të raportonte për dokumentet e emigrantëve që nuk u njiheshin, duke lexuar me zë të lartë çdo nen të rregullores. Ndalonte herë pas here dhe nga reagimet e prindërve të tij, dukej se punët nuk i kishin shumë në terezi. Të atit të djalit i mungonin disa vjet pune për të përfutur pensionin e plotë. Meraqet e çiftit përziheshin herë pas here me komentet e *Ela Selfie-s*, duke krijuar një orkestër kaotike. Çdo ndërhyrje ishte më komike se tjetra, dhe unë ndihesha si pjesë e një tabloje të gjallë karikaturale. Vendosa të ngrihem. Dëshira për të pirë një kafe në qetësi buzë detit mbeti pezull. Kafja m’u ftoh, pa e pirë...

Unë nuk kisha asnjë problem pensioni, as leje të zakonshme të papaguar, as dëshira për video live dhe për komunikime, por ja që dashur pa dashur u bëra pjesë e këtyre bisedave. Ato mësynë atë gjysmën time të orës që doja të kaloja në qetësi, si të ishin probleme të miat. Padashur u ngarkova me përgjegjësinë për t’i menduar, shqyrtuar dhe për t’i zgjidhur si të ishin probleme të miat. Truri im tani po punonte veç për to.

Jo, jo, e pamundur të rrije. Biseda mes motrave ishte ndezur edhe më. Ajo e Greqisë i tregonte motrës tjetës për një dasmë ku kishte qenë e ftuar fundjavën e kaluar. Pas përshkrimit të detajuar të pjatave (gjithmonë gjysmë shqip, gjysmë greqisht), kaloi te veshjet dhe këngët. Madje një refren shumë të njohur filloi t’ia këndonte nën zë. Motra tjetër dëgjonte e përmalluar dhe fshinte syzet që nuk di pse, herë pas here i megjulloheshin.

Kur u ngrita të ikja, te hyrja e lokalit

një gazetares po bënte live me një mikrofon portativ. Pasi përshëndeti qytetarët, ajo u kthye nga unë dhe më kërkoi t’i jepja një mendim për temën e emisionit të sotëm.

“Jo faleminderit,” i thashë me ton të lodhur. Ajo qeshi dhe tha: “Shyqyr, një që s’flet me kamera!”

Të them të drejtën e kapa veten duke buzëqeshur me fjalët e saj. E vërtetë, që nuk më pëlqenin shumë kamerat dhe këto video-calls, aq më tepër në publik. I përdor ato duke ruajtur privatësinë time dhe qetësinë e të tjerëve. Dola jashtë dhe një erë e freskët erdhi nga deti. Një mesoburrë po ushqente me grurë një tufë pëllumbash. Edhe ai ishte live.

“E shikon sa janë shtuar? Po t’i ushqesh përditë vijnë vetë e të afrohen e nuk kanë frikë” - i fliste shokut që ishte në kamera dhe zgjatej për të parë pëllumbat që hanin misër. Mora për nga bregu, duke reflektuar mbi kafen që nuk arrita ta pija dhe mbi absurditetin e situatave. I bindur si asnjëherë tjetër, për faktin se qetësia ishte bërë luks, i rashë me majën e këpucës një grumbulli guackash që kishin mbetur nga batica e mbrëmjes së djeshme.

Qyteti ynë është shumë i bukur. Një qytet ku deti të fal qetësi, por kafeneja është gjithmonë në “live”. Një vend ku çdo birrë, çdo fjalë, çdo kafshë dhe çdo ndjekës digjital mund të hyjë papritmas në jetën tënde. Dhe unë, i vetmi pa live, ndjeva një humor të çuditshëm dhe pak trishtim karikatural në këtë realitet të jetuar për kamera.

Jo pak herë mendoj se askush nuk e shikon më detin, vetëm ekranin që e pasqyron atë. Njerëzit flasin për përjetime që ndodhin vetëm pasi janë regjistruar. As heshtjet nuk egzistojnë më, pasi mbushen me zhurmën e një transmetimi.

Eci buzë detit. Nuk kam ndezur asnjë kamera, asnjë regjistrim, asnjë foto. Ndjeva për një çast se isha i fundit që e shijonte botën, e ndiente atë, pa e dokumentuar. Deti dërgonte herë pas here nga një valë lajmëtare në breg.

E shoh i mahnitur dhe më duket i pafund, i paanë. Ai nuk e di që dikush po e sodit pa i drejtuar kamerën. Vetëm po mbush mushkëritë me ajrin e tij, po ngop sytë me kaltërsinë e tij, ashtu në një heshtje të padokumentuar, ku fillon liria e vetme që na ka mbetur.



DELVINA KËRLUKU

Korç’ e Shkup - dashuri

Poezi

N’KORÇË

U pamë. Kaq.
Ky ishte Çasti.
Pastaj s’ prajtëm së renduri
si të magjepsur pas njëri-tjetrit,
duke kërkuar
dorën, të fshijë lotët e syve tanë.
Kur u gjetëm sërish,
bëmë dashuri. Eh!
Qeshëm sa shembëm paralele dhe
meridianë,
deri sa zemra s’dinte më
nëse rrihte apo çahej nga gëzimi
Aq shumë u deshëm
sa koha u tremb prej nesh.
As orë, as shekull nuk mjaftonte,
asnjë çast s’e pranonte ndarjen.
Rendëm, u kthym, u puqëm,
sikur puthja
vetëm e vetëm për të mbijetuar.
Në heshtje i ndoqëm gjurmët tona,
aty ku mungesa na priste hapekrah.
Nëpër ato gjurmë
Mblodhëm copëza shprese,
për të ngushëlluar veten në largësi.
Dhe kujtimet —
oh, kujtimet —
si ajër na mbajnë frymën,
edhe kur s’e kemi.
Njëherë deshëm qytetin e dashurisë - Korçën.
Rrugët e saj na panë të digjeshim ngadalë,
mbrëmjet e saj na dëgjuan të betoheshim.
Prandaj u kthym,
jo për qytetin —
por për atë që lamë aty.
Ne deshëm njëri-tjetrin
deri në çmenduri,
deri në afshin që s’ka emër,
deri sa dashuria u bë plagë
dhe plaga — strehë.
Aq e madhe është kjo dashuri
sa qielli i pafund çahet mbi ne.
Dhe ne mbetemi poshtë tij,
të gjallë nga dhimbja,
të djegur nga dashuria.

17 dhjetor”25

N’SHKUP

Unë dhe ti u deshëm
kur qyteti ishte ende i lodhur nga historia,
kur muret dinin të rrëfejnë më shumë
se njerëzit,
kur (krye) qyteti merrte frymë me plagë
dhe ne i dhamë frymën e dashurisë tonë.
Dashuria jonë nuk erdhi si festë,
erdhi si sfidë.
Si zë që thotë “qëndro”
kur gjithçka tjetër thërret “ik”.
Unë të desha me frikë,
ti më deshe me guxim,
dhe mes nesh u ndërtua një botë
që askush tjetër nuk e pa.
Në një strofull të shkatërruar nga luftërat,

ku diktatorët kishin gdhendur heshtjen,
ne vendosëm zemrat.
Aty ku kishte rrënoja,
ti më solle dritë.
Aty ku hiri i kohës mbulonte gjithçka,
unë mbolla shpresë.
E bëmë shtëpi,
edhe pse e dinim se ishte e përkohshme.
Shkupi na pa të qeshnim, sa një jetë,
si të mos ekzistonte e nesërmja.
Na pa të qanim pa zë
kur nata bëhej orë e gjatë.
Na pa të betoheshim me dënesë, pa fjalë,
se nëse gjithçka shembet,
ne do të mbetemi – dashuria jonë.
Por koha nuk mban premtime.
Ajo na e shqeu dashurinë ngadalë,
si letër të lagur.
Erdhi dita e ikjes
dhe unë nuk dija si të marr frymë
pa ty,
pa rrugët tona,
pa qytetin që na mbante bashkë.
Ti u bëre mungesë.
Unë u bëra kujtim.
Dhe Shkupi — plagë e hapur.
Ti u ktheve drejt rrënjëve të tua,
por shpirti im mbeti aty ku ishte ti.
Çdo hap larg teje
është (ishte) një tradhti e vogël ndaj asaj
që ndërtuam.
Të kërkoj në çdo fytyrë,
në çdo zë që s’të ngjan
në çdo heshtje që më thërret emrin tënd.
Dashuria për ty
u shtri si dhimbje në çdo rrugë të qytetit.
Dashuria për qytetin
u kthye në mall për ty.
Nuk di më kë po humbas më shumë.
Edhe sot,
kur mbyll sytë,
ti je aty,
mes urave dhe dritave të zbehta,
duke më pritur në një Shkup
që merr frymë vetëm kur ne kujtohemi.
Një qytet që nuk u shkatërrua nga luftërat,
por nga ndarja jonë.
Kujtimet nuk më lënë të arratisem
nga Shkupi
Ato rrojnë në mua,
si plagë që nuk kërkon shërim,
sepse dhimbja
është e vetmja dëshmi
që ne vërtet u deshëm.

Dhjetor,”25

Para ca kohësh, duke lexuar librin e Aristotelit *Poetika*, pjesën ku flitet për vlerat estetike të artit poetik, për një lloj diturie dhe bukuri shpirtërore që shpërndan ai, m'u kujtua xha Abazi. Ai ishte një plak që po u afrohej të njëqindave kur e takova, por që nuk tregonte në pamje se ishte aq i moshuar. Ishte me trup mesatar, nuk ishte i kërrusur. Flokët dhe mjekra i ishin zbardhur krejt, por duke e vështruar edhe te vetullat e zbardhura dhe te mustaqet e bardha e të prera shkurt mbi buzë, ai të krijonte idenë e një njeriu që ka ndenjur për minuta të tërë jashtë në dëborë.

Lëvizjet i bënte të ngadalta, pa folur. Aq i heshtur ishte, sa mendoje se kjo botë e ka heshtjen veti të qenësishme të saj. Ai jetonte vetëm, por edhe i vetmuar. Ishte xhaxhai i të zotit të shtëpisë ngjitur, muri i pasmë i së cilës kufizohej me oborrin e tij. Disa thoshin se ishte më i largët. Sido që të ishte edhe i madhi i shtëpisë ngjitur, plak ishte, se ecte me bastun. Kur shiheshin, vetëm përshëndeteshin me pasthirrma. Nipi dhe xha Abazi, takoheshin rrallë, sepse dera e shtëpisë së madhe dhe dyert e tri shtëpive të vogla të ndërtuara më pas duke krijuar kështu një gjysmë rrethi e që ishin nga ana e sipërme, të çonin nëpër rrugët e lagjeve dhe në qendër të fshatit, kurse dera e shtëpisë së xha Abazit, mund të thoshe se, nuk të çonte gjëkund. Rrugorja, ndalej në oborrin prej disa metrash katrore që kufizohej me murin e pasmë të shtëpisë së nipit, me anën që nuk kishte dritare.

Shtëpia dukej e re dhe në të vërtetë e re ishte, sepse kur kishte ndërtuar shtëpinë e madhe me shumë dhoma, nipi i kishte ndërtuar edhe atij një shtëpi të vogël. Oborri ishte me gjithfarë lulesh që mbushnin me aromën e tyre të mjedisin. Megjithëse shtëpia e re ndryshonte nga e vjetra, se ishte me mur dhe me dritare të mëdha, e kthyer nga jugperëndimi, ai mezi qe ndarë nga shtëpia e vjetër që ishte me thupra dhe kishte filluar të rrëzohej.

Xha Abazi kishte qenë i martuar, por gruaja i kishte vdekur gjatë lindjes së një vajze që kishte ardhur në jetë disa vjet pas martesë. Ai e kishte rritur vetë duke e çuar një herë në ditë të pinte te një fqinjë që pati lindur edhe ajo në atë kohë një djalë. Vaktet e tjera i përgatiste pelte me niseshte e me qumësht lope. Kur u bë pesë muajshe, njëherë në dy ditë i shtonte peltes edhe një vezë, derisa e vogla kaloi vitin dhe dora-dorës nisi të hante çfarë hante ai vetë. Nuk qe martuar së dyti. Kujtimi i gruas së parë me sa dukej kishte qenë i fuqishëm. Vajza u rrit e u bë e mbarë, por edhe e bukur. Shumë kohë ai nuk merrej me punë shtëpie, kujdesej veç për kopshtin dhe bagëtitë, se ishte ajo që e mbante shtëpinë. Vajzën e ftonte çdo verë një javë ose edhe dy vëllai i nënës së saj, por më tepër nuk e linte xha Abazi, se i dukej shtëpia bosh. Kur mbërriti moshën e dashurisë, një djalosh filloi t'ia hidhte sytë me ëmbëlsi te burimi i lagjes ku mbushte ujë për dajon dhe dajeshën. Edhe ajo ia kthente shikimin me një të qeshur që ngjasonte me lëkundjen e luleve të fushës nga flladi. Papritur, ata filluan të deheshin nën vështtrimet e dashurisë, sa herë që e hasnin njëri-tjetrin. Më vonë nisën të takohen në muzg, kur tringëllinin zilkat e bagëtive që ktheheshin nga kullota. Familja e djalit, kuptohet, me dëshirën e tij, erdhi dhe e kërkoi te i ati për nuse, pa e ditur mirë se të rinjtë i kishin dhënë zemrën njëri-tjetrit. Dhe një ditë vajza u martua. Xha Abazi ia ndjeu shumë mungesën, por u mësua, gëzohej që ajo ishte e lumtur. Vajza erdhi disa herë me të shoqin me qëllim që t'ia mbushte mendjen të shkonte për të jetuar me ta, por ai nuk desh. Ajo lindi tri vajza dhe sado larg që ishte, vinte shpesh me vogëlushet. Ai kënaqej dhe ripërtërihej kur i shihte, ishte bërë gjysh. Vajzat u rritën e u erdhi koha e martesës. Në dasmat e dy mbesave ai vajti. Për të tretën nuk mundi, se ishte i sëmurë nga njëri gju. Ishte diçka reumatizmale, që i kaloi duke e mbështjellë tërë vjeshtën dhe dimrin e atij viti me lesh deleje të palarë, sipas traditës popullore. E mësoi nipi, se e kishte provuar vetë.

Xha Abazin e ndoqi e keqja. Pasi bëri dasmën e tretë, vajza e tij vdiq. Me siguri ka qenë kancer i gjirit, se thanë që i dhembte në gjoks. Ai ra shumë shpirtërisht nga vdekja e saj. Ca kohë nuk hëngri, as piu dhe u shtri në rroba për të pritur vdekjen. Alarmin e dhanë nuset që pastronin dhe e shihnin shtrirë, bërë baltë në



fytyrë. Njëri nga djemtë e të madhit të shtëpisë, kur e dëgjoi, e detyroi me zor që të ngrihej duke e ushqyer disa ditë si bebe dhe xha Abazi e mori veten përsëri.

Ka edhe një gjë të rëndësishme për t'u shënuar. Njëra nga mbesat kur qe martuar, pati ardhur me të shoqin te xha Abazi dhe i ishte lutur të pranonte të rronte me ta, por ai nuk qe bindur. Dy të tjerat nuk e kishin provuar, se e dinin që do të merrnin si përgjigje një „jo“. Edhe nipi i kishte thënë kushedi sa herë që të bashkohej me ta. Një djalë i nipit, i vogli, po ashtu i kishte afruar një dhomë te shtëpia e vet. Gjithnjë ishte po ai qëndrim “kokëfortë” i xha Abazit. Në këtë mënyrë ishte zhvilluar historia e tij, disi e çuditshme, të cilën e pata mësuar para se t'i shkoja për vizitë.

Vetminë ai nisi ta ndjente shumë kur vajzat e vajzës i rralluan vizitat, se u ishin rritur fëmijët e tyre dhe bënin përpjekje për t'i martuar dhe rregulluar. Veç kësaj, si të gjithë njerëzit e kësaj bote edhe ato kishin probleme shëndeti, herë me pleqtë e shtëpisë, herë me burrat e tyre dhe herë me veten dhe pastaj nuk erdhën më.

Sipas asaj që tregohej, shpesh plaku rrinte ulur te pragu i derës dhe sodiste i përhumbur në horizont. Thoshin se edhe kur binte shi, shpesh ai rrinte te dera i mbështjellë me një batanije ushtarake dhe ndiqte pikat e shiut. Pranverave, nganjëherë ai shihte burbuqet e çelura me sy të ngulur si të mos i kishte parë kurrë. E kishin dëgjuar edhe të bisedonte me lulet.

Nuset e djemve të nipit që pastronin me radhë shtëpinë e tij dhe fshinin avllinë, siç i thoshin oborrit, rrëfenin se shumicën e herëve e gjenin vendin dritë, të pastër. Dy prej tyre, ato më të rejat ndodhën të dhembshura dhe i çonin fëmijët e vegjël në oborrin e tij për ta argëtuar herë njëra dhe herë tjetra. Ai luante me ta sikur të ishte vetë fëmijë.

*

Në kohën që ishte krijuar kooperativa patën shkruar në gazetë për xha Abazin, por duke e kritikuar që nuk kishte pranuar të hynte në kooperativë. Kur kooperativa e fshatit të tij pati një lulëzim të përkohshëm, atë përsëri e lutën, por ai nuk u shkrua. Pati nxjerrë shkakun se e ndiente veten të moshuar, në krahasim me rininë që mbushte radhët e atyre që punonin në arat e përbashkëta. Mes atyre që tregonte vëllai i tim eti që nuk banonte larg tij dhe shkrimit që ishte botuar, kishte një mospërputhje të hatashme. *Gazeta e kishte cilësuar armik të popullit*, njeri që nuk e donte regjimin.

Pas kësaj, kur dilte në rrugë askush nuk i fliste, nuk e përshëndesnin, nuk e ftonin nëpër dasma e festa sipas zakonit të lagjes. Për të tjerët ai ishte diçka midis qenies dhe mosqenies. Prandaj qe mbyllur në rrethin e shtëpisë dhe të atij oborri. Kohët e fundit, kishin filluar t'i sillnin edhe për të ngrënë, se qe ngathtësuar. Dreka e tij u kthye në një ritual të përditshëm, një lloj gare dashamirëse. Secilës familje i takonte njëherë në javë, se nipi kishte disa djem të martuar; nuset që kishin radhën, ia mbushnin tavën me ato që përgatisnin për shtëpinë e vet. Por ai hante fare pak. E hidhte atë që do të hante në një tas të tijin dhe pjesën tjetër e kthente mbrapsht. Nuk hante as mëngjes dhe as darkë. Në mëngjes pinte një filxhan me qumësht dhe pastaj një filxhan me

FERIDE PAPLEKA

Xha Abazi dhe Averroes

Tregim

kafe të hollë. Gjashtë ditët e javës mbusheshin nga djemtë e nipit dhe nga një stërnip i tij, kurse dita e shtatë ishte e nipit. Ajo ishte dreka e së dielës dhe gjithnjë do të kishte në jahnë edhe një copë mishi, ose bagëtie, ose gjeli që e zienin mirë, se plaku ankohej nga stomaku.

*

Xha Abazi kujdesej shumë për lulet e oborrit. Mua më kishte tërhequr shumë episodi i luleve. Diku kisha lexuar se ata që duan lulet dhe kafshët, janë njerëz të mirë. Pata krijuar një imazh disi përrallor për të, e nisur edhe nga rrëfimet e xhaxhait tim, i cili kur ndodhej në qytet për punë dhe në të kthyer ndalej te ne, nuk harronte të përmendte ndonjë gjë të veçantë të tij.

*

Njëherë vajta te xhaxhai me vëllanë tim më të vogël. Qyteti ynë ishte pranë fshatit, ndaj shkuam në këmbë duke kënduar. Nuk e di çfarë na kishte nxitur të këndonim. Mbase që do të ishim të lirë të hanim fruta pa hesap. Xhaxhai na ftonte gjithmonë disa ditë në verë në kohën që piqeshin rrushi dhe fiqtë. Në darkë unë iu luta të më shpinte të nesërmen deri te oborri i xha Abazit, sepse e kisha bërë me mend për ta takuar. Xhaxhai më shoqëroi deri atje, e përshëndeti sipas zakonit të fshatit, shkëmbu dy-tri fjalë me të dhe iku.

Kur më pa fillimisht në oborrin e tij, xha Abazi ndenji disi i druajtur, sepse unë i dukesha diçka përtej realitetit, një simbol ndoshta i rinisë revolucionare të kohës. Prej vitesh ai nuk fliste me të tjerë, përveçse me ata të shtëpisë, që ishin të gjithë një zjarr, domethënë të gjithë pasardhësit vinin nga një trung familjar. Kishin dashur ta intervistonin disa herë, por ai nuk e kishte hapur gojën. Unë pata një bindje të verbër se me mua do të fliste.

Iu afrova dhe e përshëndeta, mbase me një lloj krenarie të moshës dhe ai më pa me vërejtje për të kuptuar në ishte përshëndetje miqësore. Megjithatë nuk iu përgjigji përshëndetjes sime. Ishte dyshues dhe heshti i menduar sikur të ishte memec. Vetëm më tregoi ku të ulesha. Aty pranë, nën hijen e një pjergulle, ishte një ndenjëse druri, trung peme i latuar. Sado që oborri i tij mund të quhej lulishte, prapë dukej si i shkretë pa lëvizje. Para shtëpisë së madhe luanin fëmijët dhe i jepnin jetë vendit me zërat e me lodrat e tyre.

Xha Abazi kishte ende flokë, po të merrej parasysh moshë e madhe që sidoqoftë asnjëri nuk e dinte me saktësi. Fytyra e vogël i ngjante një pasqyre të rrumbullakët xhepi, në të cilën xixëllonin me një dritë të mjegullt dy sy të zinj. Ata pak flokë ai i kishte lënë të zgjatëshin dhe i kishin dhënë hijen e një filozofi apo alkimisti. Sigurisht, xha Abazi rrinte në shtëpi prej moshës, por po të dilte, lufta kundër flokëve të gjatë do ta bënte objekt kritikash dhe së fundi do ta çonin në floktore për ta qethur.

Nuk e mbaj mend si më pati lindur dëshira që t'i bëja vizitë. Atëherë isha në universitet dhe merresha edhe me gazetari. Doja t'i bëja një portret e ta botoja. Nga rrëfimet e xhaxhait ai ishte shndërruar në një personazh, për të cilin kisha thurur me mend disa fragmente proze. Në nënvetëdije ndoshta ishte ideja për të ditur sekretin e veçimit të tij nga bota. Në atë kohë nuk e kuptoja se çfarë ishte ligji i luftës

së klasave. Ligjin e luftës së të kundërtave dhe unitetit të teorisë me praktikën, e kisha bërë në lëndën e marksizmit në vitin e fundit të gjimnazit dhe më kishte pëlqyer. Lufta e klasave ishte e egër, sipas babait tim, por në moshë të re njeriu nuk mendon thellë. Edhe të tjerë, të rinj si unë nuk e kuptonim kohën dhe përgjithësisht jetonim në ëndërrime. Thjesht kujtonim se ata njerëz që cilësoheshin armiq, nuk na i donin të mirën. Gjithsesi, me ato që më kishin treguar për xha Abazin, mendoja se ai nuk mund të ishte armik.

Ai më pa sërish në sy, pa më folur. Kur i tregova emrin e gjyshit tim, që kishte jetuar në atë lagje, por kishte vdekur i ri, ai sikur u çel në fytyrë. Shkoi brenda dhe më solli një shiltë të butë. Derën e la hapur dhe unë e kisha përballë sepeten me relief bimor të skulpturuar, që kur shkoi sërish brenda, ia ngriti kapakun dhe nxori prej andej një ftua të madh, me një të verdhë që anonte nga e kuqja. Erdhi dhe e vuri përpara meje, mbi tryezë.

Mbaj mend se i thashë faleminderit dhe i tregova, mbase me mburrje, se isha universitare dhe do ta prisja në shtëpi me thikë, do ta ndaja në copa të vogla në një pjatë dhe do ta haja me pirun. Koha e re kishte sjellë një mënyrë të re edhe për të ngrënë dhe ne i bënim reklamë së resë. Ai shkoi prapë brenda dhe tërhoqi një arkëz, punuar përsëri me dru që ishte pranë sepetes dhe që dukej si diçka e thurur. Hamendësova se ishte një ritual fetar, aq me kujdes e vuri ai mbi sepete kapakun e heqshëm. Isha e çuditur edhe nga një lloj drite e errët që mbizotëronte në atë shtëpi. Nxori nga arkëza me përqendrim të madh, si të kishte të bënte me enë kristali që mund të thyheshin, disa libra të përmasave të ndryshme. Duke vështruar librat në duart e tij, unë përfytyrova një lumë të gjerë si det që rridhte valë-valë mes kaltërisë dhe përziente si në një lojë tokë e qiell si dhe planetin e brishtë që vinte rrotull para syve të mi. Pata vegulli ato çaste. Ishte fare e papritur: *Një plak i moçëm me libra*. Dhe, vetvetishëm më lindi titulli i shkrimit. Ai erdhi e i vendosi librat mbi një pëllhurë pambuku. Pohimi im që isha studente, mesa duket e kishte shtyrë të më tregonte librat. Ndërkohë ai kishte kryer disa veprime që unë e rrëmbyer nga fantazia, nuk i pashë. Kishte vendosur pranë meje një tryezë të vogël, e kishte mbuluar me velenxë, - velenxë i thoshin atëherë, nisur nga modeli i parë që kishte ardhur mbase nga Valencia e Spanjës, - mbi të kishte shtruar një pëllhurë të bardhë, mbi të cilën kishte vendosur librat. Vetë u ul në një stol, po prej druri, që mbulohej me një lëkurë qengji borë të bardhë. Gjithçka aty ishte e pastër dhe unë edhe sot e kësaj dite nuk arrij ta kuptoj mjeshtërinë e tij për të mbajtur aq pastërti e rregull. Kjo dukej në të gjithë mjedisin që e rrethonte, në rrobat që kishte veshur, në sendet e pakta që zotëronte. Edhe qelqet e dritares ndrisnin, edhe oborri. Lehet e luleve ishin prashitur në mënyrë të atillë që zajet e bardha rrethuese të mos kishin asnjë thërmirje dheu përsipër.

Midis librave ishte edhe një kodeks. Unë mendova kodin e Hamurabit, por më vonë e mësova se *kodeks* kishte kuptim tjetër dhe se Kodi i Hamurabit, i zbuluar në fillim të shekullit XX, saktësisht më 1901, është një pllakë guri vertikale, në të cilin mbreti Hamurab kishte „botuar“ ligjin babilonas në gjuhën akadiane, me shkrim kuneiformë (pykor, thotë Kodona, sepse pllaka e gurit mund të gdhendej me pykë guri më të fortë, me majë të mprehtë). Për natyrën e vërtetë të atij teksti, ka ende debate.

Librat ishin arabisht. Nuk e pyeta xha Abazin sesi kishin përfunduar tek ai. Ngaqë nuk dëgjonte mirë, ai rrinte përherë i heshtur. Në krye të një libri që ishte mbi tryezën e improvizuar, unë dallova një emër të gjatë, nga i cili mbaj mend : *ibn Ruchd* apo *ibn Rochd*. Në mbulesën e tij kishte edhe një gravurë që kishte qenë me ngjyra, por që ishte zbërdhulur nga koha. Tashti e di që *Ibn Ruchd* është gjymtyra e nëntë e emrit Averroes, shkurtim që e dha njëri nga nxënësit e tij, por atëherë nuk e kisha këtë informacion. Në vitin e dytë të Universitetit “je gjithkund dhe askund”, thotë Seneka. E mora librin në dorë me kujdes duke vështruar xha Abazin, se mos dalloja ndonjë qortim, por qetësia e tij që pasoi veprimin tim, më dha zemër. Në faqen e parë dallohej edhe emri Aristoteles Αριστοτέλης ο Στάγειριτης. Emri i autorit ishte kopjuar, i shoqëruar me përkatësinë e vendit; më poshtë kishte një

fjalë arabisht. Unë bëra një lexim intuitiv, siç na ndodh në disa raste, sepse kohët e fundit më kishte rënë në dorë diçka për Aristotelin. Ndërsa për Platonin dija më shumë, kisha lexuar librin e tij të famshëm *Apologjia e Sokratit*. I hapa fletët dhe u mahnita pas zbukurimeve që rrethonin shkrimin në çdo faqe, por nuk kuptoja.

Kur e pa që unë mbeta e hutuar, xha Abazi ma mori librin gjithnjë ngadalë, gjithnjë i heshtur dhe nisi të lexonte një fragment me zë të ulët, por skenik. Pastaj e përktheu drejtpërdrejt në shqip për të më befasuar, aq sa mos t’i besoja çastit. Ishte një shqipe e kulluar, sikur të kishte dhënë kursin e përkthimit në universitet. Padashur unë e pyeta:

-Keni qenë në Tiranë?

Ai tundi kryet dhe nuk e mora vesh në kishte qenë apo jo, por xhaxhai do të më thoshte në mbrëmje që ai kishte kryer medresenë e Stambollit. Po ta kisha ditur këtë gjë, mbase do t’i bëja ndonjë pyetje që lidhej me librat dhe arabishten e tij. Xhaxhai do të më tregonte, gjithashtu, se kur pati qenë kthyer nga Turqia, ai nuk kishte gjetur gjallë asnjë prej familjes. Të gjithë kishin vdekur, përveç një vëllai që nuk kishte qenë aty. I vëllai, pasi i kishte varrosur të vdekurit, kishte ikur nga fshati dhe nuk ishte kthyer më. Nuk dihej gjë për të. Xhaxhai nuk m’i kishte thënë gjithë këto mynxyra qëllimisht. Atëherë ishte bërë gjëmë e madhe. Me siguri kishte qenë helmim, se ata kishin lënguar tri ditë mes të vjellave, por besimtarët e kishin shpjeguar me ndonjë dënim të Zotit. Disa kohë Abazi ishte ngurosur dhe kishte thënë se nuk zgjohej dot nga ajo ëndërr e zezë. Kur ia kishin hedhur fjalën te martesja, kishte thënë se nuk donte të martohej. Dikur i kishin gjetur një nuse nga një fshat i largët dhe e kishin martuar si me zor; vajzë e mbetur jetime me një vëlla, e cila kishte ndodhur e virtytshme dhe shumë punëtore. Ai e kishte dashur fort. Pas vdekjes së saj, një martesë e dytë, qe një ide përjashtuese. Gjithçka që përbënte jetën e tij kishte qenë ajo vajzë.

Xha Abazi vazhdoi të përkthente. Sytë e tij që ruanian një lloj ngjyre trishtimi nga errësira e jetës së vetmuar dhe tragjike, përfatuan pakëz dritë që shkrepinte herë pas here si inxhi: *„E vërteta është edhe e vështirë edhe e thjeshtë. Jo çdo njeri mund ta mbërrijë atë. E thjeshtë është se çdo njeri flet për natyrën e së vërtetës praktike. E vështirë është se nga pikëpamja teorike ajo nuk mund të rroket as në tërësi dhe as pjesërisht. Dhe kjo ndodh për shkakun tonë, nga intelijenca jonë...*

Unë dëgjoja e mahnitur. Ai nuk vuri as syze dhe kjo gjë më çuditi përsëri.

-Pa syze, xha Abaz!- thashë me ton pyetës. -Babai im ka filluar t’i përdorë. Sapo i ka kaluar të pesëdhjetat.

Por ai vazhdoi:

“A - Ka disa rrugë që shpien te e vërteta. Së pari, shfaqja e saj njëherësh në shumë gjëra dhe së dyti, dëshira jonë për të zbuluar të vërtetën. Veçanërisht, ka nga ata që duan të mësojnë për natyrën e krijimit ...

B - Por njohja e së vërtetës arrihet me pjesëmarrjen e shumë të tjerëve. Ne e dimë se

duhet një kohë e gjatë për të zbuluar të vërtetën...”.

Ai ndali, e la librin mbi tryezë. Mbushi llullën me duhan dhe më vështroi duke e anuar pak bishtin e saj të gjatë. Mori prapë qetë-qetë librin që kishte lënë me fletë të hapur dhe u bë gati të lexonte. Unë i bëra shenjë me dorë dhe e pyeta:

-Ku e keni mësuar shqipen standarde?

Ai ngurroi një çast, se mbase i tingëlloi e rëndë fjala “standarde”, të cilën e shqiptova disi me mburrje, pastaj tha:

-Me radio. Kam një radio. Dëgjoj Radio-Tiranën. E dëgjoj deri vonë në mesnatë dhe nganjëherë edhe përtej mesnatës.

Unë nuk e prisja që ai të fliste aq natyrshëm, aq bukur dhe me aq sinqeritet. Sa keq, ne kemi ndonjëherë paragjykime për tjetrin, pa pasur argumente.

Ai ndërkohë pati rinisur të lexonte e të përkthente. Pranë tij erdhi një mace e zezë me pika të bardha, priti sa ai ta përkëdhelte në kurriz dhe u largua. Me sa kuptova, xha Abazi kishte një dëshirë të zjarrtë të lexonte dhe ta dëgjonin. Sepse asnjeri nuk merrej me të. Të gjithë te shtëpia e nipit ishin të zënë me punë dhe nuk mund të hamendësonin për këtë hollësi sublime që zotëronte ai. Djemtë e nipit kishin bërë përgjithësisht nga katër, apo shtatë klasë, pra ishin larg filologjisë. Brezi më i ri kishte dëshira të shumta. Bie fjala, njëri donte të vazhdonte për mjek, se ishte në një të mesme mjekësore, një tjetër vazhdonte për inxhinieri, se kishte ndjekur një shkollë teknike, një vajzë mes gjithë atyre djemve përgatitej të vazhdonte pedagogjiken për mësuese... Ishte koha e masivizimit të arsimit.

Unë, duke u mbështetur te ato që më kishin thënë për xha Abazin, pandehja se ai nuk do ta merrte mundimin as të fliste, ose po të fliste, do të shprehej me një gjuhë të pakuptueshme, të vjetruar. Por ai foli, sikur të mos kishte ndryshim një jetë të tërë midis nesh. Foli si universitar dhe prej tij unë e mësova se të dëgjoje radion, ishte si të ndiqje një universitet.

U ktheva te xhaxhai dhe sigurisht në mendje më rrinte portreti i xha Abazit. Mendimet e mia ndërpriteshin herë pas here nga dialogu me fjalë të dhembshura e të ëmbla të xhaxhait dhe gruas së tij të re. Mamaja më kishte thënë se ata ishin martuar me dashuri të madhe. Xhaxhai e kishte rrëmbyer. E vura re, ç’është e drejta, se ai i drejtohej me shumë respekt duke i thyer rregullat e patriarkalizmit që mbretëronte në fshat. Në qytet kishin filluar të zinin vend më shumë reformat socialiste për mbrojtjen e gruas. Unë dhe vëllai i madh i patëm thënë ato kohë babait: “Po i fole mamasë, ke punë me ne”. E mbaj mend sesi qeshi babai me gjithë shpirt nga zëri ynë i trimëruar. Organizata e rinisë na kishte udhëzuar që ta shtrinin punën tonë deri në familje.

Kur i tregova xhaxhait për gjithçka pashë, sidomos për librat dhe leximin pa syze, ai më tha se plaku e kishte hequr perden e syve. Xhaxhai im ishte infermier në klinikën e fshatit dhe e kishte shoqëruar dy herë për në spitalin e qendrës me një nga të rinjtë e familjes së madhe.

*

Të nesërmen u gdhi e diel dhe xhaxhai na ftoi mua dhe vëllanë të vilnim rrushin e një pjergulle se do ta hidhte në një vozë për raki. Unë dhe vëllai hëngrëm rrush e fiq të freskët, të këputur nga dega, sa deshëm. Të pasnesërmen ikëm. Xhaxhai na dha edhe një shportë me rrush dhe fiq që ta çonim në shtëpi, në qytet. Xhaxhait i thashë se xha Abazi ishte njeri i jashtëzakonshëm. “Po, - tha ai, - është njeri, nga i cili mund të mësosh shumë”. I thashë edhe babait për vizitën te xha Abazi, por duke qenë se ai ishte komunist dhe betohej “Për idealin e Partisë!”, nuk u zgjata shumë. M’u duk sikur pashë një shprehje çudie në sytë e tij. Ai më vështroi i menduar, pa thënë asnjë fjalë.

Gjatë vitit të tretë të universitetit, mblodha të dhëna për zbulimin e veprave të Aristotelit e të Platonit në Mesjetë nga Averroes dhe ia dërgova xha Abazit me një letër. Studimet në Universitet nuk më linin shumë kohë të lirë për të shkuar vetë. Gjeta rrugën më të shkurtër, babai do t’ia jepte vëllait të vet, dhe ai do t’ia shpinte xha Abazit. Shfrytëzova rastin kur im atë erdhi në Tiranë për disa çështje pune e më takoi edhe mua. E kuptova se babait i kishte pëlqyer interesimi im për një njeri të ditur, ndryshe nga mendimi i mëparshëm që më kishte zgjuar çudia në sytë e tij dhe të cilën unë e përktheva si një mospajtim. “Mos u bëj merak, - tha - letrën do t’ia çoj vetë xha Abazit. Ai ka pasur miqësi me gjyshin tënd”, - dhe më përqafoi.

Një kopje të letrës e kam, sepse i shkruaj dy herë për të bërë me të dytën bukurshkrim, sipas metodës që pata lexuar në intervistën e një shkrimtari. Po e rishkruaj duke ndrequr ndonjë gabim drejtshkrimor:

„Shumë i dashur xha Abaz,
Unë dëshiroj në radhë të parë të jeni mirë vetë dhe t’i keni mirë radion, librat, lulet dhe macen pikaloshe. Nëpër disa dokumente kam gjetur të dhëna që edhe mund t’i dini, por po i shkruaj në këtë letër:

Librat e Aristotelit u përkthyen nga Averroes, i cili i shoqëroi përkthimet e tij me komente, prandaj edhe u quajt: komentatori i Aristotelit. Veçanërisht, bashkëkohësit e tij lëvduan shumë traktatin Për lumturinë e shpirtit, që ai e përktheu dhe e pajisi me një komentat të shkëlqyer. Kështu veproi Averroes me të gjithë librat e Aristotelit që gjeti nëpër tregtarët e Kordovës. Ai vetë, krahas librave filozofikë, shkroi edhe një traktat për mjekësinë, që u botua në Venecie më 1549, gati katër shekuj pas vdekjes. Vepra e tij fitoi një rëndësi të veçantë në Europën perëndimore, sepse ndikoi te vepra e filozofëve mesjetarë, të cilët u quajtën averroistë. Edhe gjatë Rilindjes vepra e tij u studiua në universitete.

I frymëzuar nga libri Republika e Platonit, ai shtjelloi në veprën e tij idenë se gratë duhet të punojnë, madje ato janë të denja edhe të udhëheqin ...

Në vitet e fundit të jetës ai përballoi edhe goditjet ndaj filozofisë së tij, por edhe ndaj filozofisë në përgjithësi. Puna arriti gjer atje, sa u ndalua filozofia, studimet dhe librat rreth saj.



Aristoteli në rini, Charles Degeorge

Qysh prej vitit 1195, Averroes ishte viktimë e një fushate kundër tij. Atë e poshtëruan në xhaminë e Kordovës. Pas kësaj, u detyrua ta linte qytetin e lindjes dhe të shkonte në një qytet të vogël. Librat e tij u dogjën dhe Averroes u cilësua “tradhtar i fesë”. E shikon xha Abaz? Të gjitha kohërat nuk janë edhe aq të këndshme për t’u jetuar.

Unë mbase do të vij sërish në verë dhe do të sjell disa libra të rinj dhe do t’ju tregoj edhe më për veprimtarinë e Averroes e të disa filozofëve të tjerë arabë.

Mirupafshim dhe gjithë të mirat!

Në mbyllje të letrës ishin firma dhe data. Në fjalitë e fundit ndihej një lloj ngushëllimi për atë që koha e kishte detyruar të mbyllej brenda. Shkrimi që bëra për xha Abazin, u botua i gjymtuar, ngaqë i kishin hequr disa fragmente, sidomos ato ku përmendej medreseja.

*

Kanë kaluar vite qysh nga ai takim, të cilin e quaj një nga takimet më të çmuara të jetës sime. Xha Abazi më mësoi i pari për filozofin e shquar arab të shekullit XII, i njohur me emrin e latinizuar Averroes, që lindi dhe u rrit në një familje të shquar juristësh në Kordovë të Spanjës. Emri i tij i plotë është: Abu al-Walid Muhammad ibn Ahmad Muhammad ibn Rushd (në arabisht : أبو الوليد محمد بن أحمد محمد بن رشد). Ai ka qenë filozof, teolog, jurist dhe mjek mysliman i gjuhës arabe. Averroes kreu funksionet si gjyqtar dhe kryegjyqtar në Sevilie e në Kordovë si dhe mjek privat i oborrit në Marrakesh, në një epokë të ndezur, kur pushteti sapo kishte kaluar nga Almoravidët te Almohadët.

Fillimisht, Averroes lexoi një komentar që kishin bërë për librin *Metafizika*, dhe interpretimi i gabuar e nxiti që t’i futej punës duke përkthyer dhe komentuar veprat e Aristotelit përgjatë tetë vjetëve.

Mendimi i tij filozofik, doemos, u ushqye nga vepra e Aristotelit. Traktati filozofik *Hallakataja e hallakatjes (Incohérence de l’Incohérence)* në përkthimin francez; *Averroes’ Tahafut al-tahafut*, në ndryshorin anglez, u botuan në vitet ’50 të shekullit XX. Në arabisht është: تهافت التهافت, dhe u shkrua më 1179 si përgjigje ndaj librit të Al Ghazali-it *Tahafut al-Falasifa* (*Hallakataja e filozofëve*, 1095), në të cilin goditet filozofia në përgjithësi dhe Avicena në veçanti. Averroes-i me polemikën e tij përpiqet të dëshmojë se filozofia është e domosdoshme për studimin e Kuranit dhe të teologjisë. Një historian francez i filozofisë mesjetare e ka rindërtuar debatin mes Averroës-it dhe Al-Ghazâlî-t në librin *Introduction à la philosophie médiévale* (*Hyrje në filozofinë mesjetare*).

Xha Abazi nuk jeton më tashti që kam të dhëna më të gjera e më të plota lidhur me Averroen. Veprimtaria e tij kushtuar veprës së Aristotelit është mjaft e rëndësishme. Aristoteli është filozof materialist i Greqisë se lashtë. Ai ishte shtatëmbëdhjetë vjeç kur u pranua në Akademinë e Platonit. Platoni e mbiquajti fillimisht “Lexuesi”, pa dyshim me dashuri, ngaqë lexonte shumë, kurse më vonë “Truri” për mendimet e tij filozofike. Madje po të mungonte Aristoteli në kurset e tij, ai thoshte që kursi ishte “i shurdhër”.

Pastaj, Aristoteli hapi shkollën e vet me emrin *Liceu*. Dhe nisi të shkruante veprën e tij madhështore, që përmbledh të gjitha fushat e mendimit materialist të kohës. Aristoteli hodhi themelet e filozofisë së natyrës, por është edhe themeluesi i metafizikës, e quajtur filozofia e parë, sepse kërkon arsyet kryesore dhe parimet e ekzistencës së Universit. Mbreti Filip i Maqedonisë e zgjodhi mësues për të birin, princin Aleksandër. Aristoteli e pajisi nxënësin e vet me të gjitha dijet e kohës së deriatëhershme. Aleksandri i filloi mësimet qysh nëntë vjeç. Në moshën njëzetvjeçare u zgjodh perandor dhe u mbiquajt Aleksandri i Madh.

Një pjesë e veprës së Aristotelit, kryesisht traktatat logjike u quajtën “Organon” nga një filozof tjetër i shquar që erdhi pas tij. Filozofia e tij u bë e njohur në të gjithë Europën perëndimore, në sajë të komentareve të Averroes-it.



Averroës. Pjesë nga një afresk i Andrea di Bonaiuto-s, Firence, 1365-1368.

Libri i artit, për publikun, është po aq i Lrëndësishëm sa libri letar. Ai ka forcë edukuese të drejtëpërdrejtë po aq sa libri letrar. Ashtu si libri letrar që zgjeron njohuritë mbi të shprehurit, mbi njohjen dhe përdorimin shumë më të mirë të gjuhës shqipe, mbi zhvillimin e një perceptimi më të mirë të botës ku jetojmë, mbi nxitjen e e imagjinatës, fantazisë dhe inteligjencës, edhe libri i artit ka po të njejtën fuqi, të cilën e shpreh përmes marrëdhënies së ngushtë të imazhit me mendimin e tekstit filozofik, kritik, estetik, historik dhe vlerësues. Libri i artit është teksti estetik-filozofik i shkruar mbi veprën e artit, sepse arti është një pjesë e pandashme e historisë njerëzore.

Me një vështrim spikatës më lejoni të shprehem se konstatoj qw flitet e shkruhet shumë për letërsinë, ku për prozën edhe më shumë, e për poezinë më pak e mos mw pak!? Në kronika dhe emisione të shumta, thuajse në çdo stacion televiziv, flitet për letërsinë e, madje në radhë të parë për librat e autorëve të njohur, e më pas, për ata më pak të njohur. Madje, një mwndje e vwmwndshme i kupton mjaft mirë rastet kur gazetarja apo gazetari i kulturës asqw nuk e ka lexuar librin, për të cilin ligjëron mendime të zakonshme ose ndonjë përmbledhje të dhënë gati nga autori. Eh, ndoshta, jo se nuk do, por o nuk del i koha, pasi televizioni është një media që vrapon, o për shkak të lidhjes me tekstet dhe imazhet e medias sociale libri i shkruar në letër, nuk e tërheq aspak. Gjithësesi, nuk përjashtohet ndonjë gazetar apo gazetarë e përkushtuar, që nuk bënë dot ndryshe, vetëm se të lexojë e të lexojë.

E përqëndruar në hartimin e librave të artit, paramendoj mendueshëm se çfarë ndodh ndërmjet librit të artit me mediat televizive, ato të shkruara dhe sociale? Si mund të jenë marrëdhëniet e librit të artit me gazetarinë dhe gazetarët e tyre të kulturës? Po me institucionet që organizojnë konkurime, dhënie çmimesh apo diçka tjetër të tillë? Me librin e artit situata është shumë më e vakët dhe komplekse. Sepse vet libri i artit është i veçantë. Ai kërkon të lexohet, kuptohet dhe interpretohet nga gazetarja apo gazetari i kulturës së mediave për publikun. Dhe institucionet e vlerësimit, të konkurimit dhe dhënies së çmimeve, të cilët paguhen edhe me punën e taksapaguesve të krijimit të librave të artit dhe artistëve, që janë grupi i drejtëpërdrejtë i interesit për librin e artit, pasi veprat e tyre zënë vend në faqet e tij, ndodh që ata të shpërfillen. Arsyetimi kërkon: mos duhet vallë të nxisin në drejtim të këtyre institucioneve individë lider, të ditur e të kulturuar me fushat e letërsisë dhe të artit e më pas të formojnë grupe specialistësh, që të marrin në konsideratë dhe të vlerësojnë edhe krijimin e librit të artit? A mundet të ndodhë kjo? Natyrisht që po! Kam mendimin se fillimisht mundet të ndodhë një konstruktiv tërësor e thelbësor mbi këto lloj institucioneve, që shpeshherë nuk ndjehen komod, të ditur e në lartësi profesionale me librin e artit, madje dhe me atë letrar. Kjo mangësi i bënë t' i anashkalojnë dhe nënvlehtësojnë.

Natyrisht ky tekst ka për qëllim të përqëndrohet mbi zbulimin tërësor të vlerës së librit të artit, domosdoshmërisë së kalimit të tij në duart dhe mendjet e publikut. Edhe pse është shumë e vështirë, mendoj se arrihet nëse aktivizohen sistemet e edukimit dhe të vlerësimit. Dhe kjo mund të nisë të ndodhë nëse proceset e edukimit me librin e artit fillojnë që në moshat më të vogla; nisin nëse prindi entuziazmohet prej artit shekullor dhe edukohet ta vlerësojë fuqinë e artit mbi individin bashkëkohës, pra fëmijës së tyre; nisin me evidentimin e aktivizimit të projekteve mbi librin e artit në kurikulat e shkollës, si dhe theksimit të seriozitetit të programeve të institucioneve të konkurimit dhe vlerësimit mbi librin e shkruar, ku libri i artit të mos përjashtohet siç ka ndodhur deri në ditët e sotme, por të jetë pjesë e tyre. Mund tu sjell shembuj rreth kësaj gjendjeje sic janë panairët e shumta të librit, ku promovimi, vlerësimi dhe kritika mbi librin e artit është inekzistente, gjë që ndodh edhe me zhvillimet që ndërmer Qendra Kombëtare e Librit dhe e Leximit e cila ka një misionin e saj të shkruar qartë

Le të përpiqemi të lexojmë librat e artit

Nga Suzana Varvarica Kuka

Studiuese Arti

sei: “...duke synuar përhapjen e kulturës së leximit në të gjithë vendin, nxitjen e krijimtarisë, forcimin e rolit promovues dhe edukativ të bibliotekave dhe...”. Të gjithë e kemi parë se kjo qendër funksionon vetëm për promovimin e librit letrar, ndërsa librat e tjerë janë anashkaluar ose nënvlehtësuar. Dhe kjo nuk e ndihmon edukimin e tërësishëm të individit bashkëkohës, pra brezit të ri, por ndikon për të krijuar një individ me formim tw njwanshwm. Në këtë arsye mendoj se nëse do ta njihnim dhe ta përvetsonim fuqinë e librit të artit do të kishim në ditët e sotme jo një brez agresiv e me thika në brez, por njw brez më të ditur, më të pavarur, më tolerant dhe më të përgjegjshëm.

Po të evidentojme se çfarë ndodh me median e gazetarisë së shkruar apo televizive kulturore ndërkombëtare, zbulojmë se ajo është plot e përplot me promociione, informacione dhe mendime kritike, por me lejoni të theksoj sesi në botën virtuale të mediave sociale ndërkombëtare përballesh me gjetje inteligjente, për ta bërë publikun bashkëkohës pjesë të projekteve të tyre mbi artin, duke tërhequr vemendjen në forma tejet njerëzore, emocionale dhe profesionale. Në botën aty ku bashkohet Lindja me Përrëndimin, në Rusi, ku arti pamor ka pasë dhe ka një zhvillim të gjerë, një gazetar rus del çdo ditë në rrugë dhe pyet kalimtarët e rastësishëm, kryesisht të moshave të reja, “E kujt artisti është kjo tablo apo pikturë?” dhe 90 % të përgjigjeve janë pozitive dhe të sakta. Ata gjejnë autorët si të huaj ashtu dhe vendas. Dhe natyrisht lind çudija sesi ka mundësi. Por ka mundësi, sepse t' i kupton që ata janë edukuar me artin në shkolla, në familje, në


galeri dhe muze. Ti kupton se organizmat shtetërore mbi edukimin, arsimin janë të lidhura ngushtësisht me kulturën dhe artin. Ti kupton fuqinë e artit dhe të librit të artit, tw cilat ndihmojnë nw aktivizimin e inteligjencws individuale. Media sociale të dërgon kudo. Në Londër, një gazetarë e mirëinformuar me artin pamor ndërkombëtar, i' u kërkon kalimtarëve të ndryshëm në racë dhe moshë, t' i' u bëj një pyetje mbi artin. Ajo i' u drejtohet me anglishten britanike: “Më falni! Nëse ju do të deshit të kishit në pronësinë tuaj një vepër arti, cila do të ishte ajo dhe pse?” Dhe çdo njëri prej tyre, duke pranuar më parë se përgjigjeja përballet me një sfidë të madhe, jep përgjigje të shkëlqyera, përmes së cilës mëson rreth dijes që kanë mbi historinë e artit, të cilën e kanë përfutur nga librat e artit dhe vizitave të tyre në galeri dhe muze arti. Njihesh me shijen e tyre për të zgjedhur një prej veprave që kjo histori e mban në faqet e veta. Dhe më pas ata japin arsyen pse, që lidhet me atë çka ajo i ka emocionuar, mbi faktet që ata dijnë rreth krijimit apo historikut të veprës, frymën imagjinative që vepra do të shpërndante nëse do ta kishin në mjedisin e tyre të banimit dhe, më e fundit rreth ndikimit që vepra ka ushtruar mbi psikun dhe mënyrën e tyre të jetës. Dhe kupton pse shoqëritë e vendeve përtej Shqipërisë janë shoqëri të konsoliduara, të cilat kanë eliminuar dhjetra fenomene agresive, i kanë dhënë vlerë lirisë së individit dhe respektit reciprok. A nuk janë këto akte të gazetarisë së medias sociale shprehje të fuqisë së librit të artit? Dhe konkretisht libri i artit do të thotë art dhe mendim, të cilët do t' i konsideroja edhe si mjete të fuqishme për rritjen intelektuale të



individit të ditëve të sotme. Një rritje krejt e ndryshme, homogjene me kohën e këtij shekulli, i cili që në hyrje të vet, përgatiti nisjen e një rendi të ri botëror.

Në këtë arsye do t' i sugjeroja sistemit të sotëm të edukimit arsimor e familjar dhe institucioneve të konkurimit dhe vlerësimit të përditësojnë dhe vlerësojnë librin e artit, për të ndjerë gjatë leximit të tij jo thjesht bukurinë e veprave ose tingëllimin historik të krijimit të tyre, por më së shumti arsyen pse janë shkruar këta libra. Çfarë përmbajtje kanë ata, cilat janë veprat tipike, cilët janë stilet që përshkruajnë, drejtimet dhe rrymat artistike; cilët janë artistët themeltarë dhe pse janë të tillë, çfarë pikturuan ata; në shërbim të kujt kanë qenë dhe pse i ndihmuar apo i' u bënë porosi për të krijuar art; a janë ata politik? A janë veprat e tyre një shtrirje imazhesh ku tregohet historia njerëzore dhe ku evidentohet kujtesa njerëzore, e cila marret në konsideratë dhe evidentohet në të gjitha periudhat historike? Dhe sa shumë pyetje të tjera gjejnë përgjigje nëse lexohet një libër arti.

Sa shumë libra arti ndodhen në bibliotekat e huaja dhe ato shqiptare dhe është kënaqësi të shkruaj se edhe në radhën e librit të artit shqiptar ndodhen dhjetëra e dhjetëra syresh që mund t' i' u referohemi për të mësuar rreth kujtesës pamore të historisë sonë. Gjithësesi, libri i artit i botuar do kohë më parë, me të cilin gjithkush mund të nisë një rrugëtim të paqhtë për të gjetur të gjitha përgjigjet e shtruar më sipër, është “HISTORIA E ILUSTRUAR E ARTIT”, përkthyer mjeshtërisht në shqip nga Sokol Çunga. DK London në Britani dhe Aedititions në Shqipëri janë botuesit. Kontribuesit e këtij libri janë Ian Chlivers Iain Zaczek, Jude Welton, Caroline Bugler dhe Lorrie Mack, njohës dhe hartues tekstesh mbi artin të Enciklopedisë Britanike. Përmbajtja e librit nis nga Antikiteti 30. 000 vite para K dhe përfundon me artin Pop dhe Op të zhvilluar në vitet 1950-1980 të shekullit XX. Libri është i shkëlqyer, aspak i vështirë dhe shumë tërheqës për informacionet që promovon. Në çdo kapitull të njeh me cilësinë më tipike të përmbajtjes historike, si dhe me ngjarjet kryesore dhe individët udhëheqës të zhvillimit historik të epokës, të cilat kanë përcaktuar kushtet specifike të zhvillimit të atmosferës së artit të epokës. E gjitha kjo bëhet e qartë kur fillon e njihesh me veprat dhe artistët kryesorë, me temat, subjektet dhe personazhet e trajtuar në veprën e artit. Në dhjetëra faqe lexohen me kërshtëri kuriozitet domethënëse, të cilat ndihmojnë në kuptueshmërinë më të lartë të arsyeve të lindjes dhe të krijimit të një veprë arti, si dhe gjurmët që ato kanë lënë përmes domethënies të imazheve. Në këtë përmbajtje tekstesh mbi artin përfshihen edhe thënie të personaliteteve të ditur të arkitekturës, letërsisë, artit dhe shkencës. Ajo çka është më e rëndësishme është se libri i artit i formës histori arti specifikon periudhat në rënditjen historike të zhvillimeve ekonomike e politike të historisë njerëzore. Pohimi filozofik “Historia e Njerëzimit është një. Historia e Artit është një pjesë integrale e Historisë së Njerëzimit”, tregon rreth lidhjes themelore midis ekzistencës njerëzore dhe shprehjes artistike. Ky përkufizim shpreh një ide, që pasqyron konsensusin e vendosur midis historisë së artit dhe shkencave humane. Le të përpiqemi të lexojmë librat e artit!



Shtëpia prestigjioze e modës, Dior, nxori këtë javë koleksionin e ri pranverë-verë 2026, ku sërisht, përtej risive në vendosjen e standardeve të modës, arriti (nuk e dimë nëse qëllimisht) të depërtojë drejt një grupi që, ndoshta, më pak e vret mendjen për modën se sa për kulturën, letërsinë dhe në veçanti, aktin e leximit. Dior-i prezanton kësaj here një praktikë estetike që në pamje të parë duket si një homazh ndaj letërsisë klasike, por që, në një lexim më të thelluar semiotik, shfaqet si simptomë e një marrëdhënieje komplekse midis artit, industrisë kulturore dhe konsumit artistik. Për sezonin e ri, drejtori kreativ i Dior-it, Jonathan Anderson, sjell klasikët letrarë në çantat ikonë të markës. Çdo pjesë e “The Book Cover Collection” ekspozon kopertinën e botimit të parë të klasikëve të shekullit XVIII, XIX dhe XX. Në mesin e librave të përfshirë janë: Drakula e Bram Stoker, Madam Bovari e Gustave Flaubert, Lulet e së keqes e Charles Baudelaire, si dhe Ulisi i James Joyce. Në dekadat e fundit, marrëdhënia midis modës dhe kulturës letrare ka kaluar nga referenca simbolike drejt ndërthurjes së drejtpërdrejtë midis objektit, imazhit dhe praktikës lexuese. Rasti i Dior it për sezonin pranverë–verë 2026, ku kopertina e librave klasikë përdoret jo vetëm si motiv, por si element dominues vizual dhe simbolik, ngre një pyetje themelore: çfarë ndodh kur libri nuk është më vetëm objekt leximi, por bëhet objekt konsumimi vizual i luksit? Ky fenomen, përtej pamjes së tij motivuese, kërkon një analizë kritike nga pikëpamje teorike estetike dhe kulturore.

Në debatin e madh të shekullit të kaluar mbi maninë e riprodhimeve mekanike të veprave artistike, Walter Benjamin argumenton se në epokën moderne, vepra e artit nuk e ruan dot më “aurën” e saj origjinale, pra, atë praninë unike që e lidh subjektin me objektin në një përvojë meditative. Riprodhimi masiv dhe qarkullimi industrial i veprave artistike nuk e shkatërron vetëm origjinalitetin e saj, por transformon mënyrën se si ajo perceptohet dhe përdoret. Kur kopertinat e librave klasikë zhvendosen nga funksioni i tyre narrativ drejt rolit të një ornamentit luksoz në aksesore mode, shkëputja nga përvoja lexuese bëhet e dukshme. Libri nuk më është referencë për përvojë, por për prezencë vizuale në hapësirat publike, pra kalojmë nga nevoja për lexim tek estetika e të lexuarit. Kjo çon në humbjen e aurës sipas Benjamin it, por jo në mënyrën e thjeshtë teknike që ai përshkruan. Këtu humbja lidhet me transformimin kulturor dhe funksional: nga teksti në imazh. Edhe Theodor Adorno na e ofron një vizion paralel mbi industrinë kulturore: arti dhe kultura, kur futen në logjikën e konsumit masiv, humbasin potencialin e tyre kritik, duke u shndërruar në mall për konsumatorin. Sipas tij, arti nuk duhet të jetë thjesht shije estetike: Ai duhet të përmbajë elementin e sfidës dhe të tensionit kritik ndaj realitetit ku shfaqet. Kur letërsia klasike shndërrohet në simbol shijeje të rafinuar për konsumatorë të luksit, ajo humbet funksionin e saj fillestar dhe reduktohet në objekt simbolik për kritikën sociale. Kjo është pikërisht kritika që Adorno drejton kundrejt artit që bëhet mall.

Megjithatë, një analizë tërësisht teorike që ngrihet vetëm mbi humbjen e aurës dhe neutralizimin kritik, nuk depërton dot në kompleksitetin e përvojës së lexuesit, apo subjektit artistik modern.

Koleksioni më i fundit i Dior-it i bën homazh letërsisë klasike

Nga Jola Tasellari

Leximi si praktikë, ndryshe nga objekti që e përfaqëson, mbetet një akt intim, personal dhe autonom. Nuk mund të supozojmë se transformimi i librit në objekt mode e çrrënjos plotësisht përvojën e leximit. Përkundrazi, kontakti me objektin, edhe kur ai është problematik nga kjo pikëpamje, mund ta riaktivizojë dëshirën për lexim. Rastet kur individët nxiten të rilexojnë një vepër letrare pas një kontakti të beftë kulturor, demonstrojnë se përvoja e leximit nuk është hermetikisht e mbyllur ndaj konteksteve të jashtme, pasi ndonëse servirur si një proces vetmitar dhe personal, leximi si praktikë stimulohet lehtësisht edhe prej faktorëve të jashtëm. Kjo tregon se leximi ka një autonomi që nuk mund të absorbohet plotësisht nga logjika e hiper-konsumit.

Në një kontekst më të gjerë kulturo estetik, fenomeni i Dior it nuk është i izoluar; ai shfaqet si pjesë e një trendi më të gjerë në modë, ku shtëpitë e modës përdorin letërsinë dhe botimet si materiale narrative dhe simbolike. Në vitet e fundit, marka të ndryshme kanë filluar të konceptojnë projekte që shkojnë përtej referencës së thjeshtë të librit. Vitin e kaluar, Prada ka ftuar shkrimtaren Ottessa Moshfegh të krijojë prozë origjinale lidhur dhe frymëzuar nga koleksionet e saj, duke e integruar letërsinë jo vetëm si motiv, por si një formë të re të rrëfimit kulturor. A nuk është fashion-i kulturë?

Shtëpia franceze e modës, Yves Saint Laurent, ka hapur në Paris një librari që sfidon modelet tradicionale të konsumit

të luksit, duke ia dedikuar këtë hapësirë artit, kulturës dhe modës ekspresioniste. Shembuj të tillë na bëjnë të besojmë se interesi i modës për letërsinë nuk është thjesht trend dhe sipërfaqësor, por një përpjekje për të rikrijuar një lidhje midis pasionit intelektual dhe identitetit vizual në një kohë kur konsumatorët nuk kërkojnë vetëm mallra dhe objekte, por histori dhe kuptim kulturor në markat që zgjedhin. Megjithatë, kjo ndërthurje e letërsisë me modën, dualizohet në dy pole: nga njëra anë, simboli i librit transformohet, objektivizohet dhe, përmes çmimit me të cilin koleksioni hidhet në treg (nga 1300\$ - 3500\$), ai rezervohet për një elitë të caktuar, dhe nga ana tjetër, ky shpërthim vizual i librit dhe klasikëve të letërsisë stimulon rikthimin kah përvojës së leximit, një përvojë që gjithsesi nuk cenohet. Ajo mbetet individuale, intime dhe autonome.

Assesi nuk po themi se bota e modës po “i bën nder” letërsisë në kuptimin tradicional. Nuk e ringjall ajo tekstin, veçse përmes veprimit të tij narrativ, por mund të riaktivizojë tek individët e mandej tek masa dëshirën për ta ripërjetuar përvojën letrare, kjo pas debatit të kudogjetur se libri, në konceptin origjinal të shfletimit të tij, nuk lexohet më në të njëjtën sasi sa më parë. Kështu, ndoshta sadopak, Dior-i ka stimuluar rikthimin tek klasikët, përmes estetikës së re, atë të së lexuarit. Dhe me kë më mirë mund ta arrinte përveçse përmes lexuesit të ardhshëm?



Kjo tregon se leximi, edhe pse i nxitur nga faktorë të jashtëm, nuk e humbet dot identitetin e tij, jo sepse kështu duam, por sepse përballja është e pabarabartë, fenomenet janë plotësisht të ndryshme, dhe pjesërisht edhe audienca që tërhiqet nga njëri pol apo nga tjetri.

Në një kohë kur bota kërkon të rindërtojë vlerat e kulturës së thellë përballë konsumimit vizual, ky fenomen shërben si një laborator i rëndësishëm. Ai tregon se ndonëse “i elitizuar”, ky objekt luksi mund ta stimulojë subjektin lexues në mënyra të papritura. Përgjegjësia kritike e teorisë estetike dhe e praktikës kulturore është ta shfrytëzojë dimensionin e kësaj përplasjeje, dhe jo ta mohojë një dimension në funksion të një tjetri. Ndërkohë që, për shkak të lehtësisë së riprodhimit, riprodhimi masiv i artit është kthyer tanimë në normë, një çantë luksoze mund ta mbajë kopertinën e një klasiku, por sërisht leximi mbetet një akt i papërshkueshëm nga mekanizmat e tregut dhe konsumit. Ironia qëndron pikërisht këtu: ndërkohë që industria e modës synon ta ringjallë veprën klasike letrare, aurën e saj, ne, lexuesit, biem dakord se vetëm në vetminë dhe intimitetin e përvojës sonë, ne vijojmë ta rilexojmë, ta interpretojmë dhe ta ri-zbulojmë tekstin letrar. Por a janë të gjitha përvojat letrare dhe stimulimet tona të njëjta? Ose thjesht mund të biem dakord për të mos rënë dakord...



Shumë lexues të *Odisesë* duan që Penelopa, bashkëshortja kokëfortë e Odiseut, të përputhet me idealin e një gruaje të fuqizuar.

Qëkur përfundova përkthimin tim të *Odisesë*, i cili është version i parë i botuar i epopesë së Homerit në anglisht i përkthyer nga një grua, lexuesit shpesh kanë supozuar se duhet të simpatizoj mbi të gjitha personazhet femra të veprës. Më pyesin veçanërisht për interpretimin tim të Penelopës, gruas besnike të Odiseut. Penelopa kalon njëzet vjet në izolim plot lot, duke pritur që burri i saj të kthehet nga lufta—dhe, siç ndodh, edhe nga shpella dhe shtrati i dy perëndeshave të bukura—ndërsa kujdeset për djalin e saj dhe zmbra përparimet e pretendentëve të dhunshëm. Në të njëjtën kohë, ajo arrin t'i mashtrojë pretendentët me dredhinë e saj të fshehtë të endjes ditën dhe ç'endurit të punës natën, duke u thënë se nuk mund të martohet derisa pëlhura të përfundojë. Për më tepër, ajo ia shpon krenarinë bashkëshortit duke pretenduar se ka lëvizur shtratin që ai ka ndërtuar nga një ulli ende i gjallë—një kujtesë se ajo ka fuqinë ta lëndojë duke fjetur me një burrë tjetër. Ajo është e mençur, kokëfortë, këmbëngulëse, me imagjinatë të gjallë, besnike, një nënë kompetente, kryesisht e vetme, që tregon dashuri të thellë për djalin e saj të vështirë e të paqëndrueshëm, dhe e mban në këmbë një familje të madhe e komplekse për dy dekada. Për të gjitha këto duhet ta duash—dhe unë e dua.

Por shumë studentë, studiues dhe lexues të përgjithshëm duan edhe më shumë nga ky personazh letrar: duan që ajo të përputhet me idealin e një gruaje të fuqizuar. Është ngushëlluese të përqafosh idenë—siç bën Daniel Mendelsohn në kujtimet e tij të botuara së fundmi, *An Odyssey*, dhe siç bën Robert Fagles në përkthimin e tij të poemës—se martesë midis Odiseut dhe Penelopës është një partneritet barazie intelektuale, i bazuar në dashuri të vërtetë dhe një këndvështrim të përbashkët për jetën. Odiseu flet, në poemën e Homerit, për idealin e një mendësie të përbashkët (homophrosyne) në martesë. Zakonisht nuk përmendet se ai e sjell këtë temë vetëm kur flet me një vajzë adoleshente të lehtë për t'u ndikuar, Nausikën, së cilës i shmanget t'i thotë se është i martuar dhe ndaj së cilës ka motive të forta të fshehta për ta lajthitur, meqë jeta e tij varet nga ndihma e saj. (Duhet ta dimë tashmë se burrat e fuqishëm e më të moshuar nuk u thonë gjithmonë të vërtetën grave të reja.) Për më tepër, leximi i sentimentalizuar i Penelopës fshin disa fakte rreth pozitës së saj shoqërore që poema origjinale i bën shumë të qarta. Ndërsa Odiseu ka shumë zgjedhje, shumë identitete, shumë vende ku të shkojë dhe njerëz që të jetë e të shohë, Penelopa ka vetëm një zgjedhje, të përcaktuar ekskluzivisht nga statusi i saj martesor: ajo mund të presë Odiseun ose të martohet me dikë tjetër—dhe edhe kjo zgjedhje tejet e kufizuar nuk është e hapur përgjithmonë, pasi pretendentët e dhunshëm mund ta detyrojnë më në fund të vendosë. Në broshurën e ardhshme të Mary Beard, *Women and Power*, ajo shkruan për një skenë në *Odisesë* që e quan “shembulli i parë i regjistruar në letërsinë perëndimore i një burri që i thotë një gruaje ‘mbylle gojën’”—Telemaku i thotë Penelopës të heshtë, në Librin e Parë, pasi ajo i kërkon poetit që këndon në pallatin e saj të zgjedhë një melodi tjetër.

Heshtja e zërave femërorë dhe rreziqet

Përballja e një përkthyesje me gratë e Odisesë

Nga Emily Wilson

E para grua në botë, që ka përkthyer "Odisenë"

e agjencisë femërore janë probleme qendrore të poemës. Pozita e rreptë e kufizuar e Penelopës paraqitet në disa aspekte si e nevojshme, pasi gratë elitare që veprojnë më lirshëm mund të bëjnë gjëra të frikshme—si Helena gjysmë-hyjnore, që braktis burrin për një tjetër, ose motra e saj Klitemnestra, që ndihmon të dashurin të vrasë bashkëshortin. Në Itakë, Odiseu zotëron shtëpinë, armët, pasurinë, skllevërit, fermën, kopshtin dhe vendin në keshillin e burrave; Penelopa as që e ndan plotësisht shtratin martesor, të cilin burri i saj e quan “shtrati im”. Penelopa është, si bashkëshorti i saj, jashtëzakonisht inteligjente; por inteligjenca e saj, *periphron* (“e kujdesshme, e matur”), sugjeron maturi dhe shmangie rreziku. Mendja e saj e mprehtë nuk e çliron; e mban të bllokuar. Në kontrast, inteligjenca e Odiseut përkufizohet si aftësia për të gjetur zgjidhje për çdo situatë: ai është *polymechanos*, njeriu me zgjidhje për gjithçka, me një vullnet të hekurt. Poema vendos një dallim të mprehtë midis fantazisë së Odiseut dhe realizmit të Penelopës. Ai beson se, pas njëzet vitesh larg shtëpisë, mund të kthehet sërish në të njëjtin njeri; ajo e di se, sado e fortë, e zgjuar apo besnike të jetë, nuk mund të jetë kurrë më e njëjta. Në një nga pasazhet më tronditëse dhe më të bukura të poemës, Penelopa qan aq dëshpërimisht saqë vetë qenësia e saj duket se tretet. Në përkthimin tim, thuhet:

Fytyra e saj po shkrihej, si bora që Zefiri shpërndan mbi majat e maleve; pastaj Eurusi e shkrin, dhe teksa shkrihet, lumenjtë fryhen dhe rrjedhin sërish. Kështu edhe faqet e saj të bukura u shkrinë në lot.


Përkthime të tjera thonë se lotët e saj “u shkrinë” ose “rreshqitën” mbi faqet, ose (në klishe angleze) se iu “shkri zemra”. Por teksti origjinal i Homerit thotë se *chros*—“lëkura” ose “mishi” i saj—u shkri dhe se vetë faqet e saj u tretën (*teketo kala pareia*). Penelopa e përjeton martesën e saj përmes pikëllimit, braktisjes dhe humbjes së identitetit—një humbje që, Homeri e paraqet si një proces të domosdoshëm dhe natyror, si ardhja e pranverës në mal. Duke përkthyer këtë pasazh, doja të nxirrja në pah njëkohësisht bukurinë dhe saktësinë e imazherisë, si edhe tmerrin—një tmerr i zakonshëm, i afër—të të qenit grua që e përjeton lidhjen me bashkëshortin si shkatërrim të vetvetes. Doja që lexuesi i anglishtes sime të ndiente atë që ndiej unë duke lexuar greqishten: të ndiente për Penelopën dhe me dhimbjen e saj, pa e zbukuruar apo trivializuar pikëllimin e saj.

E gjithë kjo mund ta bëjë Penelopën të duket si një viktimë e pafajshme, por ajo është gjithashtu një grua e privilegjuar, që bashkëpunon—madje këmbëngul—

në heshtjen e grave më të cënueshme. Penelopa kapet me dëshpërim pas çdo cope autonomie që i ofrohet në shtëpinë e burrit të saj. Pasi Odiseu masakron pretendentët, ai i thotë Telemakut të vrasë skllevërit femra që kanë fjetur me ta. Përkthyes dhe komentues bashkëkohorë shpesh e paraqesin masakrën e këtyre grave si krejt të zakonshme dhe plotësisht të justifikuar. Skllevërit e vrarë përshkruhen rregullisht në përkthimet bashkëkohore amerikane si “shërbëtore të pabindura” dhe etiketohen si “kurva” apo “lavire”—një nivel abuzimi verbal që nuk ka absolutisht asnjë analogji në greqishten origjinale. Vrasja e këtyre skllevërve të abuzuar (që shpesh quhen, në mënyrë eufemistike, “shërbëtore” ose “vajza shtëpie”) përshkruhet shpesh sikur të ishte pa asnjë dyshim etike. Udhëzuesi *SparkNotes* i përshkruan këto gra si “shërbëtore femra jobesnike” që duhet të “ekzekutohen”, ndërsa *CliffsNotes* i quan “shërbëtore” që qenë “jobesnike” dhe pretendon se vrasja e tyre ka një “bukuri makabrë”. Në gjuhën origjinale të poemës, Telemaku u referohet atyre vetëm me *hai*, nyja femërore—“ato gra që... fjetën pranë pretendentëve”. Në përkthimin tim, i quaj “këto vajza” dhe shpresoj ta përcjell skenën si në çnjerëzoren e saj të përgjakshme, ashtu edhe në pathosin e saj: “kokat e tyre, të rreshtuara, / u varën me lakun rreth qafës / që vdekja e tyre të ishte një agoni. Ato gulçuan, / këmbët u dridheshin për pak, por jo për shumë.”

Ka një vizion të feminitetit të fuqizuar në *Odisenë*, por ai përcillet jo në botën vdekatare, por në atë të perëndive. Komploti i poemës, sigurisht, orkestron nga perëndesha mrekullisht fluide gjinore Athena, e cila mbron dhe shpëton njeriun e saj të preferuar nga Sirenat, perëndesha dhe përbindësja femra që përpigën ta zënë në grackë, ta shndërrojnë, ta fshehin, ta gëlltisnin ose ta përpijnë me dredhitë e tyre të rrezikshme femërore. Kalipsoja hyjnore, Afërdita dhe Çirçja ofrojnë modele pasionante të fuqisë femërore—fantazi të idealizuara se sa agjenci mund të kishin gratë vdekatare, po të ishin rrethanat shoqërore krejtësisht të ndryshme. Unë e lexoj poemën e madhe të Homerit si një artikull kompleks dhe të vërtetë të dinamikave gjinore që vazhdojnë të na përndjekin. *Odiseja* gjurmon frikërat e thella mashkullore ndaj fuqisë femërore dhe tregon dëmin e tmerrshëm që u bëhet grave—dhe ndoshta edhe burrave—nga strukturat shoqërore androcentrike që na mbajnë të heshtur dhe të kufizuar. Zogjtë te Homeri janë imazhi përfundimtar i të folurit dhe i lirisë. Athena shndërrohet vazhdimisht në një zog grabitqar, që fluturon mbi çatitë ose rrëshqet mbi dallgët e detit. Vajzat sklave të heshtura janë “si pëllumba ose mëllenja”, të zëna në rrjetën e gjuetarit. Penelopa, ndërkaq, është si një “bilbil i zbehtë gri” që “rri mes gjetheve / që mbushin pemët”. Ajo nuk mund të fluturojë, por cicërima e saj shndërrohet në një “simfoni tingujsh”.

EMILY WILSON është profesore dhe studimeve klasike në Universitetin e Pensilvanisë. Përkthimi i saj i *Odisesë* u botua në nëntor nga W. W. Norton & Company.



Midis kujtesës dhe fiksionit: strategjitë narrative te vepra “Të lirë” të Lea Ypit

Në zemër të veprës *Të lirë*, Lea Ypi artikulon një përvojë narrative që shkon përtej kontureve tradicionale të autobiografisë, duke ndërtuar një *vetvete narrative*, e cila nuk është thjesht dëshmitare e kohës, por produkt i përplasjes ndërmjet kujtesës dhe historisë, një proces i ndërtimit të një “unë-i” që lëviz mes përjetimit dhe interpretimit. Ky rrëfim nuk ka për qëllim të dokumentojë një jetë, por të negociojë kuptimin e saj në përballje me ideologjinë që e ka formësuar, duke e shndërruar autobiografinë në një akt filozofik të lirisë, jo si gjendje ontologjike, por si një horizont interpretimi. Parë nga ky këndvështrim, libri i Ypit mishëron atë që Ardian Vehbiu e përkufizon si funksionin kritik të kujtimeve: “Për ne, brenda hapësirës së kulturës shqipe, “kujtimet” kanë mbetur diçka që njeriu i shkruan në fund të jetës, për të korrigjuar disa gjëra dhe për të vënë disa pika mbi i, dhe sidomos për t’i përcjellë lexuesit një perspektivë unike ndaj ngjarjeve historike dhe eksperiencave politike.¹ Pikërisht këtu, rrëfimi na çon natyrshëm drejt kontekstit historik që na orienton në leximin e autobiografisë.

Konteksti historik dhe identiteti autobiografik

Konteksti historik i Shqipërisë komuniste dhe post-komuniste nuk shfaqet si sfond i heshtur mbi të cilin ndërtohet rrëfimi, por si një element i pandashëm i strukturës narrative. Ndikimi i tij e përshkon tekstin si në përmbajtje, ashtu edhe në ritëm, simbolikë dhe në ngarkesën emocionale që lind nga përplasia midis asaj që thuhej dikur dhe asaj që kuptohet sot. Kjo ambivalencë manifestohet që në kapitullin e parë “Stalini” dhe kulmon në pjesën e dytë të librit, ku përshkruhen me hollësi skemat piramidale dhe pasojat e tranzicionit që ndërtojnë një terren ku formohet zhgënjimi kolektiv.

Ndikimi i kontekstit nuk mbetet vetëm në nivel makrohistorik: ai konkretizohet fuqishëm në skena të zakonshme të jetës së përditshme, ku radhët e gjata përpara dyqaneve kthehen nga indikatorë ekonomikë në simbole strukturore që zbërthejnë ritmet e një jetese të pezullt dhe mekanizmat e brendshëm të një shoqërie të kushtëzuar nga mungesat dhe pritja e vazhdueshme. “Përpara dyqaneve kishte gjithnjë radhë, një radhë që ngjizej në pritje të kamionit të furnizimit... Atëherë më shpjeguan se radhët vazhdonin për ditë të tëra, ndonjëherë edhe natën. Ishte e domosdoshme që rrjetat e pazarit, bidonët e vajgurit ose gurët e madhësive të ndryshme, të ngarkoheshin me funksionet e tyre përfaqësuese që përndryshe do të mundoni njerëzit vetë.”²

Kjo metaforë e radhës, që në pamje të parë duket e parëndësishme, kthehet në një përkufizim të mprehtë të njeriut që jeton nën totalitarizëm: një njeriu që pret, pa e ditur ç’pret, por që vazhdon ta bëjë pritjen pjesë të identitetit të tij duke qenë se i jep një ndjenjë përkatësie.

Një tjetër element thelbësor është figura e prindërve, të cilët për Ypin përfaqësojnë dy pole të kundërta të një sistemi që e formoi dhe e gënjeu në të njëjtën kohë. Pyetja e saj – “Përse nuk po dilnin prindërit e mi për të shijuar lirinë që kishin dëshiruar aq gjatë? Përse nuk po shkonin të votonin? Ai zgjim me lëvizje të ngadalësuar, të krijojnë përshypjen se gjatë gjithë atyre viteve ata nuk kishin ëndërruar plotësimin e dëshirave konkrete, por vetëm që mundësitë abstrakte të mbeteshin të hapura.”³ – zbulon tensionin midis pritjes së gjatë për ndryshim dhe frikës për t’u përballur me të panjohurën. Liria e papritur i ekspozon ata jo vetëm

¹ Ardian Vehbiu, *Fiction në memoir*, Peizazhe të fjalës, Tiranë, 2022.

² Lea Ypi, *Të Lirë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2021. Fq. 61/62

³ Po aty, fq. 153

Mbi veprën *Të lirë* nga Lea Ypi, Dudaj

AUTOBIOGRAFIA SI INTERPRETIM: RASTI I LEA YPIT

Nga Rubensa Ndreca

ndaj mundësive, por edhe ndaj pasigurisë: ideologjia e mëparshme u kishte imponuar shtypjen e dëshirave dhe kultivimin e shpresës vetëm në formën e saj më abstrakte.

Kjo përplasje midis përvojës dhe kuptimit të mëvonshëm kulmon në çastin grotesk të zbulimit se statuja e Stalinit ka humbur kokën, një moment simbolik që përfaqëson rënien e mitit politik si strukturë orientuese e jetës. Ajo e përshkruan përballjen kështu: Po çfarë të shihja? Buzëqeshja ishte zhdukur. Nuk kishin mbetur më as sy, as gojë, madje as mustaqe. Huliganët ia kishin rrëmbyer Stalinit kokën.⁴ Ky imazh i fortë semiotik shënon çastin e çmitizimit: atë moment kur figura ideologjike reduktohet në materie të zbrazët, dhe rrëfimtaria përballet me të vërtetën se siguria, morali dhe kuptimi kishin qenë të projektuar mbi një iluzion monumental.

Në këtë pikë hyn në lojë ajo që studiuesi Paul Ricoeur e quan “brishtësia e kujtesës”⁵, gjendja në të cilën themelet simbolike të identitetit lëkunden dhe bota e mëparshme shpërbëhet. Pikërisht në këtë çast, thotë Ricoeur, kujtesa ekspozohet ndaj manipulimit, harresës dhe imagjinatës, dhe subjekti detyrohet të rimodelojë kujtesën për të rindërtuar vetveten përmes aktit të rrëfimit. Rrëfimi i Ypit provokon kështu një krizë të marrëdhënies midis lexuesit dhe kujtesës, një përplasje mes së vërtetës dhe fiksionit si mekanizëm mbrojtës, që Ardian Vehbiu e përkufizon si procesin ku teksti, “...në atë masë që i ka shërbyer autorit për të ndërtuar një imazh të rremë të vetes, po i shërben tani lexuesit për të ndërtuar një imazh të rremë të vetes, si super-ego, ose autoritet verifikues dhe gjygues.”⁶ Prej këtej lind nevoja për të shqyrtuar zërin rrëfimtari.

Kujtesa dhe retrospektiva: ndërtimi i zërit rrëfimtari

Teksti autobiografik *Të lirë* ngjizet mbi përplasjen midis përvojës së fëmijërisë dhe vetëdijes së mëvonshme politike dhe filozofike, ku retrospektiva nuk është thjesht

⁴ Po aty, fq. 14

⁵ Paul Ricoeur, *Memory, History, Forgetting*, përkth. Kathleen Blamey dhe David Pellauer (Chicago: University of Chicago Press, 2004), f.81

⁶ Ardian Vehbiu, *Fiction në memoir*, Peizazhe të fjalës, Tiranë, 2022.



kthim pas, por akt krijimi i vetvetes nën perspektivën e një kohe tjetër. Zëri rrëfimtari te Ypi lëviz midis dy regjistrave: një fëmijë që kupton botën përmes gjuhës së propagandës dhe një të rritur që çmitizon këtë gjuhë përmes një reflektimi kritik.

Ky dualitet është i pranishëm që në faqet e para të veprës, ku rrëfyesja përshkruan momentin kur përqafton statujën e Stalinit me një ndjenjë krenarie dhe besimi: “Kupimi i lirisë nuk kishte qenë kurrë në mendimet e mia deri në ditën që përqaftova Stalinin. Ashtu nga afër, Stalini mu duk shumë më i gjatë se ç’e prisja.”⁷ Fëmija e vogël nuk ka mjetet për të analizuar realitetin ideologjik që e rrethon, ajo vepron në përputhje me narrativën zyrtare. Por ky fragment, i ndërtuar me një gjuhë të zhveshur nga ironia e drejtëpërdrejtë, ngërthen një distancë të heshtur midis subjektit që përjeton dhe subjektit që rrëfen.

Në këtë mënyrë, retrospektiva bëhet mjeti për të riorganizuar të shkuarën sipas kuptimit që ajo merr sot. Kjo tregon se kujtesa autobiografike nuk është pasqyrim i realitetit, por ndërtimi i tij. Në një pasazh domethënës, rrëfimtaria pranon: “Ndoshta dhe unë vetë nuk e kuptoja mirë atë rrëmujë ndjenjash që përjetoja atëherë, atë përshypje të turbullt se jeta ime, brenda dhe jashtë mureve të shtëpisë, në fakt nuk ishte një por dy jetë.”⁸ Kjo frazë është çelës për të kuptuar procesin e kujtesës si një akt narrativ, ku përvoja ndahet nga kuptimi dhe përpunohet përmes një vështrimi të vonuar.

Dyzimi rrëfimtari është i pranishëm edhe në mënyrën sesi rrëfyesja përshkruan figurat prindërore. Babai përshkruhet si dikush që përdor ironinë për të jetuar, një formë mbijetese brenda një sistemi që e ka kufizuar. Nëna, nga ana tjetër, ruan një autoritet të heshtur: “Përshkruante vetëm atë që ndodhte, dukuritë që mund të mateshin, kurrë ndjenjat e saj. Ankohej rrallë. Nuk mbaj mend ta kem parë ndonjëherë me lot në sy. Shfaqte autoritet absolut; autoritetin e atyre qenieve të jashtëzakonshme...”⁹ Siç vëren teoricieni Philippe Lejeune¹⁰, pakti autobiografik mbështetet në idenë se autori rishkruan veten përmes një vetëdije të tashme. Në *Të lirë*, kjo vetëdije artikullohet si lëvizje e vazhdueshme midis tonit të fëmijës dhe zhgënjimit të të rriturës. Mungesa e shprehjes emocionale nga prindërit nuk është indiferencë, por një formë e heshtur qëndrueshmërie, të cilën vetë rrëfimtaria e kupton vetëm në retrospektivë. Përpunimi i së shkuarës përkthehet më pas në strukturën narrative të tekstit.

Poetika narrative: fiksioni, fragmentariteti dhe stili

Lea Ypi shpesh i shkrin kufijtë mes Lkujtesës autobiografike dhe elementeve fiktive, duke e shndërruar rrëfimin në një akt krijimi letrar e pothuaj mitik. Kjo ndërthurje fakt/ fiksion është e dukshme kur rrëfimtaria rikujton vdekjen e Enver Hoxhës, ajo nuk rrëfen vetëm ngjarjen, por ndërton një “unë” që është njëkohësisht produkt i propagandës

⁷ Lea Ypi, *Të Lirë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2021, fq.11

⁸ Po aty, fq. 34

⁹ Lea Ypi, *Të lirë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2021, fq. 45

¹⁰ Philippe Lejeune “On Autobiography”, , vol. 52, Theory and History of literature, University of Minnesota Press

dhe subjekt që përpigjet të kuptojë botën. Për shembull ajo rikujton sesi kishte idealizuar figurën e Enver Hoxhës deri në absurditet fëmijëror, duke menduar se një foto e tij do ta bënte më të denjë si pjesë e shoqërisë: “U kisha kërkuar sa e sa herë të vinin në kornizë një fotografi dhe ata gjithmonë harronin.”¹¹ Kujtesa kalon në një rrëfim ku ndjenja personale përzihet me shtrësëzimet propagandistike, duke krijuar një akt performativ që nxjerr në pah një identitet të formuar ideologjikisht.

Rrëfimi përzien shpesh ngjarje historike të njohura dhe episode personale në mënyrë që “e vërteta” të kuptohet si fryt i subjektivitetit. I tillë është pasazhi i përshkrimit të funeralit të Enver Hoxhës, rrëfyer me tone epike dhe simbolikë të mbivendosur, ku përmendet se “Edhe natyra vajton humbjen e një prej revolucionarëve më të mëdhenj të kohës sonë”.¹² Mund të themi se faktet historike shndërrohen në narrativë mitike, një teknikë ku kufijtë mes faktit dhe fiksionit shkrihen.

Një tjetër element i rëndësishëm është trajtimi i konceptit të “biografisë”, të cilin regjimi e kishte shndërruar në një mekanizëm përjashtimi. “Biografia ishte një lloj përgjigjeje universale ndaj çdo pyetjeje, një si themel fundor i dijes pa të cilin çdo njohuri e saktë kthehej sa e hap e mbyll sytë në një opinion të luatur... Ashtu ishte koncepti *biografi*. Kur përmendej si fjalë nuk kishte rrugë tjetër. Pranohej siç vinte, pa një pa dy.”¹³ Për Ypin fëmijë, kjo fjalë merr ngjyime surrealistike, ndërsa në planin narrativ ajo bëhet metaforë e fatit të paracaktuar ideologjik. Mënyra se si tregohet historia e babait, që u detyrua të linte pas ëndrrën për matematikë për shkak të biografisë së tij, dhe ajo e nënës që përjetonte frikën e përjashtimit për shkak të sfondit familjar, ndërtohen si regjime të gjalla, me humor të hidhur dhe elemente groteske. Për shembull, ironia kur përmendet se të gjitha pyetjet për jetën e njerëzve marrin si përgjigje fjalën “biografi”, një fjalë që për narratorin fëmijë bëhet një koncept misterioz dhe tërësisht absurd: “Po ti pyesje prindërit e mi se si ishin takuar dhe pse ishin martuar bashkë, përgjigjja e atypëratyshme ishte: “Biografia”.¹⁴ Ky përdorim i përsëritur dhe gati surreal i fjalës, e kthen faktin në një mjet poetik, ku fiksioni dhe realiteti bashkohen për të përçuar absurditetin e sistemit.

Edhe skenat e jetës së përditshme, p.sh., mënyra se si fëmijët imagjinojnë ushqimet dhe lodrat e turistëve apo bollëkun e supermarketeve perëndimore, janë rikrijime narrative që mbështeten në fakte reale të izolimit të Shqipërisë, por ndërkohë marrin ngjyra fiksioni përmes fantazisë dhe supozimeve femnore.

Rrëfimi që ndërton Ypi ku fiksioni dhe faktet janë të ndërthurura me një vetëdije kritike karakterizohet nga një strukturë fragmentare dhe jo lineare. Kalimet nga një kujtim te një tjetër, nga një histori te një reflektim, krijojnë një narrativë të ndarë në fragmente të vogla që paraqesin copëza të përvojës. Ajo kapërcen nga përshkrime intime të jetës familjare (p.sh., lufta e babait me antenën televizive për të kapur sinjal nga Dajti) te reflektime të gjera filozofike mbi lirinë dhe sistemin komunist. Kjo strukturë fragmentare është një strategji narrative që përcjellë ndjesinë e kujtesës reale: të çrregullt, të ndërprerë dhe të mbushur me kthime dhe shmangie.

Në thelb, vepra *Të lirë* qëndron si një model i rrëfimit bashkëkohor, ku individi rikthehet te vetja për të kuptuar jo vetëm një jetë të jetuar, por kushtet që e kanë bërë atë jetë të mundur, duke dëshmuar se autobiografia është po aq proces interpetimi sa edhe kujtesa.

¹¹ Po aty, fq. 59

¹² Po aty, fq. 56

¹³ Lea Ypi, *Të Lirë*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2021, fq. 40

¹⁴ Po aty, fq. 39

Çdo natë, Pilar ecte rreth e rrotull shtëpisë, merrte orët dhe i shpinte sa më larg veshëve të tij. Tringëllima e tyre e torturonte dhe nuk e linte të flinte.

Derisa një ditë José i tha:

“Nuk do të kesh më nevojë për shëtitjet e natës. Do t'i ndal orët. Nuk do t'i kurdis më.”

Disa ditë më vonë, e mori për dore dhe e çoi nga ora në orë.

“E sheh? Asnjëra nuk pipëtin,” - tha ai, i lumtur si një fëmijë. Të gjitha tregonin të njëjtën orë: katër.

“Pse orën katër?” - e pyeti Pilar.

Ai e pa dhe tha:

“Sepse është ora kur u njohëm.”

Pilar ishte gazetare kur i ra në dorë “Memoriali i manastirit”, libri i parë që lexoi nga shkrimtari. U prek aq shumë, sa reagimi i saj ishte i natyrshëm: të vraponte në një librari për të kërkuar një libër tjetër nga i njëjti autor.

Ishte i përkthyer “Viti i vdekjes së Rikardo Reisit”.

E lexoi, e komentoi në emisionet e saj televizive, e recensoi në shtyp. Por nuk u mjaftua: donte të njihnte autorin e atyre faqeve.

Gjeti numrin e telefonit të Saramagos dhe e telefonoi në Lisbonë.

“Jam lexuesja juaj,” - i tha. - “Po vij në Portugali dhe do të doja t'ju takoja.”

Nuk i kërkoi intervistë. Donte vetëm ta falenderonte që, duke lexuar librat e tij, ishte bërë njeri më i mirë.

Saramago ishte mësuar me gazetarë që e telefononin me të njëjtën kërkesë. Nuk pati asnjë kundërshtim.

U takuan në Hotel Mundial – ku ajo do të qëndronte – më 16 qershor 1986. Në orën katër pasdite.

Dolën nga hoteli për të shëtitur nëpër varrezat Dos Prazeres, pranë Manastirit të Jeronimitëve, në kërkim të gjurmëve të Fernando Pessoa-s. Kur u ndanë, shkëmbyen të dhënat. Asgjë më tepër.

Të dy mbetën me diçka që i rrethonte, të cilën Saramago e kujtonte kështu:

“Kishim të njëjtën ndjenjë: unë kisha gjetur këtë grua dhe ajo kishte gjetur këtë burrë.”

U shkruan disa letra, pak a shumë formale, derisa në njërin prej tyre ai i tha:

“Po qe se rrethanat e jetës suaj e lejojnë, do të doja, meqë po shkoj në Barcelonë dhe në Granada, të afrohem deri në Sevilje që të takohemi.”

Pilar iu përgjigj se po, rrethanat e jetës së saj e lejonin. U panë. Dhe që nga ai çast nuk u ndanë më.

Ishte viti 1988.

“Pilar u shfaq kur ishte e nevojshme. Kur kisha nevojë për veten time. Kam shumë arsye të mendoj se ngjarja më e madhe e jetës sime ishte takimi me të,” - tha José.

Ai ishte 64 vjeç kur u njohën. Ajo, 36. Një diferencë prej njëzet e tetë vitesh që për disa mund të dukej shumë, por mes tyre nuk qe kurrë problem.

E vetmja diferencë që pranonin ishte se ajo ishte grua dhe ai burrë. Për pjesën tjetër, dinin ta ndanin mënyrën e të jetuarit.

DASHURIA E JOSÉ SARAMAGO-S DHE PILAR DEL RIO

Dhe një sekret i Saramagos për Kadarenë, sipas Pilar del Rios, treguar nga fotografi personal i nobelistit, Joaquim Silva Rodrigues

*Përktheu dhe përgatiti
Bujar Hudhri*

Pilar u bë përkthyesja spanjolle e veprave të Saramagos. Ajo nuk kishte punuar kurrë si përkthyesë dhe as nuk dinte portugalisht, por një ditë përkthyesi i tij i zakonshëm, Basilio Lozada, u shfaq para tyre me syze të errëta dhe bastun dhe u tha se po verbohej.

“Sa keq,” - tha Pilar. Dhe shtoi se, që nga ai çast, përkthimi do të vazhdonte vetvetiu. E vendosi me të njëjtin impuls me të cilin merrte gjithçka në jetë. E mësoi gjuhën duke lexuar Saramagon në origjinal dhe kështu realizoi përkthimin e saj të parë: “Të gjithë emrat”.

Më pas vazhdoi të përkthente të gjitha romanet që laureati i Nobelit shkroi: “Njeriu i dyfishtë”, “Ese mbi verbërinë”, “Shpella”, “Kaini”, ndër të tjera.

Metoda e tyre e punës ishte kjo: Saramago shkruante dy fletore në ditë (nuk e kalonte kurrë këtë masë) dhe i linte mbi tryezën e Pilarit. Ajo i lexonte, i rilexonte dhe i përkthente. Të nesërmen, Saramago i korrigjonte dhe ajo i korrigjonte.

Kështu, libri lindte njëkohësisht në portugalisht dhe në spanjisht. Ishte një përgjegjësi që e trembte.

“Kisha ndërgjegjen se po përktheja një qenie të madhe dhe se unë nuk isha,” - thotë Pilar.

Ai kurrë nuk ndërhynte në argumentin e një libri dhe as nuk përmendte se çfarë mund ose nuk mund t'i ndodhte një personazhi.

“Kurrë.”

Vetëm dy herë bëri vërejtje.

E para, në dorëshkrimin e “Të gjithë emrat”, ku Saramago kishte vendosur

një sekretari telefonike në një shtëpi pa drita (dhe për ta bindur se kjo ishte e pamundur, Pilarit iu desh t'ia hiqte dritat shtëpisë së tyre në Lanzarote, ku jetonin).

E dyta, kur, pas një bisede me të, ai ndryshoi fjalën e fundit të “Shpellës”: hoqi fjalën “biletë” dhe e zëvendësoi me fjalën “hyrje”.

“Kontributi im i madh përmbledhet në kaq!”

“Jam e vetëdijshme për kufizimet e mia në veprën e Saramagos,” - thotë Pilar, dhe e shpreh kështu: Saramago. Sepse në shtëpi ishte vetëm José, por jashtë ishte Saramago. Sepse flet përkthyesja.

Emri i saj, Pilar, është i njohur për këdo që ka pasur në dorë një libër portugez të Nobelit. Ai është gjithmonë aty, në faqen e parë. Që



nga çasti kur jetët e tyre u bashkuan, veprat e Saramagos iu kushtuan bashkëshortes së tij (u martuan në vitin 1988; ai kishte pasur dy martesë të mëparshme; ajo, një).

Disa prej dedikimeve janë si këto:
“Për Pilarin, që ende nuk kishte lindur dhe iu desh kaq shumë kohë për të ardhur.”

“Për Pilarin, që nuk më la të vdisja.”
“Për Pilarin, shtëpinë time.”

Ajo i kërkoi të mos ia tregonte derisa ta kishte mbaruar librin, sepse mund të paralizohej.

“Kur më thoshte ‘e kam dedikimin’, po vdisja nga tmerri. Edhe sot e anashkaloj,” - thotë ajo.

Nuk shkruan kurrë “me katër duar”, por kishin një korrespondencë të vazhdueshme. U shkruan qindra letra, të cilat u lanë në një kasafortë në shtëpinë e tyre.

“Ishte një lojë argëtuese, - shton ajo, - për të cilën nuk do t’ju tregoj shumë detaje, por na argëtonte të shkonim të shihnim çfarë kishte lënë njëri dhe si i ishte përgjigjur tjetri.”

Letra që, natyrisht, nuk do të botohen kurrë.

José Saramago vdiq në qershor 2010. Ishte 87 vjeç. Ndarja ishte diçka për të cilën José dhe Pilar kishin folur.

“Do të takohemi diku tjetër,” - thoshte ai kur ngrinin çështjen e largimit të pashmangshëm. Vdekja e tij.

“Nuk flas zakonisht për këtë, e di?”

Por përpiqeshim të përgatiteshim së bashku.

“Ishim të qartë për atë që do të ndodhte,” - thotë Pilar. Shkrimtari kishte thënë:

“Që një ditë do të marrë fund? Këtë tashmë e dimë. Por nuk do të doja të isha në lëkurën e Pilarit kur të zhdukem. (...) Gjithsesi, le të qëndrojmë pranë njëri-tjetrit. Ta vazhdojmë. Së bashku.”

Pilar del Río u bë shtetase portugeze pas vdekjes së Saramagos dhe jeton mes Lisbonës – qytetit ku vepron fondacioni që mban emrin e shkrimtarit dhe të cilit ajo i përkushtohet ditë e natë – dhe Lanzarotes, ishullit ku ata jetuan për vite me radhë.

Hiri i shkrimtarit ndodhet te rrënjët e një ulliri njëqindvjeçar, të cilin e sollën nga fshati i tij i lindjes (Azinhaga), dhe epitafi i tij është fjalia e fundit e "Memorialit të manastirit":

“Dhe ai nuk u ngjit në qiell, sepse i përkiste tokës.”

Pilar-it nuk i pëlqen të quhet e veja e Saramagos. Ajo është bashkëshortja e tij. Në të tashmen. Çfarëdo që t’i mbetet nga jeta, thotë ajo, do të vazhdojë t’ia kushtojë veprës së këtij autori, të cilin një ditë shkoi ta kërkonte, në orën katër pasdite.



Bujar Hudhri

November 18, 2022 · 🌐

Një takim i veçantë sot në Juvenilja, midis Kadaresë dhe portugezit Joaquim Silva Rodrigues, ish fotografit personal të nobelistit José Saramago. Qëllimi i vizitës së z.Rodrigues ishte një intervistë për procesin krijues të shkrimtarit tonë. Ai solli dhuratë dy libra të nobelistit, nënshkruar nga zonja e Saramagos, Pilar del Rio e cila, gjithashtu, e kishte autorizuar që t'i përcillte Kadaresë një sekret të nobelistit: Saramago kishte propozuar Kadarenë për çmimin Nobel!

Ndërkohë z. Rodrigues na rrëfeu se kishte lindur një nga kryeveprat e tij. Një ditë Saramago ishte indinjuar sepse në restorantin ku ai shkonte çdo ditë, kamerierët shkonin e vinin, por jo në tavolinën e tij. Mos ndoshta jam bërë transparent dhe nuk më shohin kamerierët, mendoi shkrimtari. Apo ishin të gjithë të verbër? Kështu lindi romani "Verbëri" (botuar në shqip nga Dudaj)





Joaquim Silva Rodrigues

November 18, 2022 · 🌐

ISMAIL KADARÉ

Tirana 18 de Novembro de 2022

Dia grande para a literatura!

Primeira entrevista a Ismail Kadaré feita por um português, ido expressamente de Vila Nova de Gaia para entrevistar este grande escritor e Senhor das Letras, não só da Albânia, dos Balcãs, da Europa, mas do mundo!

Agradecimento especial a Bujar Hudhri (fundador da editora Onufri/Albânia) e à minha amiga e cúmplice nestas andanças Maria João Bravo.

Karikaturë nga Arben Meksi

**Së shpejti,
një platformë online
për shitjen e librave
në gjuhën shqipe
në Amerikën e Veriut**



*New Jersey Division of Revenue & Enterprise Services
Certificate Of Amendment
NJSA 42:2C-19
New Jersey Limited Liability Company Act*

State of New Jersey
Department of the Treasury
Division of Revenue & Enterprise Services
Business Amendments
Filed

Validation Number: 4286184300
07/16/25 10:21:25

Verify this certificate online at
https://www1.state.nj.us/TYTR_StandingCert/JSP/Verify_Cert.jsp

This Limited Liability Company filed with the Division of Revenue and Enterprise Services to amend its Certificate of Formation. The filer is responsible for ensuring strict compliance with NJSA 42:2C, the Revised Uniform New Jersey Limited Liability Company Act.

1. Name of Limited Liability Company: ALBLIBRIS LLC
2. Business ID Number: 0451311896